




RRUGËTIMI I **SBASHK-ut**



2025

Viti 2025 me plot sfida, por edhe me angazhime e arritje të shumta

SBASHK ishte bërë që në janar i gatshëm për të dialoguar me institucionet me qëllim që kërkesat e anëtarësisë të gjenin zgjidhje apo në të kundërtën, nëse dialogu do të ishte i pamundur me fajin e institucioneve, atëherë të shkohet në veprime sipas kërkesës së anëtarësisë. Mirëpo u bë diçka që nuk është pritur. Partia që doli e para e pa kënaqur me votat, bëri çmos që të pengonte krijimin e institucioneve. Kështu Kosova po mbyll vitin 2025 pa Qeveri dhe pa Parlament e një vit i humbur kot nuk është pak.

Mirëpo në këtë realitet, që nuk është dashur të ndodhte, SBASHK nuk ndali angazhimet në shërbim të anëtarësisë duke komunikuar vazhdimisht me ta dhe ka realizuar shumë takime. SBASHK ka organizuar edhe trajnime për shtatë modulet e kompjuterëve dhe për dialogun social dhe qindra anëtarë të SBASHK-ut kanë fituar njohuri të reja, të cilat i kanë vënë në jetë gjatë procesit mësimor. Të gjithë vijuesit në këto trajnime janë pajisur edhe me certifikata, që ju duhen për të dëshmuar orët e trajnimeve e për licencim e pastaj edhe për gradim në profesion. Po ashtu SBASHK ka bërë edhe angazhime për shërbime të anëtarësisë. Kujtojmë marrëveshjen me “Nëna Naile” me zbritje çmimesh për gjithë anëtarët e SBASHK-ut dhe familjarët e tyre.

SBASHK edhe në vitin 2025 ka vazhduar bashkëpunimin e frytshëm me Qendrën Amerikane të Solidaritetit me qëllim të forcimit të zërit sindikal. Për këtë qëllim janë mbajtur takime me veprimtarët sindikal me qëllim që përgatiten kuadro udhëheqës sindikal duke filluar nga shoqatat e deri të niveli qendror. Një aktivitet përmbajtësor ishte edhe seminari “Forcimi i angazhimit të anëtarësisë në folus të rinjtë dhe gratë”, organizuar në Ferizaj e Pejë. Ky aktivitet ka arritur objektivat dhe është vlerësuar lartë edhe nga zyrtarja e lartë e Qendrës Amerikane të Solidaritetit, znj Bruna. Ajo ka deklaruar se SBASHK është sindikatë e organizuar shumë mirë dhe se bashkëpunimi mes Qendrës Amerikane të Solidaritetit dhe SBASHK-ut do të vazhdojë duke organizuar edhe aktivitete të tjera sindikale e duke veçuar punëtorinë për Planin strategjik të SBASHK-ut.

Duhet veçuar edhe pjesëmarrjen e përfaqësuesve të SBASHK në aktivitetet sindikale të Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës (ETUCE) dhe të Internacionales Botërore të Arsimit (EI). Pjesëmarrësit e SBASHK kanë prezantuar në mënyrë të denjë sindikatën tonë në të gjithë këto takime. Ata janë pritur me respekt nga udhëheqësit më të lartë të Këtyre dy unioneve, të cilët janë shprehur shumë të gëzuar me angazhimet e SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë dhe të forcimit të zërit sindikal.

SBASHK edhe në vitin 2025 ka vazhduar me traditën e mirë për dërgimin e një numri të konsideruar të anëtarësisë për pushime në bregdetin shqiptar. Pushuesit shprehen me fjalë të zgjedhura për këtë aktivitet duke shprehur mirënjohje për stafin e nivelit qendror dhe duke lënë përshtypje të shtuara e të cilat janë botuar edhe në gazetën mujore të SBASHK-ut.

Po veçojmë edhe një aktivitet shumë domethënës të SBASHK-ut. Fjala është për organizimin e takimit me veteranët e SBASHK-ut. Ky aktivitet ua mundëson atyre që të takohen dhe shpalosin kujtime nga vitet e kaluara në misionin e shenjtë për edukimin e brezave dhe nga aktivitete me plot sfida të sindikatës sonë. Ata veçojnë veçmas angazhimet arsimore e sindikale në vitet e 90-ta. SBASHK do të vazhdojë me organizimin e pushimeve për 450 anëtarë e anëtarë të SBASHK-ut dhe me takimin e veteranëve të sindikatës sonë.

SBASHK zhvillojë edhe shumë aktivitete për të realizuar objektivat në shërbim të anëtarësisë duke u zotuar se edhe sot e gjithmonë do të vazhdojë me aktivitetet dhe me moton Bashkë e në SBASHK.

Bisedë me anëtarët e stafit qendror të SBASHK-ut

Rahman Jasharaj

Viti 2025 ishte me plot sfida. Sindikata jonë ishte përgatitur në pritje se do të krijohen me kohë institucionet qendrore me qëllim që fillojnë me dialogun për kërkesat e anëtarësisë. Ishim të gatshëm edhe me versionin e Kontratës Kolektive, që është njëra nga kërkesat legjitime, por partia që doli e para bëri çka nuk bëri dhe duke mos qenë e kënaqur me rezultat e zgjedhjeve të shkurtit, pengoi formimin e Parlamentit dhe të Qeverisë duke ëndërruar se po u bënë zgjedhjet e reja, do të fitojnë më shumë vota. Kështu shkoi kot një vit dhe ende nuk dihet se zgjedhjet e radhës, më 28 dhjetor, a do të krijojnë një realitet të ri, apo do të kemi një situatë të njëjtë edhe në fillimet e vitit 2026, që sipas të gjithë gjasave do të jetë vit me plot sfida. Kryetari Jasharaj tregon se të gjitha çështjet që janë varur nga SBASHK-u janë debatuar dhe janë realizuar dhjetëra grupe të trajnimeve dhe pjesëmarrësit kanë fituar njohuri për të qenë edhe më të suksesshëm në procesin mësimor.

Vjollca Shala

Lavdëron bashkëpunimin e gjithë anëtarëve të stafit qendror dhe të kryetarëve nga të gjitha komunat dhe universitetet me qëllim të realizimit të kresave legjitime të anëtarësisë. Një arritje, që veçon nënkryetarja Shala është edhe organizimi shumë i mirë i trajnimit për përdorimin e moduleve të kompjuterëve në procesin mësimor. Ajo kujton edhe organizimin e tryezave, punëtorive e seminareve me Qendrën Amerikane të Solidaritetit, bashkëpunim ky që ka për qëllim forcimin e vazhdueshëm të zërit sindikal. Vjollca veçon komunikimin me zyrtaren e lartë të kësaj Qendre, znj Bruna Hylviu. “Qendra Amerikane e Solidaritetit na ka përkrahur edhe në vitet e kaluara dhe ne jemi ndjerë krenar me këtë bashkëpunim, që ndikojë në hapërimin e SBASDHK-ut drejt arritjeve e rezultateve të reja.

Ymer Ymeri

Ymeri lavdëron punën e gjithë stafit qendror për të treguar pastaj për arritjet e shumta të SBASHK-ut. “Në koordinim me kryetarët e nivelit komunal sindikal kemi organizuar trajnime për qindra mësimdhënës. Kemi organizuar veprimtari sindikale me përkrahjen e Qendrës Amerikane të Solidaritetit, kemi marrë pjesë në shumë ngjarje e aktivitete të organizuara nga Unioni i Sindikatave të Arsimit të Evropës (ETUCE) dhe të Internacionales Botërore të Arsimit. Do veçuar se shpesh unë, nënkryetarja, por edhe i tërë stafi nuk kemi pasur pushim as të shtunave e të dielave, por kemi qenë me pjesëmarrësit e trajnimeve”, thotë Ymeri, i cili shton se SBASHK-u ka realizuar shumë nga objektivat e parapara në aktivitet brenda Kosovës, por edhe në aktivitetet e takimet ndërkombëtare duke ruajtur respektin që sindikatat simotra kanë shprehur për ne. Ymeri përgëzon stafin qendror, kryetarët e nivelit komunal sindikal e të universiteteve, por edhe kryetarët e gjithë shoqatave dhe veprimtarët tjerë sindikal që kanë dhënë kontribut me vlerë duke vazhduar me moton Bashkë e në SBASHK.

Afërdita Ahmeti

Si zyrtare administrative edhe në vitin 2025 jam angazhuar në kryerjen e detyrave të përditshme dhe kemi bërë gjithë të angazhimet që në bashkëpunim dhe në komunikim me kryetarët e nivelit komunal sindikalë e të universiteteve kemi arritur të jemi vazhdimisht në shërbim të anëtarësisë dhe për këtë kemi marrë vazhdimisht lëvdata. Dua të theksoi se suksese është fryt i angazhimit të përbashkët dhe atmosfera e krijuar na jep edhe më shumë vullnet për të vazhduar në kryerjen e këtyre detyrave. Çdo respekt për anëtarët e stafit qendror që nuk heziton për të ndihmuar njëri-tjetrit dhe kështu kemi dalë të gjithë faqebardhë dhe kemi marrë shumë falënderime nga kryetarët e nivelit komunal, por edhe nga anëtarët nga e tërë Kosova.

Nezafete Jakupi

Jam munduar dhe besoj që kam arritur që edhe në vitin 2025 të kryej detyrat që janë paraparë për vendin im të punës dhe nuk kemi hezituar që të gjithë në stafin qendror të merreni edhe me realizimin e detyrave, që përcaktohen për çdo ditë pune në takimet ditore të stafit qendror. Është për çdo lëvdatë atmosfera e punës dhe krenohem me respektin e ndërsjellë të anëtarëve të stafit qendror. Një bashkëpunim të shkëlqyer e kam edhe me kryetarët e nivelit komunal e të universiteteve të cilët me fjalët e zgjedhura të vlerësimit pozitiv na japin edhe më shumë kurajë për të vazhduar me angazhimet në shërbim të anëtarësisë.

Blendor Shatri

“Natyra e punës nga pozita e zyrtarit ligjor është e veçantë dhe njeriu ndjehet krenar kur palët shkojnë nga zyret të buzëqeshur e të lumtur që çështja për çka kanë ardhur të ne ka gjetur përkrahje dhe këshilla adekuatë. Kjo mikpritje dhe bashkëbiseda me anëtarësinë në zyret tona, apo gjatë vizitave në komuna ka bërë që ne të kemi pritje të ngrohtë kurdo herë që jemi mes anëtarësisë”, shprehet zyrtari ligjor, i cili pastaj duke folur për angazhimet e përditshme shton se është për çdo lëvdatë edhe fryma e shëndosh dhe angazhimi i përbashkët i Kryesisë, stafit qendror dhe veprimtarëve sindikal. “Kjo ka bërë që sindikata jonë të gëzojë respekt kudo në Kosovë, por edhe nga sindikatat simotra kudo në shtetet e Evropës dhe botës”, shton Shatri.

Drita Vitia

Është një staf i mrekullueshëm ky i SBASHK-ut. Këtu është krijuar një atmosferë punë dhe ne çdo mëngjes ulemi në zyre të kryetarit dhe marrim detyra konkrete dhe ne mundohemi, edhe duke i ndihmuar njëri – tjetrit, të kryejmë gjithë detyrat e planifikuara në këto takime. Ajo që dua të shtoj është se janë për çdo lëvdatë edhe veprimtarët sindikalë nga e tërë Kosova. Në takimet e Këshillit Drejtues, kam vërejtur, diskutohet shtruar për kërkesat e anëtarësisë dhe për angazhimet që ka bërë Kryesia. Në këto takime ka frymë mirëkuptimi dhe angazhimi për të qenë vazhdimisht zë i fuqishëm sindikal. Po ashtu SBASHK mund të krenohet edhe me numrin e madh të trajnimeve kudo në komunat e Kosovës. Këto trajnime zhvillohen ditëve të vikendit dhe përgëzojë anëtarësinë, e cila për të marrë njohuri të reja e për ruajtur procesin mësimor vjen në trajnime gjatë vikendeve. I gjendur në këtë atmosferë pune njeriu ndjehet mirë dhe vazhdon me vullnet të kryej detyrat ditore.

SBASHK po e përmbyll një vit me gjendje të rëndë të punonjësve arsimor në Kosovë

SBASHK mbajti tryezë diskutimi për gjendjen e sindikatave në 4 vitet e fundit në Kosovë

Fillimviti i muajit janar për SBASHK-un nisi me tryeza pune rreth gjendjes së krijuar në sistemin arsimor në Kosovë, veçanërisht gjendjen e rënduar të mësimdhënësve dhe mbarë punonjësve tjerë të arsimit, të cilët për katër vite me radhë nuk u trajtuan dinjitetshëm nga Qeveria e Kosovës.

Janari i vitit 2025 filloi me një tryezë diskutimi lidhur me gjendjen e krijuar viteve të fundit në arsim por edhe sindikatat tjera në Kosovë.



Gjatë këtij fillimviti SBASHK kishte organizuar një tryezë diskutimi lidhur me situatën e krijuar në katër vitet e fundit në Kosovë, ku u shpërfaq gjendja e punëtorve arsimor por edhe anëtarëve të sindikatave tjera, e cila u tha se është e rëndë.



Kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj, kishte thënë se qeveria Kurti jo vetëm që nuk ka bashkëpunuar dhe përkrahur sindikatat në Kosovë, por ka qenë kundërshtarë e tyre dhe

gati armiqësore karshi kërkesave të mësimdhënësve dhe punonjësve tjerë në Kosovë.



I pranishëm me diskutime në këtë tryezë ishte edhe dejtori i Institutit për Politika Sociale, "Musine Kokalari" Visar Ymeri, i cili tha se, Ministria e Financave nuk e ka rolin vetëm të ndarjes së buxhetit në Kosovë, por edhe krijimin e politikave për zgjidhjen e kërkesave të punonjësve, në këtë rast të arsimit.



Kurse, Naim Jakaj nga Instituti i Kosovës për Drejtësi, kishte thënë se nëse nuk vepron për ndryshimin e Ligjit të Pagave, IKD do të iniciojë padi në emër të 84 mijë shërbyesve civil.

“IKD do të iniciojë padi në emër të 84 mijë shërbyesve civil të prekur nga kjo situatë”, kishte thënë ai.

Pakënaqësitë e tyre i kishin shprehur edhe përfaqësuesit e disa sindikatave tjera në Kosovë si ai i BSPK-së, Atdhe Hykolli, i Sindikatës së Policisë së Kosovës, Avdi Hoti, përfaqësuesi i Sindikatës së Energjetikës së Kosovës, Avni Grajçevci, ai i Sindikatës së Pavarur të Minatorëve të Trepçës, Ibrahim Januzi, përfaqësuesi i Sindikatës së Punëtorëve të RTK-së, Gëzim Bimbashi.



Të pranishëm në diskutim ishin edhe disa nga kryetarët e Sindikatave Komunale të Arsimit dhe anëtarë tjerë të SBASHK-ut. Pjesëmarrësit në këtë tryezë kishin nxjerrë konkluzione në formë të një strategjie për angazhime të përbashkëta të sindikatave në Kosovë, duke forcuar solidaritetin mes tyre në përballje me cilëndo sfidë të kohës.



SBASHK pjesëmarrës në 80 vjetorin përkujtues të çlirimit të kampit shfarosës, Auschwitz

Gjatë muajit janar, SBASHK u përfaqësua edhe në skenën ndërombëtare të arsimit e kulturës.



Udhëheqës të lartë shtetërorë, veprimtarë, artistë, por edhe sindikalistë nga e tërë Evropa e bota ishin bërë bashkë në përkujtimin e 80-vjetorit të çlirimit të kampit nazist gjerman të përqendrimit, pjesë e të cilit ishin edhe përfaqësuesit e SBASHK-ut, nënkryetarja Vjollca Shala dhe sekretari i Përgjithshëm, Ymer Ymeri, ku bashkë me koleget e kolegët e tyre nga Ballkani, Evropa e tërë bota, kishin lartësuar kujtimin për miliona viktimë që përjetuan tmerre e shfarosje në këtë kamp përqendrimi, duke u lutur që tragjedi të tilla kurrë të mos përsëriten më. Kjo lutje e përbashkët ishte bërë gjatë vizitës në Muzeun Auschwitz e pastaj ishin mbajtur takime e Konferencë kushtuar 80-vjetorit të çlirimit të këtij kampi.



Pjesëmarrësit e këtij aktiviteti përkujtues kishin vizituar lagjen e vjetër hebraike në Kazimierz, duke përfshirë sinagogën më të vjetër në Poloni dhe një nga ndërtesat më të rëndësishme fetare hebraike në Evropë.

Përfaqësuesit e SBASHK-ut dhe gjithë sindikatave të arsimit ishin pjesë e Konferencës përkujtuese me moton "Kujtimi jemi ne".



Por, kishin zhvilluar takime të shumta me udhëheqës të lartë të Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës, të Internacionales Botërore të Arsimit dhe me përfaqësues të sindikatave simotra nga Ballkani, Evropa e bota, për të forcuar bashkëpunimin sindikal, që është tepër i nevojshëm në këto kohë kur sindikatat po përballen me sfida të shumta në përpjekje për të realizuar misionin e tyre në mbrojtje dhe realizim të kërkesave të anëtarësisë.



Përfaqësuesit e SBASHK-ut- pjesëmarrës në Konferencën finale në Bruksel, me temën:

“Shkollat si institucione të të mësuarit-partneri social i arsimit të evropës, promovon cilësinë efektive dhe modelet inovative të udhëheqjes në sektorin e arsimit pas pandemisë Covid19”



Nënkryetarja e SBASHK-ut, Vjollca Shala dhe sekretari i Përgjithshëm, Ymer Ymeri, kishin marrë pjesë po ashtu në Konferencën finale në Bruksel me temën “Shkollat si institucione të të mësuarit-partneri social i arsimit të evropës, promovon cilësinë efektive dhe modelet inovative të udhëheqjes në

SBASHK, pjesë e aktivitetit të Sindikatave të Arsimit të Evropës në Irlandë

Unioni i Sindikatave të Arsimit të Evropës që numëron 11 milionë anëtarë, kishte zhvilluar një aktivitet të rëndësishëm sindikal me temën kyçe “Sindikatat e arsimit mbështesin përfshirjen e refugjatëve dhe emigrantëve në arsim”.



Në këtë tryezë në mesin e 64 përfaqësuesve sindikalë nga e tërë Evropa, kishin marrë pjesë edhe përfaqësuesit e SBASHK-ut, nënkryetarja Vjollca Shala dhe sekretari i Përgjithshëm, Ymer Ymeri, të cilët kishin prezantuar përvojat e shkëlqyera të mësimitdhënësve të Kosovës, të cilët pas dëbimit me dhunë të popullatës së Kosovës nga

sektorin e arsimit pas pandemisë Covid19”.



Qëllimi i konferencës ishte diskutimi mbi gjendjen e institucioneve arsimore pas pandemisë Covid19, dhe hapat që duhet të ndërmerren me qëllim të përmirësimit të cilësisë në sistemin arsimor, tani më kur kemi mungesë të madhe të numrit të mësimitdhënësve pothuajse në gjithë evropën. Aty ishin paraqitur edhe modele të menaxhimit të inovacionit dhe të menaxhimit të cilësisë në praktikë nga perspektiva e partnerëve social. Nga ky takim ishin nxjerrë edhe rekomandime politike për të ardhmen.

pushtuesi serb, kishin organizuar mësimin në Maqedoni, Shqipëri e Mal të Zi me fëmijët e Kosovës duke bërë që të shërohen sado pak plagët dhe traumat e luftës dhe duke bërë të mundur vazhdimin e vitit shkollor, që ishte ndërprerë pas gjithë atyre masakrave e vrasjeve që kishte bërë makineria vrastare e pushtuesit serb kudo në Kosovë.

Prania dhe kontributi i çmuar që SBASHK-u jep në të gjitha aktivitetet sindikale në Evropë e botë dëshmon për përkushtimin që Kosova të prezantohet në mënyrë të denjë dhe për respektin meritore që SBASHK-u gëzon nga Unioni i Sindikatave të Arsimit të Evropës dhe nga Internacionalja Botërore e Arsimit, që numëron 32 milionë anëtarë e të cilat vazhdimisht e kanë përkrahur sindikatën e arsimit të Kosovës për hir të përkushtimit e angazhimit maksimal të saj në mbrojtjen e të drejtave dhe realizimit të kërësive të anëtarësisë.



SBASHK-u në Irlandë kishte marrë pjesë në tryezën "Përmes dhe nëpërmjet arsimit: Sindikatat e Arsimit mbështesin përfshirjen e refugjatëve dhe migrantëve", e cila ishte një iniciativë e rëndësishme që trajton rolin e sindikatave të arsimit në promovimin e përfshirjes së refugjatëve dhe migrantëve përmes sistemit arsimor. Kjo ngjarje ishte zhvilluar në Dublin të Irlandës gjatë muajit janar dhe kishte mbledh përfaqësues nga sindikatat e arsimit të vendeve të ndryshme evropiane për të ndarë përvoja, sfida dhe praktikat më të mira për ndërtimin e një arsimit gjithëpërfshirës.



Në këtë ngjarje kishte marrë pjesë edhe SBASHK-u me dy përfaqësues, të cilët kishin ndarë përvojat e tyre dhe kishin kontribuar në diskutimet për politikën dhe strategjitë që promovojnë barazinë dhe përfshirjen. Pikat kryesore të diskutimit ishin: Strategjitë për mbështetje dhe integrim, Diskutimi mbi qasjet dhe masat që ndihmojnë refugjatët dhe migrantët të përfshihen në mënyrë efektive në sistemin arsimor, duke marrë parasysh sfidat gjuhësore, kulturore dhe sociale.

Në janar SBASHK i përfundoi tri grupe të trajnimit dhe i filloi pesë të reja

Muaji janar në SBASHK kishte filluar me shumë aktivitete me trajnime për mësimdhënës duke përfunduar trajnimet e filluara para vitit të ri 2025, por edhe me grupe të reja të trajnimeve të cilat kishin filluar menjëherë pas festave.

Sapo kishin përfunduar festat zyrtare të Vitit të Ri, SBASHK kishte organizuar testet për mësimdhënësit e Vitisë, të cilët e kishin përfunduar me sukses trajnimin "Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie", derisa gjatë testimit i pranishëm ishte edhe kryetari Rahman Jasharaj. Testi ishte administruar nga sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri dhe kryetari i Komisionit Statutar, Blendor Shatri, kurse i pranishëm ishte edhe kryetari i NSKAP-it për Viti, Kemajl Bislimi dhe trajneri Musli Neziri. Në Viti, për vizitë kishte qëndruar edhe kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj, i cili e kishte përcjellë nga afër mbarëvajtjen e testit dhe ishte informuar nga afër me kërkesat e mësimdhënësve.



Politikat për barazi dhe përfshirje: Identifikimi i politikave që mundësojnë trajtimin e të gjithë nxënësve në mënyrë të barabartë dhe krijimin e mjediseve të sigurta dhe mbështetëse për të gjithë.

Roli i sindikatave: Analiza e mënyrave se si sindikatat mund të ndikojnë në mbrojtjen e të drejtave të refugjatëve dhe migrantëve, duke u bërë zëdhënës për përfshirjen dhe trajtimin e drejtë në arsim.

Pjesëmarrja e SBASHK-ut në këtë tryezë ishte një mundësi e rëndësishme për të forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar dhe për të ndarë përvojat nga Kosova në drejtim të mbështetjes dhe përfshirjes së refugjatëve dhe migrantëve në arsim.



SBASHK kishte organizuar testin edhe për një grup të mësimdhënësve të Drenasit, të cilët e kishin përfunduar trajnimin në programin "Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie". Testi në Drenas ishte mbajtur

nga sekretari i Përgjithshëm i SBASHK-ut, Ymer Ymeri së bashku me zyrtaren Afërdita Ahmeti. Ndërkohë i pranishëm ishte edhe kryetari i NSKAP-it për këtë komunë, Ilaz Dervishi si dhe trajnerja e përzgjedhur nga SBASHK, Arbenita Gashi.



Gjatë muajit të parë të këtij Viti, SBASHK kishte filluar edhe me katër grupe tjera të trajnimeve, ku në programin “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje të dialogut social”, dy grupe kishin filluar në Pejë, me trajnerë Ilir Gashi dhe Addhe Krasniqi dhe një në Gjilan me trajner Rexhep Arifi.



Kurse në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, SBASHK i kishte filluar edhe dy grupe të reja të trajnimit në Pejë, me trajner Burim Krasniqi. Grupet e trajnimit në Pejë i kishte vizituar kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, i cili mësimdhënsve u kishte dëshiruar suksese sa më të larta në ngritjen profesionale, i shoqëruar edhe nga kryetari i NSKAP-it për Pejë, Isuf Lajçi.



Kurse në Gjilan kishte qëndruar kryetari i NSKAP-it për këtë komunë, Blerim Mehmeti, i cili ishte kujdesur nga afër për mbarëvajtjen e trajnimit.

SBASHK nënshkruan marrëveshje në shërbim të anëtarësisë

NSKAP në Malishevë nënshkroi marrëveshje me laboratorin Avicena në këtë komunë

Kryetari i Nivelit Sindikal Komunal të Arsimit Paruniversitar (NSKAP) në Malishevë, Skender Gashi dhe drejtori i AVICENA - KS - SHPK, Amar Shuki, kishin nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi (kontratë për shërbime).

Qëllimi i marrëveshjes ishte që të gjithë mësimdhënësit sindikalist të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut të mund të marrin shërbime laboratorike mjekësore me zbritje prej 20% në Laboratorin “Avicena” në Malishevë.

Kjo marrëveshje kishte hyrë në fuqi prej datës: 20.01.2025, dhe është me afat të pacaktuar.

Me këtë rast, kryetari i NSKAP-it në Malishevë, Skender Gashi, e kishte falënderuar

përzemërsisht drejtorin e Avicena-KS, Amir Shukin, dhe njëherit i kishte ndarë mirënjohje për ofertën dhe nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje bashkëpunuese (Kontratë Marrëveshje).



Kryetari Jasharaj i kishte vizituar mësimdhënësit që po ndiqnin trajnimin në Prishtinë



Kryetari i SBASHK-ut, z. Rrahman Jasharaj, i kishte vizituar mësimdhënësit të cilët kishin filluar ta ndjekin trajnimin "Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie", e që po mbahej në Qendrën Burimore "Përparimi" në Prishtinë.




Jasharaj ishte informuar nga afër me mbarëvajtjen e trajnimit që po zhvillohej në këtë shkollë ku ishin mbajtur dy grupe të trajnimit paralelisht, njëri të shtunën dhe njëri të dielën, nga trajneri i përzgjedhur nga SBASHK, Nexhmedin Gruda.

Jasharaj kishte diskutuar nga afër edhe me mësimdhënësit që po e ndiqnin këtë trajnim në mënyrë që të njiheshin nga afër me problemet, kërkesat dhe shqetësimet që i preokuponin ata si dhe u kishte ofruar mbështetjen e SBASHK-ut si çdoherë.

Në janar të vitit 2025, SBASHK kishte filluar edhe me një grup të ri të trajnimit në Rahovec në programin "Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie" me trajner Skender Gashi, derisa vazhdonin trajnimet e filluara javëve të kaluara në qytete të ndryshme si Podujevë, Prizren, Pejë, Gjiilan, Klinë e Fushë-Kosovë.

Në Viti u mbajt testi për një grup të mësimdhënësve

Në kuadër të trajnimeve për mësimdhënës, SBASHK gjatë muajit shkurt kishte organizuar edhe testin për mësimdhënësit të cilët e kishin përfunduar trajnimin në programin, "Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie".



Testi ishte administruar nga sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri dhe zyrtarja Nezafete Jakupi. Ndërsa trajnimi ishte udhëhequr nga trajneri i përzgjedhur nga SBASHK, Musli Neziri.



Me trajnime SBASHK ka vazhduar gjatë muajit shkurt ku kishin filluar dhe zhvilluar 21 grupe të trajnimit gjithsej.

SBASHK të shtunën e 22 shkurtit kishte filluar me nëntë grupe të trajnimit në programet "Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie" dhe "Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social" në disa komuna të Kosovës si Prishtinë, Gjakovë,

Klinë, Fushë-Kosovë, Pejë, Malishevë e Rahovec.

Nëkuadërtëprogramit“Applikimi i Programeve Kompjuterike në Mësimdhënie”,



Tri grupe të trajnimit ishin mbajtur në Prishtinë, nën udhëheqjen e trajnerëve Nexhmedin Gruda dhe Arben Zymeri.



Grupet e trajnimit ishin vizituar nga Sekretari i Përgjithshëm i SBASHK-ut, Ymer Ymeri, i cili kishte bashkëbiseduar me pjesëmarrësit lidhur me përvojat e tyre gjatë trajnimeve, rëndësinë e përvetësimit të aftësive digjitale në mësimdhënie dhe çështje të tjera me interes për anëtarësinë e SBASHK-ut. Ai kishte theksuar se ky program synon të fuqizojë mësimdhënësit me njohuri praktike, duke i pajisur ata me mjete që lehtësojnë procesin mësimor dhe rrisin efikasitetin e tyre në klasë.



Dy grupe të trajnimit kishin filluar gjatë muajit shkurt edhe në Klinë në programin “Applikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” me trajner Fejzullah Berisha. Derisa në Gjakovë ishte mbajtur

një grup i trajnimit për mësimdhënës të kësaj komune, në programin “Applikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” me trajneren e përcaktuar nga SBASHK, Litvana Spahija.

Një grup i trajnimit gjatë shkurtit ishte mbajtur edhe në Malishevë në programin



“Applikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” me trajner Albert Samadraxha si dhe një grup në programin e njëjtë në Fushë-Kosovë, me trajner Blerona Ahmeti.



Ndërkohë, dy grupe të trajnimit gjatë muajit shkurt ishin mbajtur në Pejë në programin “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social” me trajnerët e përcaktuar nga SBASHK: Addhe Krasniqi dhe Ilir Gashi si dhe një grup në programin e njëjtë në Rahovec, me trajner Gani Kryeziu.



Gjatë muajit shkurt po ashtu kishin filluar dy grupe të trajnimit në Podujevë në programin “Applikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, me trajner Kadri Hyseni.



Paraprakisht, SBASHK kishte filluar edhe me 9 grupe tjera të trajnimit në fillim të muajit shkurt, derisa kishte organizuar testet për dy grupe të mësimdhënësve.



Po ashtu gjatë këtij muaji kishte filluar me katër grupe të trajnimit në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” në Prizren, me trajnerët e përzgjedhur nga SBASHK: Arton Ajeti, Ermal Ahmetaj, Naser Kastrati dhe Nexhat Maçkaj si dhe një grup në programin “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social” me trajnere Arlinda Lamaj.



Në Podujevë më 1 dhe 2 shkurt 2025 kishin filluar edhe dy grupe të trajnimit në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” me trajner Kadri Hyseni, derisa një grup i trajnimit kishte nisur në programin “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social” me trajnere Nora Haliti.



Po ashtu në fillim të muajit shkurt, në Gjilan kishin filluar dy grupe të trajnimit në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” me trajnere Ibadete Limani kurse në Rahovec ishte mbajtur një grup i trajnimit po ashtu në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, me trajnerin e përzgjedhur nga SBASHK, Skender Gashi.

SBASHK u përfaqësua në trajnimin e rëndësishëm të ETUI-ETUCE në Bruksel!



Më 20 dhe 21 shkurt 2025, në Bruksel ishte zhvilluar trajnimi i përbashkët i Institutit të Sindikatave Evropiane (ETUI) dhe Komitetit të Bashkimit Evropian për Arsimin (ETUCE) me temën "Ndikimi i teknologjive

të IA-së në barazinë dhe përfshirjen në arsim".

SBASHK ishte i pranishëm në këtë ngjarje të rëndësishme, duke kontribuar krahas të gjitha sindikatave nga shtetet evropiane.

Ky trajnim kishte sjell diskutime mbi rolin e Inteligjencës Artificiale në arsim, sfidat që sjell për mësimdhënësit dhe nxënësit, si dhe strategjitë

sindikale për të siguruar një arsim gjithëpërfshirës dhe të drejtë.

Pjesëmarrja e SBASHK-ut në këtë trajnim nënvizon angazhimin për një arsim cilësor dhe mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve të arsimit në Kosovë.



SBASHK pjesë e rëndësishme e diskutimeve evropiane për barazinë në arsim!

SBASHK gjatë muajit shkurt po ashtu kishte marrë pjesë në takimin e Komitetit të Përhershëm për Barazi të ETUCE-së në Bruksel, e ku kishin marrë pjesë 47 përfaqësues të vendeve të ndryshme nga Evropa.



SBASHK ishte përfaqësuar nga sekretari i Përgjithshëm, Ymer Ymeri, i cili kishte kontribuar përkrah përfaqësuesve të shteteve evropiane në diskutime të rëndësishme mbi barazinë, përfshirjen dhe të drejtat e mësimdhënësve dhe nxënësve. Ky ishte një moment i rëndësishëm që dëshmoi se Kosova ka zërin e saj të barabartë në tryezat evropiane të arsimit, duke ndikuar në politikat që sigurojnë një sistem arsimor më të drejtë dhe gjithëpërfshirës për të gjithë. SBASHK vazhdon të jetë zë i fuqishëm për mësimdhënësit e Kosovës në nivel ndërkombëtar! Gjatë ditës së parë të takimit të përhershëm të ETUCE-së për barazinë, ishin diskutuar disa tema të ndryshme si: Barazia gjinore dhe përfshirja në arsim – Strategjia për të adresuar pabarazitë dhe diskriminimin në shkolla dhe institucione arsimore, kushtet e punës dhe të drejtat e mësuesve në Evropë – Politikat për pagë të barabartë, sigurina në vendin e punës dhe bilancin punë-jetë.



Digjitalizimi dhe barazia në arsim – Si të sigurohet që teknologjia të përdoret për të promovuar përfshirjen dhe jo për të thelluar hendekun arsimor etj. Po ashtu, gjatë këtij diskutimi ishte propozuar të hartohet një "Udhëzues mbi Politikën e Barazisë dhe Përfshirjes në Arsim", dokument ky që përmban rekomandime të qarta për hartimin dhe zbatimin e politikave të barazisë në sistemin arsimor, përfshirja e mekanizmave për mbrojtjen nga diskriminimi, trajnime për mësuesit dhe masa për një ambient më gjithëpërfshirës në shkolla.

Gjatë kësaj tryeze ishte diskutuar edhe dobia e bazave online të praktikave të mira dhe mënyra se si mund të përmirësohet një gjë e tillë. Në diskutim ishte konkluduar se baza online e praktikave të mira është e dobishme, por mund të përmirësohet duke shtuar raste konkrete nga vende të ndryshme, për të mësuar nga përvojat më të mira, duke krijuar një sistem filtrimi për praktikat e mira sipas vendit, llojit të shkollës dhe fushës së barazisë si dhe duke shtuar burime dhe modele të politikave që mund të përdoren drejtpërdrejt nga sindikatat dhe shkollat.

Po ashtu në takimin e ETUCE-së ku kishin marrë pjesë 47 pjesëmarrës nga shtete të Evropës, ishte shtruar nevoja për organizimin e një seminari online me temën "Përfshirja e grupeve të marginalizuara në arsim", i cili do të ishte shumë i vlefshëm për Kosovën dhe Shqipërinë, e që do të mbahej me mbështetjen e Komitetit të Përhershëm.

SBASHK gjatë muajit shkurt ishte përfaqësuar edhe në Barcelonë të Spanjës në punëtorinë trajnuese "Your Turn 2: Teachers for Trade Union Renewal" – "Radha Juaj 2: Mësimdhënësit për Rinovimin e Sindikatave" e cila ishte mbajtur më 25 dhe 26 shkurt 2025, nën organizimin e Komitetit Evropian të Sindikatave të Arsimit (ETUCE).



Në këtë ngjarje kishin marrë pjesë sindikatat anëtare të ETUCE-së nga e gjithë Evropa, përfshirë edhe përfaqësuesit e SBASHK-ut, nënkryetaren Vjollca Shala dhe sekretarin e Përgjithshëm Ymer Ymeri.



Gjatë kësaj punëtorie, pjesëmarrësit kishin diskutuar mbi përvojat dhe strategjitë për fuqizimin e sindikatave të arsimit, rikthimin e tyre

në qendër të vendimmarrjes dhe mbrojtjen më të mirë të të drejtave të mësimdhënësve. Përfaqësuesit e SBASHK-ut kishin ndarë përvojat e Kosovës në organizimin sindikal, sfidat e sektorit të arsimit dhe hapat që duhen ndërmarrë për një përfaqësim më të fuqishëm sindikal.

Urimi i SBASHK-ut për Ditën e Pavarësisë së Kosovës

Urime 17 vjetori i Pavarësisë së Kosovës



Kolege e kolegë që nga çerdhet e deri në universitete, urime ditën e pavarësisë së shtetit tonë. Në çdo 17 shkurt lartësojmë kujtimin për luftëtarët e lirisë dhe për pishtarët e dijes që me nga sublime i sollën lirinë dhe pavarësinë atdheut tonë. SBASHK ua uron këtë festë të madhe punëtorëve të arsimit, policisë e ushtrisë, mantelbardhëve, punëtorëve të administratës dhe gjithë të punësuarve në sektorin publik dhe në sektorin privat.

Gëzuar!

Festa e gëzime paçi gjithonë.

SBASHK gjatë muajit mars organizoi dhjetëra grupe të trajnimit në mbarë Kosovën

Jasharaj vizitoi mësimdhënësit të cilët ndoçën trajnimin në Prishtinë

Edhe gjatë muajit mars SBASHK kishte vazhduar me organizimin e trajnimeve për mësimdhënësit në dy programe të ndryshme të trajnimit: “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” dhe “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social”.



Gjatë muajit mars, SBASHK kishte organizuar 14 grupe të trajnimit, një në programin “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social” dhe 13 në atë “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”.

Në Rahovec ishte mbajtur një grup i trajnimit në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, duke filluar nga 1 marsi 2025, i cili ishte udhëhequr nga trajneri i përzgjedhur nga SBASHK, Ermal Ahmetaj.



Mësimdhënësit në Rahovec ishin vizituar edhe nga nëkryetarja e SBASHK-ut, Vjollca Shala dhe kryetari i NSKAP-it për Rahovec, Veli Morina.



Ndërkohë, gjatë këtij muaji ishin mbajtur dy grupe të trajnimit në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” në Klinë, me trajnerin e përcaktuar nga SBASHK, Fejzullah Berisha. Ndërkohë, në Malishevë ishte organizuar trajnimi në të njëjtin program me trajnerin e përzgjedhur nga SBASHK-u, Albert Samadraxha.



Mësimdhënësit ishin shprehur mirënjohës për mundësinë e ofruar nga SBASHK, duke ndjekur trajnime të cilat për ta janë të nevojshme për avancim por edhe ishin shprehur të gatshëm të rrisin njohuritë e tyre profesionale në fushën e arsimit.



Në kuadër të përpjekjeve për ngritje profesionale të mësimdhënësve, në Gjakovë gjatë muajit mars, SBASHK kishte mbajtur një grup të trajnimit po ashtu në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, me trajnerin e përzgjedhur nga SBASHK, Litvana Spahija. Kurse në Suharekë, gjatë muajit mars ishin mbajtur katër grupe të trajnimit në programin “Aplikimi i programeve

kompjuterike në mësimdhënie”, me trajnerët e përcaktuar nga SBASHK, Bahrije Elshani, Skender Gashi dhe Emin Hoxha, i cili i kishte mbajtur paralelisht dy grupe të trajnimit me mësimdhënës.



Edhe në komunën e Dragashit gjatë këtij muaji ishte organizuar një grup i trajnimit në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, me trajner Vloran Krasniqi.



Ndërkohë, dy grupe të trajnimit ishin mbajtur gjatë muajit mars në Ferizaj në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, me trajnerët e përcaktuar nga SBASHK, Xhemil Halili dhe Arsim Qalaj.

Edhe në Lipjan gjatë këtij muaji ishte mbajtur trajnimi në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” me trajner Idriz Sopa, kurse në Shtime dhe Gjilan kishte filluar nga një grup i trajnimit në programin e njëjtë, me trajner, Ferid Shaqiri, respektivisht Musli Neziri.



Gjatë muajit mars 2025, SBASHK kishte organizuar edhe një mori testesh për mësimdhënësit të cilët e kishin ndjekur dhe përfunduar me sukses trajnimin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”.

Nën administrimin e sekretarit të Përgjithshëm të SBASHK-ut, Ymer Ymeri dhe nënkryetares Vjollca Shala, testet ishin zhvilluar në Suharekë, në një atmosferë profesionale dhe të organizuar, duke vlerësuar njohuritë dhe aftësitë e fituara nga pjesëmarrësit gjatë trajnimit.

Trajnimi ishte mbajtur nga trajnerët Skender Gashi dhe Bahrije Elshani dhe ka pasur për synim të pajisë mësimdhënësit me aftësi të avancuara në përdorimin e teknologjisë në procesin e mësimdhënies. SBASHK vazhdon të organizojë këto trajnime si pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme për të përmirësuar cilësinë në arsim dhe për të ndihmuar mësimdhënësit të jenë më të përgatitur për sfidat e mësimdhënies moderne.

Ky aktivitet është një dëshmi e përkushtimit të SBASHK-ut për zhvillimin profesional të mësimeve dhe për avancimin e sistemit arsimor në Kosovë.



Në kuadër të këtij qëllimi, edhe në Gjilan ishin mbajtur testet për dy grupe të mësimeve në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësime”, nën administrimin e sekretarit të Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri, ku trajnere ishte Ibadete Limoni.



Gjatë vikendeve të këtij muaji, nën administrimin e nënkrytares së SBASHK-ut, Vjollca Shala dhe zyrtarit ligjor Blendor Shatri, ishin mbajtur testet edhe për mësime në Gjakovë, të cilët e kishin përfunduar me sukses trajnimin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësime”, me trajneren e përcaktuar nga SBASHK, Litvana Spahija.

Testi për një grup të mësimeve që ishte udhëhequr nga trajneri Albert Samadraxha ishte mbajtur edhe në Malisheve si dhe në Rahovec, ku trajneri i përcaktuar nga SBASHK ishte Ermal Ahmetaj.

SBASHK në Podujevë kishte mbajtur testet për dy grupe të mësimeve kurse kishte shpërndarë certifikatat për tri grupe të mësimeve të cilët i kishin përfunduar më parë trajnimet. Testet në Podujevë ishin administruar nga sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri dhe zyrtarja Nezafete Jakupi, derisa udhëheqës i trajnimit me katër grupe të mësimeve në Podujevë, ishte trajneri Kadri Hyseni.



Në Podujevë ishin shpërndarë edhe certifikatat për tri grupe të mësimeve të cilët i kanë përfunduar gjatë muajit shkurt trajnimet: dy në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësime”, me trajner Kadri Hyseni dhe një grup i certifikatave në programin “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social”, me trajnere Nora Haliti.



Gjatë muajit mars SBASHK kishte mbajtur edhe një grup të trajnimit në programin “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social” në komunën e Rahovecit, i cili ishte udhëhequr nga trajneri i përzgjedhur nga SBASHK, Gani Kryeziu.



Testet për mësime gjatë këtij muaji ishin mbajtur edhe në Prishtinë ku trajner ishte Arben Zymeri dhe Fushë-Kosovë, me trajnere Blerona Ahmeti. Testet në këto dy grupe ishin administruar nga sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri si dhe zyrtarja Afërdita Ahmeti.



SBASHK uron 7 Marsin, Ditën e Mësuesit



Të dashur mësimdhënës,

Me rastin e 7 Marsit, Ditës së Mësuesit, SBASHK-u ju përcjell urimet më të përzemërta dhe mirënjohjen e pakufishme për punën tuaj të palodhur dhe përkushtimin e treguar ndër vite në edukimin e gjeneratave të reja. Falë angazhimit tuaj, sot kemi shumë doktorë shkencash, mjekë, juristë, gjykatës, prokurorë dhe profesionistë të shumtë në fusha të ndryshme, të cilët kontribuojnë në zhvillimin e shoqërisë sonë.

Në veçanti, dëshirojmë të nderojmë kontributin tuaj gjatë viteve të vështira 1990-1999, kur, përballë sfidave të mëdha, u dëbuan nga shkollat dhe mbetët pa paga. Megjithatë, ju vazhduat misionin tuaj fisnik pa u ndalur as edhe një ditë, duke edukuar brezat e rinj në kushte të vështira. Një numër i konsiderueshëm prej jush iu bashkua radhëve të UÇK-së, duke kontribuar në çlirimin e vendit tonë. Kjo datë korrespondon edhe me epopenë e UÇK-së, duke e bërë atë edhe më domethënëse.

Megjithatë, ndjejmë një shqetësim të thellë që shteti ynë aktualisht nuk e njeh plotësisht këtë kontribut të jashtëzakonshëm të viteve '90. Si rezultat, disa nga ju po dilni në pension duke marrë vetëm pensionin e pleqërisë, pa u vlerësuar si duhet me pensionin kontributdhënës që meritoni. SBASHK-u do të vazhdojë të angazhohet për të drejtat tuaja dhe për njohjen e plotë të kontributit tuaj të çmuar.

Edhe njëherë, ju urojmë Ditën e Mësuesit dhe ju falënderojmë për gjithçka që keni bërë dhe vazhdoni të bëni për arsimin dhe shoqërinë tonë.

Me respekt dhe mirënjohje,

SBASHK-u,

7 mars 2025

Udhëheqësit e SBASHK-ut realizuan disa vizita jashtë vendit gjatë muajit mars, takuan udhëheqës të sindikatave evropiane e botërore të arsimit

Përfaqësuesit e SBASHK-ut ishin takuar me udhëheqës të EI-së dhe ETUCE-së

Delegacioni i SBASHK-ut, i përbërë nga nënkryetarja Vjollca Shala dhe sekretari i Përgjithshëm Ymeri Ymeri, në kuadër të vizitave jashtë vendit gjatë muajit mars kishte qëndruar në Bruksel ku kishte takuar Sekretarin e Përgjithshëm të Edukimit Ndërkombëtar (EI), z. David Edwards, të shoqëruar nga Kryetari i ETUCE-së, John MacGabhann. Gjatë këtij takimi kishin diskutuar për mungesën e dialogut social në Kosovë, angazhimin e vazhdueshëm të SBASHK-ut për mbrojtjen dhe promovimin e anëtarësisë, si dhe mbështetjen që institucionet EI-së dhe ETUCE-së po u ofrojnë organizatave anëtare, duke përfshirë edhe SBASHK-un.

Edwards kishte përgëzuar SBASHK-un për punën e rëndësishme në Kosovë, duke theksuar pjesëmarrjen aktive në takimet ndërkombëtare të EI-së dhe ato evropiane të ETUCE-së, ku instituti ka dhënë kontribut në çështje kyçe. Ai kishte ripërsëritur angazhimin e EI-së dhe kishte theksuar se do të mbetet gjithmonë krah i SBASHK-ut për të siguruar përfaqësim në çdo forum, si në nivel botëror ashtu edhe në atë evropian, duke bashkëpunuar në fushatën për mbrojtjen e arsimit publik në Kosovë.

Delegacionin e SBASHK-ut e kishte pritur edhe një takim në zyrën e tij, Drejtori i ri i ETUCE-se, Jelmer Evers, ku kishin diskutuar për fillimin e punës së tij. Në këtë rast, ishte shprehur edhe mbështetja e SBASHK-ut për aktivitetet që po ndërmerren në përkrahje të anëtarësisë, si dhe për mundësinë që, sa më e afërt të jetë e mundur, të vizitohet Kosova. Delegacioni i SBASHK-ut e kishte falënderuar Edwards për mbështetjen që EI i ka ofruar SBASHK-ut edhe përpara viteve '90, dhe sidomos për periudhën e menjëhershme pas luftës, kur u ndërtoshin dhe pajiseshin me infrastrukturë shkollat e para që ishin djegur gjatë konflikteve në Kosovë. Gjithashtu ishte shprehur mirënjohja e përjetshme për Sekretarin e Përgjithshëm të atëhershëm, Fred Van Leeuwen, i cili ka qenë gjithmonë në krah të SBASHK-ut në ditët më të vështira për popullin e Kosovës.



SBASHK përfaqësohet në Takimin e Komitetit të Përhershëm për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor (HERSC) në Bruksel

Po ashtu, udhëheqësit e SBASHK-ut gjatë muajit mars kishin qëndruar në Bruksel ku ishte mbajtur Takimi i Komitetit të Përhershëm për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor (HERSC), i cili ishte hapur nga Kryetari i Komitetit Evropian të Sindikatave të Arsimit (ETUCE), John MacGabhann. Në fjalimin e

tij, ai kishte uruar punë të mbarë anëtarëve të HERSC-it për mandatin e tyre katërvjeçar.



Në këtë takim kishte marre pjesë edhe Drejtori i ETUCE-së, Jelmer Evers, i cili kishte theksuar rëndësinë e bashkëpunimit për avancimin e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor në nivel evropian.

SBASHK-u ishte përfaqësuar në këtë komitet nga nënkryetarja Vjollca Shala, e cila është anëtare e HERSC-it. Gjatë ditës së parë të takimit, komiteti kishte zgjedhur Kryetarin dhe Nënkyetarin e ri të HERSC-it për një mandat katërvjeçar.



Në këtë ngjarje të rëndësishme kishte marre pjesë edhe sekretari i Përgjithshëm i SBASHK-ut, Ymer Ymeri, i cili së bashku me nënkryetarën e SBASHK-ut Vjollca Shala, kishin zhvilluar edhe një takim të veçantë me Sekretarin e Përgjithshëm të Education International, David Edwards. Ky takim kishte për qëllim që të trajtojë çështje kyçe mbi të drejtat e punëtorëve të arsimit dhe zhvillimet e fundit në politikat arsimore ndërkombëtare.

Në kuadër të takimit të HERSC-it ishin diskutuar çështje të rëndësishme për të ardhmen e arsimit të lartë, përfshirë:

- Sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë dhe standardet evropiane
- Politikat e BE-së për financimin e arsimit dhe ndikimi i tyre
- Krizat financiare, kursimet buxhetore dhe efektet e tyre në universitetet publike
- Angazhimi i sindikatave për të kundërshtuar shkurtime dhe për të siguruar investime në arsim
- Fushata "Go Public, Fund Education" e Education International
- Shembuj nga vende të ndryshme mbi ndikimin e politikave financiare në arsimin e lartë

SBASHK vazhdon të mbetet një zë i fuqishëm në mbrojtjen e të drejtave të mësimdhënësve dhe punëtorëve të arsimit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, duke qenë pjesë aktive e vendimmarrjes në politikat arsimore në Evropë.

SBASHK kishte mirëpritur Federatën Sindikale të Arsimit e Shkencës së Shqipërisë, nënshkruan edhe një marrëveshje bashkëpunimi



Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, SBASHK-u gjithashtu kishte mirëpritur udhëheqësit e Federatës Sindikale të Arsimit e Shkencës së Shqipërisë, me të cilët ka lidhur edhe një marrëveshje bashkëpunimi, e cila parasheh ndër të tjera: bashkëpunimin në reformat arsimore, angazhimin për financim të qëndrueshëm të arsimit, harmonizim të politikave dhe objektivave sindikale, bashkëpunim për trajnimin profesional dhe sindikal, dhe disa pika tjera.



Nënkyetarja e SBASHK-ut, Vjollca Shala dhe sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri, së bashku edhe me Kryesinë, fillimisht kishin zhvilluar një takim pune me udhëheqësit e FSASH-së, të cilët ishin mirëpritur në zyrat e SBASHK-ut në Prishtinë.



Kryetari i FSASH-së, Shpetim Brahaj, nënkryetarja Blerina Qemali, sekretari Organizativ, Bashkim Shyle dhe anëtarja e Këshillit Drejtues, Brikela Zeqollari, kishin zhvilluar takim edhe me Këshillin Drejtues të

SBASHK-ut, ku kishin diskutuar mundësitë e bashkëpunimit në fushën e arsimit, në fuqizimin e bashkëpunimit sindikal dhe forcimin e rolit të mësimdhënësve në dy shtetet simotra, për të mbyllur ditën me një darkë të përbashkët ndërmjet delegacioneve të të dyja vendeve.

Në ditën e dytë të vizitës së sindikalistëve shqiptarë, SBASHK-u u kishte organizuar edhe disa takime në Pejë, Prizren e Klinë, ku delegacioni nga Shqipëria ishte takuar me udhëheqësit e Drejtorisë Komunale të Arimit në Pejë, duke u pritur nga drejtori komunal i Arsimit, Naser Gega për të vizituar më pas shkollën Filllore të Mesme të Ulët “Xhemal Kada” në Pejë si dhe udhëheqësit sindikal të komunës së Pejës.




Përfaqësuesit e Sindikatës së Shqipërisë, gjatë rrugës për në Pejë, kishin vizituar shkollën Filllore të Mesme të Ulët, “Azem Bejta” në Klinë, ku ishin pritur nga kolektivi i shkollës, derisa në shkollë, për hir të mysafirëve, kishte shkuar edhe Drejtori i Arsimit të kësaj komune, Qemail Sejdiu.

Pas Pejës, përfaqësuesit e Shqipërisë kishin vizituar edhe shkollën Filllore të Mesme të Ulët “Emin Duraku” në Prizren, ndërsa më pas ishin pritur nga drejtoresha për Arsim në këtë komunë, Luljeta Veselaj Gutaj. Vizita në Kosovë e delegacionit shqiptar ishte përmbyllur me shkollat e Kosovës ku ishin takuar me mësimdhënësit e këtyre institucioneve arsimore.

BASHK gjatë muajit prill kishte organizuar mbi 20 grupe të trajnimit në mbarë Kosovën

Në prill kishin filluar 16 grupe të reja të trajnimit kurse ishin mbajtur testet për 13 grupe tjera që e kishin përfunduar trajnimin



SBASHK gjatë muajit prill kishte organizuar fillimin e 16 grupeve të trajnimit në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” si dhe atë “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social”, në disa komuna të ndryshme të Kosovës.

Gjatë po këtij muaji SBASHK organizoi edhe administrimin e testeve për 13 grupe tjera që e kishin filluar më herët këtë trajnim dhe të cilët e kishin përfunduar në prill.



Vikendin e fundit të prillit SBASHK kishte administruar testet për shtatë grupe të mësimdhënësve të cilët e kishin përfunduar trajnimin në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”. Kurse të dielën kishte organizuar

tri grupe të testimit për mësimdhënësit që e kishin ndjekur trajnimin në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, në Shtime dhe Suharekë.

Në Shtime testi ishte administruar nga nënkryetarja e SBASHK-ut, Vjollca Shala, kurse i pranishëm për ta përcjellur nga afër testin ishte edhe kryetari i NSKAP-it për Shtime, Xhavit Rexhaj. Këtë grup të trajnimit e kishte udhëhequr trajneri i përzgjedhur nga SBASHK, Ferid Shaqiri.



Sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri dhe zyrtarja Nezafete Jakupi i kishin organizuar edhe dy

grupe të testimit në Suharekë, ku trajnerë të përcaktuar nga SBASHK-u ishin Emin Hoxha dhe Skender Gashi. Kurse për ta përcjellur nga afër testin ishte edhe kryetari i NSKAP-it për Suharekë, Nazim Gashi.



Ndërsa, të shtunën e këtij vikendi, sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri së bashku me zyrtarin Ligjor, Blendor Shatri, kishin organizuar testin për një grup të mësimeve në Gjilan ku trajner ishte Xhemil Kastrati dhe një grup me trajnerin e përcaktuar nga SBASHK, Musli Neziri.



Edhe në Viti, sekretari Ymeri dhe zyrtari Ligjor Shatri, kishin mbajtur testin për një grup të mësimeve të cilët e kishin përfunduar modulën e dytë të trajnimit “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësime”, me trajnerin e përzgjedhur nga SBASHK, Musli Neziri. Ndërkohë, në po të njëjtën ditë, nënkryetarja e SBASHK-ut, Vjollca Shala dhe zyrtarja Afërdita Ahmeti, kishin administruar testin në Gjilan për grupin e dytë të mësimeve të cilin e kishte udhëhequr trajneri Xhemil Kastrati.



Teste për mësime të cilët e kishin përfunduar këtë trajnim ishin mbajtur një javë më parë edhe në Ferizaj, ku dy grupe të testimit ishin administruar nga nënkryetarja e SBASHK-ut, Vjollca Shala dhe sekretari i Përgjithshëm, Ymer Ymeri, derisa trajnimet ishin udhëhequr nga trajnerët Arsim Qalaj dhe Xhemil Halili. Gjatë testimit në Ferizaj, mësime ishin vizituar edhe nga kryetari i NSKAP-it për këtë komunë, Fejzullah Vranovci.



Teste për dy grupe të mësimeve të cilët e kishin filluar më parë trajnimin, gjatë muajit prill ishin mbajtur edhe në Klinë, ku dy grupe të mësimeve ishin certifikuar në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësime”. Testet në Klinë ishin administruar nga sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri dhe zyrtari Ligjor, Blendor Shatri, kurse grupet e trajnimit ishin udhëhequr nga trajneri i përcaktuar nga SBASHK, Fejzullah Berisha.



Ndërkohë, po gjatë vikendit të 19 dhe 20 prillit, SBASHK kishte filluar edhe me 14 grupe të reja të trajnimit në programet “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” dhe “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social”.

Në Kaçanik gjatë muajit prill SBASHK kishte filluar me 3 grupe të trajnimit në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, ku trajnimet ishin udhëhequr nga trajnerët e përcaktuar nga SBASHK, Naser Guri dhe Avni Krasniqi.



Gjatë po këtij muaji edhe në Pejë kishin filluar dy grupe të trajnimit, një në programin "Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie" me trajner Burim Krasniqi dhe një grup i trajnimit në programin "Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social", me trajner Ilir Gashi.

Dy grupe të trajnimit kishin filluar edhe në Mitrovicë, një në programin "Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie" me trajner Fejzullah Berisha dhe një grup në programin "Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social", me trajnere Lindita Muja.

Kurse në Podujevë gjatë prillit kishin filluar dy grupe të trajnimit në programin "Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie", me trajner Kadri Hyseni.



Po ashtu me dy grupe të trajnimit kishte filluar edhe Malisheva gjatë muajit prill, ku në programin "Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie", kishte filluar një grup i trajnimit nën udhëheqjen e trajnerit Albert Samadraxha dhe një grup në programin "Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social" me udhëheqje të trajnerit Arben Krasniqi.



Gjatë këtij muaji kishte filluar edhe një grup i trajnimit në Fushë-Kosovë në programin "Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie" me trajnerin e përcaktuar nga SBASHK, Arben Zymeri.



Kurse në Viti ishte mbajtur një grup i trajnimit në programin "Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social", me trajnere Makfirete Zuka.



Po ashtu një grup i trajnimit në programin "Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social", me trajner Gani Kryeziu, gjatë prillit ishte mbajtur edhe në Rahovec.



Ndërkohë, në Gjilan e Viti kishin filluar tri grupe të reja të trajnimit në fillim të këtij muaji në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, ku dy grupe të mësimdhënësve në Gjilan ishin udhëhequr nga trajnerja Ibadete Limani dhe një grup i mësimdhënësve në Viti, nga trajneri Musli Neziri.

SBASHK në prill kishte filluar përgatitjet për pushime në bregdetin shqiptar

SBASHK gjatë muajit prill kishte filluar me përgatitjet për pushimin e anëtarëve në bregdetin shqiptar. Gjatë një takimi me kryetarët e Nivelit Sindikal Komunal të Arsimit Parauniversitar (NSKAP), ishte diskutuar edhe për ecurinë e trajnimeve për mësimdhënësit dhe mbarëvajtjen e zgjedhjeve nëpër Shoqata Sindikale.

Kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj, i kishte përgëzuar udhëheqësit e niveleve komunale të sindikatës për punën e shkëlqyer në shërbim të anëtarësisë në të gjitha drejtimet.

Jasharaj kishte thënë se, punët rreth përgatitjeve për pushimin e mësimdhënësve në bregdetin shqiptar, trajnimet të cilat SBASHK i organizon për anëtarësinë si dhe zgjedhjet sindikale po ecin mirë, andaj kishte kërkuar që të vazhdohet

ky ritëm i punës e përkushtimit në mënyrë që shërbimet për anëtarësinë të jenë sa më cilësore.

Nënkryetarja e SBASHK-ut, Vjollca Shala, kishte thënë se trajnimet për mësimdhënësit anëtar të sindikatës po vazhdojnë me një dinamikë të lartë, ku aktualisht janë duke u zhvilluar mbi 20 grupe të trajnimit njëkohësisht në të gjitha komunat e Kosovës.


Kurse sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri, kishte kërkuar nga udhëheqësit komunal të sindikatës që t'i respektojnë me përpikëri rregullat për dërgimin e pushuesve në bregdetin shqiptar, ku të gjithë pushuesit duhej të zgjedheshin bazuar në krieteret e përcaktuara nga SBASHK-u.

Në takimin online me kryetarët, SBASHK-u e kishte diskutuar edhe ecurinë e zgjedhjeve sindikale të cilat kishin filluar me shoqata sindikale për të vazhduar më pas me komuna dhe deri në zgjedhjen e kryetarit dhe Kryesisë.

Gjatë prillit, lidhur me fillimin e përgatitjeve për pushimin e mësimdhënësve në bregdet, SBASHK kishte mbajtur edhe një takim me kryetarët e nivelit komunal sindikal e të universiteteve.

Në këtë takim, me shumicë votash SBASHK i kishte aprovuar kriteret për përzgjedhjen e pushuesve për këtë vit ku kishin pushuar mbi 400 pushues, derisa ishte vendos që listat të definohen më së largu deri më 31 maj 2025.

SBASHK tradicionalisht organizon pushme 5 ditore për mësimdhënësit anëtar të Sindikatës, ku në mënyrë të organizuar SBASHK e dërgon një numër të caktuar të mësimdhënësve për pushim në shenj simbolike për punën në sektorin e arsimit.



SBASHK u prit nga drejtoresha e Arsimit në Komunën e Obiliqit



Udhëheqësit e SBASHK-ut, nënkryetarja Vjollca Shala dhe sekretari i Përgjithshëm, Ymer Ymeri dhe kryetarja e NSKAP-it për Obiliq, Luljeta Boshnjaku, ishin takuar me drejtoreshën e Drejtorisë Komunale të Arsimit në këtë komunë, Fitore Hashani dhe shefin për Arsim, Rexhep Zeka, në një takim njoftues.

Në këtë takim, përfaqësuesit e SBASHK-ut ishin pritur ngrohtësisht nga drejtoresha e DKA-së, Fitore Hashani, ku ishte diskutuar për mbështetjen institucionale për qështjet që ndërlidhen me arsim, siç është Kontrata Kolektive, organizimi i trajnimeve për mësimdhënësit e kësaj komune dhe bashkëpunimi sindikatë-DKA.

Drejtoresha e DKA-së, Fitore Hashani, në emër të Kryetarit të Komunës dhe DKA-së, kishte shprehur përkushtimin për bashkëpunim të vazhdueshëm

dhe kishte ofruar mbështetje për të drejtat e stafit arsimor në përgjithësi.

Edhe muaji maj ishte intensive sa i përket trajnimeve profesionale për mësimdhënës **SBASHK-u gjatë muajit maj kishte organizuar 17 grupe trajnimi në kuadër të zhvillimit profesional të stafit arsimor**

Në vazhden e përkrahjes së anëtarësisë së vet sa i përket ngritjes profesionale, SBASHK-u gjatë muajit maj kishte organizuar 17 grupe të trajnimit në dy programe të ndryshme: “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” dhe “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social”, nëpër komuna të ndryshme të Kosovës.



Vetëm në vikendin e fundit të majit, 24 dhe 25 maj 2025, SBASHK-u kishte organizuar trajnime në katër komuna të ndryshme të Kosovës. Në Ferizaj ishin mbajtur dy grupe të trajnimit në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” me trajnerët e përcaktuar nga SBASHK-u: Arsim Qalaj dhe Xhemil Halili, derisa një grup i mësimdhënësve e kishin filluar trajnimin në programin “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social”, me trajnerin Emrush Ahmeti.



Mësimdhënësit gjatë trajnimit i kishte vizituar edhe kryetari i NSKAP-it për Ferizaj, Fejzullah Vranovci, i cili ishte interesuar nga afër për mbarëvajtjen e trajnimeve dhe u kishte dëshiruar mësimdhënësve suksese në zhvillimin e tyre profesional.



Në po të njëjtën ditë, me dy grupe të trajnimit kishte filluar edhe Mitrovica ku në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, trajner ishte përzgjedhur Kadri Hyseni, kurse në programin “Forcimi i kapaciteteve efektive për udhëheqje efektive të dialogut social”, trajner i përcaktuar nga SBASHK-u ishte, Muhamet Shala.

Kryetari i NSKAP-it për Mitrovicë, Isa Ismajli, i kishte vizituar mësimdhënësit gjatë fillimit të trajnimeve kurse kishte shprehur gatishmërinë e SBASHK-ut për orgnaizimin e trajnimeve dhe ndihmesën e mësimdhënësve në plotësimin e kriterëve për avancim apo licencim.



Po ashtu me dy grupe të trajnimit, gjatë muajit maj kishte filluar edhe Peja në programet e njëjta të trajnimit ku një grup i trajnimit ishte mbajtur në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” me trajnerin e përcaktuar nga SBASHK, Burim Krasniqi dhe grupi i dytë në programin “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social”, me trajnerin e përzgjedhur nga SBASHK, Ilir Gashi.



Gjatë vikendit të 24 dhe 25 majit, me një grup të trajnimit kishte filluar edhe Drenasi në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie-moduli 2”, i cili ishte udhëhequr nga trajneri i përcaktuar nga SBASHK, Fejzullah Berisha. Mësimdhënësve po ashtu u kishte dëshiruar suksese në karrierë edhe kryetari i NSKAP-it për Drenas, Ilaz Dervishi.

Gjatë muajit maj SBASHK kishte filluar edhe me tetë grupe tjera të trajnimeve në tetë komuna të ndryshme të Kosovës.

Edhe në vikendin e 17 e 18 majit, SBASHK kishte organizuar një grup të trajnimit në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”

në Fushë-Kosovë me trajnerin e përzgjedhur nga SBASHK, Blerona Ahmeti. Mësimdhënësit ishin shprehur falënderues ndaj SBASHK-ut për mundësinë që të ndjekin trajnimet e nevojshme për licencë dhe avancim me mbështetjen e SBASHK-ut. Mësimdhënësit ishin vizituar edhe nga kryetari i NSKAP-it për Fushë-Kosovë, Haki Krasniqi.



Një grup i trajnimit në programin e njëjtë kishte filluar edhe në Malishevë, nën udhëheqjen e trajnerit të përcaktuar nga SBASHK-u, Albert Samadraxha. Edhe mësimdhënësit e Malishevës ishin vizituar nga kryetari i NSKAP-it për këtë komunë, Skender Gashi, derisa ishin shprehur mirënjohës për mundësinë e ofruar nga SBASHK.



Grupi i tretë i trajnimit gjatë këtij vikendi kishte nisur në komunën e Klinës, me trajnerin e përzgjedhur nga SBASHK-u, Nexhmedin Gruda. Mbarëvajtjen e trajnimit e kishte përcjellur kryetari i NSKAP-it për Klinë, Arif Elezaj, i cili u kishte dëshiruar mësimdhënësve arritje sa më të larta në karrierë.

Edhe Gjilani kishte filluar me një grup të ri të trajnimit me trajnerin e përcaktuar nga SBASHK-u, Ibadete Limani, derisa kryetari i NSKAP-it për Gjilan, Blerim Mehmeti, ishte kujdesur për mbarëvajtjen e trajnimit dhe ecurinë e rregullt të tij.

Kurse Obiliqi kishte filluar me një grup të trajnimit në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” me trajnerin e përcaktuar nga SBASHK, Xhelal Krasniqi. Për mbarëvajtjen e trajnimit ishte kujdesur edhe kryetarja e NSKAP-it për Obiliq, Luljeta Boshnjaku, e cila u kishte dhënë mbështetje prej SBASHK-ut mësimdhënësve në përgatitjet e tyre profesionale.



Komuna e Shtimes po ashtu kishte nisur me një grup të ri të trajnimit, ku trajneri Ferid Shaqiri ishte përcaktuar nga SBASHK për udhëheqjen e mësimdhënësve në trajnimin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”.



Derisa komuna e Vitisë kishte nisur një grup të trajnimit në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie-moduli 2”, me trajnerin e përcaktuar nga SBASHK-u, Musli Neziri.



Gjatë kësaj jave kishte filluar një grup i vetëm i trajnimit në programin “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje të dialogut social” në Vushtri, me trajnerin e përcaktuar nga SBASHK, Zahir Kastrati. Kryetari i NSKAP-it për Vushtri, Kadri Hyseni, ishte kujdesur për krijimin e kushteve sa më të përshtatshme për mbarëvajtjen e trajnimit dhe arritje sa më të larta të njohurive nga ana e mësimdhënësve.

Gjithsej gjatë muajit maj SBASHK kishte organizuar 12 grupe të trajnimit në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” dhe 5 grupe në programin “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social”.


Gjatë muajit maj SBASHK-u kishte organizuar edhe testet për disa grupe të mësimdhënësve të cilët trajninin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” e kishin filluar javë më parë dhe e kishin përfunduar të njëjtin me sukses.



Testet për dy grupe të mësimdhënësve ishin mbajtur të dielën e 25 majit në Podujevë, ku trajnimin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” e kishin përfunduar me sukses dy grupe të mësimdhënësve, nën udhëheqjen e trajnerit Kadri Hyseni. Testi ishte administruar nga sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri dhe zyrtarja Afërdita Ahmeti.



Paraprakisht, SBASHK kishte mbajtur testet për tri grupe të mësimdhënësve në Kaçanik dhe një grup në Drenas.



Të dielën e 18 majit SBASHK-u kishte organizuar testet për tri grupe të mësimdhënësve të cilët e kishin përfunduar me

sukses trajnimit në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” në Kaçanik, ku trajnerët e përzgjedhur nga SBASHK-u ishin: Avni Krasniqi dhe Naser Guri si dhe një grup në Drenas në po të njëjtin program të trajnimit, me trajner Fejzullah Berisha.



Testet në Kaçanik ishin administruar nga sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri dhe zyrtarja Nezafete Jakupi.



Kurse testi për një grup të mësimdhënësve në Drenas, ishte administruar nga nënkryetarja e SBASHK-ut, Vjollca Shala dhe zyrtarja Afërdita Ahmeti.

Teste gjatë vikendit paraprak ishin mbajtur edhe në Gjilan e Fushë-Kosovë. Në këtë të fundit testi ishte administruar nga sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri dhe zyrtarja Nezafete Jakupi, kurse në Gjilan nga nënkryetarja e SBASHK-ut, Vjollca Shala dhe zyrtari Ligjor, Blendor Shatri.



Gjatë muajit maj, teste ishin mbajtur edhe në Pejë dhe Malishevë për mësimdhënësit të cilët e kishin ndjekur me sukses trajnimit “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”. Testit në Pejë u ishte nënshtruar një grup i mësimdhënësve i cili ishte udhëhequr nga trajneri Burim Krasniqi, kurse testi ishte administruar nga sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri dhe zyrtarja Nezafete Jakupi.



Ndërsa në Malishevë testi ishte administruar nga nënkryetarja e SBASHK-ut, Vjollca Shala dhe zyrtari Ligjor, Blendor Shatri. Grupi i trajnimit në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” në Malishevë ishte udhëhequr nga trajneri, Albert Samadraxha.



Ndërsa dy grupe të testimit ishin mbajtur në Prishtinë për mësimdhënësit të cilët e kishin filluar javë më parë këtë trajnim, e që e kishin përfunduar me sukses, nën udhëheqjen e trajnerit, Nexhmedin Gruda. Testi ishte administruar nga sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri, zyrtari Ligjor, Blendor Shatri dhe zyrtarja Nezafete Jakupi.



Organizimi i trajnimeve nga SBASHK-u në shërbim të anëtarësisë ka vazhduar gjatë gjithë vitit me kërkesë të shumë mësimdhënësve, e të cilat po u shërbejnë për zhvillim profesional dhe të karrierës.

SBASHK gjatë muajit maj ka organizuar tri kuvende zgjedhore SBASHK vazhdoi me zgjedhjet sindikale gjatë majit, zgjedhjet përfunduan në tri komuna



Gjatë muajit maj, SBASHK-u ka përfunduar zgjedhjet sindikale në disa komuna të Kosovës, derisa ato kishin vazhduar në të gjitha komunat tjera me proces të rregullt dhe demokratik. Zgjedhjet Sindikale gjatë këtij muaji ishin organizuar në Klinë, ku kryetar ishte rizgjedhur Arif Elezaj, kurse nënkryetar, Islam Kalludra.



Të enjten e 29 majit, në Klinë ishte mbajtur Kuvendi Zgjedhor i Nivelit Sindikal Komunal të Arsimit Parauniversitar (NSKAP), ku ishte zgjedhur kryetari, nënkryetari, kryesia e re e NSKAP-it të Klinës, delegatët për Kongresin e SBASHK-ut, si dhe anëtarët për Këshillin Drejtues të SBASHK-ut.



Ky kuvend ishte organizuar në kuadër të zgjedhjeve të rregullta ku në vitin 2025 po mbaheshin zgjedhjet për të gjitha shoqatat sindikale dhe për nivelet komunale, universitare dhe të kulturës që veprojnë në kuadër të SBASHK-ut. Këshilli Drejtues e kishte shpallur këtë vit si vit zgjedhor që në fillim të vitit kalendarik. Procesi zgjedhor në Klinë ishte zhvilluar në mënyrë të rregullt, demokratike dhe pa asnjë pengesë.



Kryetar i NSKAP-it për Klinë ishte rizgjedhur Arif Elezaj kurse nënkryetar, Islam Kalludra.



Më 27 maj zgjedhjet Sindikale ishin mbajtur edhe në Shtërpçë ku ishte zgjedhur kryetari, nënkryetarja dhe organet drejtuese të NSKAP-it.



Ky kuvend ishte organizuar në kuadër të zgjedhjeve të rregullta që në vitin 2025 po mbaheshin zgjedhjet për të gjitha shoqatat sindikale dhe për nivelet komunale, universitare

dhe të kulturës që veprojnë në kuadër të SBASHK-ut. Këshilli Drejtues kishte shpallur këtë vit si vit zgjedhor që në fillim të vitit kalendarik. Procesi zgjedhor në Shtërpçë ishte zhvilluar në mënyrë të rregullt, demokratike dhe pa asnjë pengesë. Nga votimi i fshehtë, ku kishin marrë pjesë edhe kundërkandidatët, kryetar i NSKAP-it për Shtërpçë ishte zgjedhur Avni Shabani, ndërsa nënkryetare Besa Hyseni.



Gjatë këtij muaji, zgjedhjet sindikale kishin përfunduar edhe në Kamenicë, ku ishin rizgjedhur: Kryetar Lulzim Thaqi, nënkryetare Mense Morina dhe organet drejtuese të NSKAP-it.



Gjatë Kuvendit Zgjedhor të Nivelit Sindikal Komunal të Arsimit Parauniversitar (NSKAP), në Kamenicë ishte zgjedhur edhe kryesia e re, delegatët për Kongresin e SBASHK-ut, si dhe anëtarët për Këshillin Drejtues të SBASHK-ut. Procesi zgjedhor në Kamenicë me votim të fshehtë, ishte zhvilluar në mënyrë të rregullt, demokratike dhe pa asnjë pengesë.



Zgjedhjet sindikale ishin mbajtur edhe në Prishtinë, ku në mbledhjen e rregullt të Kuvendit Zgjedhor të Sindikatës Komunale të Arsimit Parauniversitar në Prishtinë, ishin zgjedhur drejtuesit e rinj të kësaj sindikate për mandatin e ardhshëm katërvjeçar. Me shumicë votash, ishte zgjedhur kryetar Qamil Hajdini dhe nënkryetare, Florije Kadriu.



Në këtë kuvend kishin marrë pjesë edhe përfaqësues të lartë të SBASHK-ut, Vjollca Shala – nënkryetare, Ymer Ymeri – sekretar i Përgjithshëm dhe Blendor Shatri – zyrtar ligjor, të cilët kishin përshëndetur punimet e kuvendit, uruar punë të mbarë dhe shprehur mbështetje të plotë për drejtuesit e rinj në misionin e tyre për përfaqësimin dhe mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve të arsimit në Komunën e Prishtinës. Në përputhje me rendin e ditës, fillimisht ishte zgjedhur Komisioni për verifikimin e mandateve dhe numërimin e votave, ndërsa më pas, përmes votimit të fshehtë, ishin zgjedhur kryetari dhe nënkryetarja.



Anëtarët e Kryesisë dhe Komisioni Mbikëqyrës i Sindikatës Komunale do të zgjidhen në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit. Urime të përzemërta të zgjedhurve dhe suksese në përfaqësimin e denjë të punëtorëve të arsimit në kryeqytet!

SBASHK-u mori pjesë në Forumin e Këshillit Ekonomik Social Evropian për Ballkanin Perëndimor



Në Beçiq të Malit të Zi, gjatë muajit maj kishte mbajtur punimet Forumi i 10-të i Shoqërisë Civile të Ballkanit Perëndimor, i organizuar nga Këshilli Ekonomik Social Evropian (KESE), në të cilin kishin marrë pjesë edhe dy përfaqësues të SBASHK-ut: Vjollca Shala, nënkryetare e SBASHK-ut, dhe Ymer Ymeri, sekretar i Përgjithshëm.



Ky forum kishte mbledhë përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe partnerëve socialë nga i gjithë Ballkani Perëndimor, për të diskutuar dhe dhënë kontribut konkret në agjendën evropiane të rajonit përgjatë dy ditëve të 13 dhe 14 majit 2025.



Forum i ishte fokusuar në temat kyçe si: Përhshpejtimi i anëtarësimit në BE për Ballkanin Perëndimor, Roli i shoqërisë civile të organizuar në negociatat e anëtarësimit dhe Plani dhe Instrumenti i Rritjes për Ballkanin Perëndimor – fokusi në bazat, Kontributi i partnerëve socialë dhe organizatave të shoqërisë civile në zbatimin e Planit dhe Instrumentit të Rritjes për Ballkanin Perëndimor – Tregu i Vetëm, Tregtia dhe Marrëveshja e Pastër Industrial dhe Tregu i Përbashkët Rajonal (CRM), nxitja e mjedisit të biznesit, drejtësisë sociale dhe transformimit digjital, Kontributi i partnerëve social dhe organizatave të shoqërisë civile në zbatimin e Shtyllës Evropiane të të Drejtave Sociale në Ballkanin Perëndimor - më shumë dhe më mirë vende pune dhe zhvillimi i aftësive dhe mbrojtja sociale, barazia dhe përfshirja.



SBASHK-u, përveç angazhimit të vazhdueshëm për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të punëtorëve të arsimit në Kosovë, kishte dhënë kontributin e vet edhe në avancimin e agjendës evropiane nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në platformat rajonale dhe evropiane siç është KESE. Përmes këtij angazhimi,

SBASHK-u synon të japë zërin e punëtorëve të arsimit në procesin e integritetit evropian dhe të kontribuojë që edhe Kosova të jetë pjesë e Bashkimit Evropian, me një shoqëri më të drejtë, më të barabartë dhe më të zhvilluar për të gjithë.



Muaji qershor i këtij viti, krahas angazhimeve të shumta në SBASHK, kishte sjellë edhe pak qetësi dhe relaks tek punonjësit arsimor. Gjatë këtij muaji SBASHK kishte dërguar mbi 400 mësimdhënës në bregdetin shqiptar, duke u ofruar një pushim prej 6 ditësh me kolegët arsimor.

Në shenjë vlerësimi dhe respekti për ta, SBASHK kishte dërguar në bregdet mbi 400 mësimdhënës



Në organizimin e Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), edhe këtë qershor ishte organizuar pushimi veror për mësimdhënësit-anëtar të Sindikatës, të cilët ishin nderuar nga SBASHK-u për përkushtimin, punën dhe kontributin e tyre shumëvjeçar në arsimimin dhe edukimin e brezave. Grupin e parë dhe të dytë të mësimdhënësve të cilët kishin udhëtuar drejt bregdetit në gjysmën e dytë të muajit qershor, i kishte vizituar edhe kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj.



Në të dy takimet, Jasharaj kishte mundësi të bisedojë nga afër me pushuesit të cilët ishin shprehur shumë mirënjohës për organizimin e shkëlqyer dhe për kujdesin që SBASHK-u po vazhdon të tregojë ndaj

anëtarëve të vet. Mësimdhënësve, Jasharaj u kishte uruar pushime të mbara, plot relaks dhe përjetime të këndshme gjatë gjithë qëndrimit të tyre.



krijuar atyre mundësi për relaks dhe rifreskim pas një viti të ngarkuar pune. Organizimi i tyre ishte një tjetër konfirmim se SBASHK-u është gjithmonë pranë anëtarëve të vet — jo vetëm në mbrojtjen e të drejtave të tyre, por edhe në kujdesin për mirëqenien dhe jetën e tyre.



Ky aktivitet i cili kishte filluar me grupin e parë prej 130 pushuesve, grupin e dytë prej 104 pushuesve, kishte vazhduar edhe me grupin e tretë dhe të fundit prej 210 mësimdhënësve të cilët kishin qëndruar në bregdetin shqiptar gjatë verës 2025.

Sikurse çdo vit, edhe këtë herë SBASHK kishte përfshirë në këtë aktivitet anëtarë nga mbarë vendi, përfshirë edhe katër bashkëkombës nga Bujanoci. Pushimi kishte zgjatur gjashtë ditë. Derisa përzgjedhja e pjesëmarrësve ishte bërë nga shoqatat sindikale në bazë të kriterëve të përcaktuara nga Këshilli Drejtues i SBASHK-ut.



Kryetari i SBASHK-ut, z. Rrahman Jasharaj, ishte shprehur krenar që ky aktivitet po vazhdon sepse është shprehje e mirënjohjes për angazhimet e vazhdueshme e maksimale të këtyre pushuesve në shërbim të arsimit dhe kulturës.



SBASHK edhe në qershor vazhdoi aktivitetin sindikal në shërbim të anëtarësisë-organizoi 3 grupe të trajnimit



Në vazhden e angazhimeve për ofrimin e shërbimeve dhe mbështetjes për mësimdhënësit-anëtar të SBASHK-ut, Sindikata kishte vazhduar me ofrimin e trajnimeve pa pagesë për anëtarët e vet anë e kënd Kosovës. Edhe gjatë muajit qershor kishin vazhduar grupe të shumta të trajnimeve të cilat kishin filluar më parë, ku shumica ishin kurorëzuar edhe me testet përfundimtare dhe shpërndarjen e certifikatave për mësimdhënësit e suksesshëm në këto trajnime.



Të mërkurën e 25 qershorit SBASHK kishte filluar me dy grupe të trajnimit në Prishtinë në programin “Aplikimi i Programeve kompjuterike në mësimdhënie”, me trajnerët e përzgjedhur: Arben Zymeri dhe Blerona Ahmeti.

Mësimdhënësit të cilët e kishin filluar trajnimin i kishte vizituar edhe kryetari i NSKAP-it për Prishtinë, Qamil Hajdini, i cili kishte shprehur përkushtimin e madh për krijimin e kushteve sa më të mira për mësimdhënësit të cilët ishin të interesuar për t'i ndjekur këto trajnime. Ditë më parë, një grup i trajnimit kishte filluar edhe në Vushtrri në programin “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social” me trajner Zahir Kastrati.



Ndërkohë, gjatë muajit qershor ishin organizuar edhe një numër testesh për mësimdhënësit të cilët e kishin përfunduar me sukses trajnimin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, ku testi është pjesë përfundimtare e trajnimit.



Në Pejë, më 15 qershor ishte mbajtur testi për një grup të mësimitdhënësve të cilët e kishin ndjekur këtë trajnim, derisa ishte administruar nga sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri dhe zyrtari Ligjor, Blendor Shatri.



Gjatë testimit të mësimitdhënësve, i pranishëm ishte edhe kryetari i NSKAP-it për Pejë, Isuf Lajqi si dhe trajneri që kishte udhëhequr këtë grup, Burim Krasniqi.



Po ashtu, në të njëjtën ditë test ishte organizuar edhe në Viti për një grup të mësimitdhënësve të cilët e kishin ndjekur trajnimin nën udhëheqjen e trajnerit Musli Neziri.



Testi ishte administruar nga nënkryetarja e SBASHK-ut, Vjollca Shala dhe zyrtarja Afërdita Ahmeti. Ndërkohë, për ta përcjellur mbarëvajtjen e trajnimit, i pranishëm ishte edhe kryetari i NSKAP-it për Viti, Kemajl Bislimi.



Të dielën e 15 qershorit, po ashtu Kryesia e SBASHK-ut kishte mbajtur një mbledhje online nën udhëheqjen e Kryetarit Rrahman Jasharaj, ku ishte biseduar për aktivitetet e SBASHK-ut, për përgatitjet për pushime dhe ishin marrë disa vendime.

Gjatë gjysmës së parë të qershorit ishin organizuar testet edhe për dy grupe të mësimitdhënësve të cilët e kishin përfunduar më parë trajnimin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimitdhënie”, në Malishevë dhe në Klinë.



Në Malishevë testi ishte administruar nga nënkryetarja e SBASHK-ut, Vjollca Shala, derisa i pranishëm ishte edhe kryetari i NSKAP-it për këtë komunë, Skender Gashi.



Kurse trajnimi ishte udhëhequr nga trajneri i përcaktuar nga SBASHK, Albert Samadraxha.



Edhe në Klinë ishte testuar një grup i mësimehënësve të cilët e kishin ndjekur po të njëjtin trajnim, derisa trajneri i përcaktuar nga SBASHK, Nexhmedin Gruda e kishte udhëhequr këtë grup të trajnimit.



Edhe në Klinë i pranishëm ishte kryetari i NSKAP-it, Arif Elezaj kurse testi ishte administruar nga nënkryetarja e SBASHK-ut, Vjollca Shala.



Ndërkohë, qysh në javën e parë të qershorit ishin mbajtur testet edhe për tri grupe tjera të mësimehënësve, në Fushë-Kosovë, Obiliq e Shtime.



Të dielën e 8 qershorit ishin mbajtur testet për dy grupe të mësimehënësve të cilët e kishin përfunduar me sukses trajnimin në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimehënie” në Fushë-Kosovë dhe Obiliq.



Testet ishin administruar nga sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri, derisa trajnimet ishin udhëhequr nga trajnerët e përcaktuar nga SBASHK-u, Blerona Ahmeti, respektivisht Xhelal Krasniqi.



Një ditë më parë ishte mbajtur testi edhe për mësimehënësit e Shtimes, nën udhëheqjen e sekretarit të Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri, derisa trajnimi në këtë komunë ishte udhëhequr nga trajneri i përcaktuar nga SBASHK, Ferid Shaqiri.



SBASHK mori pjesë në Konferencën Evropiane për Shëndetin Mendor dhe Rreziqet Psikosociale në Arsim



SBASHK edhe gjatë muajit qershor ishte përfaqësuar në konferencën e aktiviteteve të ndryshme ndërkombëtare arsimore, përmes udhëheqësve të lartë të Sindikatës. Më 17-18 qershor 2025 në Bruksel ku ishte mbajtur Konferenca e Partnerëve Social Evropian me temën “Shëndeti mendor në punë dhe rreziqet psikosociale në arsim”, e organizuar nga ETUCE dhe EFEE, SBASHK-u ishte përfaqësuar nga nënkryetarja, Vjollca Shala dhe sekretari i Përgjithshëm, Ymer Ymeri. Kjo konferencë ishte si përmbyllje e një pune dyvjeçare, që kishte përfshirë edhe një hulumtim të gjerë mbi mirëqenien në vendin e punës në sektorin e arsimit, pas ndikimeve të pandemisë COVID-19.



Përgjatë dy ditëve, sindikatat e arsimit dhe punëdhënësit ishin mbledhur për konferencën përfundimtare



të projektit APRES COVID, të bashkëorganizuar nga ETUCE dhe EFEE. Nën temën “Shëndeti Mendor në Punë dhe Rreziqet Psikosociale në Arsim”, eventit dyditor kishte mbledhur së bashku palët e interesuara të arsimit, studiuesit, politikëbërësit e BE-së dhe edukatorët për të eksploruar se si dialogu social mund të nxisë përmirësime sistemike në kushtet e punës dhe shëndetin mendor të mësuesve, akademikëve dhe stafit të arsimit në të gjitha nivelet e arsimit.

Jelmer Evers, Drejtor i ETUCE, dhe Paddy Lavelle, zëvendës-president i EFEE, kishin hapur konferencën duke theksuar rëndësinë e rreziqeve psikosociale në punën e përbashkët të dialogut social evropian në arsim, mes kompleksiteteve në rritje shoqërore dhe në klasë dhe pritjeve në rritje mbi sektorin e arsimit dhe edukatorët. Konferenca kishte ofruar një platformë për të ndarë njohuritë kërkimore, praktikat kombëtare dhe strategjitë e përbashkëta për të siguruar mjedise arsimore të sigurta, mbështetëse dhe të shëndetshme.



Gjatë gjithë aktivitetit dy-ditor, pjesëmarrësit kishin shqyrtuar ndërveprimin midis kushteve të punës dhe mirëqenies në punë, implikimet e dixhitalizimit dhe inteligjencës artificiale, si dhe strategjitë për të luftuar dhunën dhe ngacmimin në mjediset arsimore. Konferenca kishte përfunduar me një diskutim në panel me vizion, duke riafirmuar

angazhimin e partnerëve socialë evropianë për të vazhduar avokimin për mjedise pune të denja, të shëndetshme dhe të qëndrueshme në arsim.

SBASHK pjesëmarrës në Konferencën e 113-të Ndërkombëtare të Punës të ILO-së në Gjenevë



Në fillim të muajit qershor SBASHK ishte përfaqësuar edhe në Gjenevë në Konferencën e 113-të Ndërkombëtare të Punës, të organizuar nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO).



Kjo konferencë përbënte një nga ngjarjet më të rëndësishme globale në fushën e punës dhe të drejtave të punëtorëve, duke mbledhur delegacione trepalëshe (qeveri, sindikata dhe përfaqësues të punëdhënësve) nga të gjitha shtetet anëtare të ILO-së. Megjithatë Kosova aktualisht nuk ishte pjesë zyrtare e kësaj Konference për shkak të mosfunksionimit të Këshillit Ekonomik-Social (KES), përfaqësuesit e SBASHK-ut kishin marrë pjesë në këtë ngjarje të rëndësishme ndërkombëtare.

Nënkryetarja Vjollca Shala dhe sekretari i Përgjithshëm Ymer Ymeri, kishin përfaqësuar SBASHK-un në kuadër të delegacionit të Edukimit

Ndërkombëtar (Education International – EI), duke qenë aktivë në sesionet që trajtojnë çështjet e arsimit dhe të punës, krahas përfaqësuesve sindikalistë nga mbarë bota.



Kjo pjesëmarrje e SBASHK-ut në Konferencën e ILO-së kishte një rëndësi të veçantë, pasi jo vetëm që siguron një zë për sindikalistët e arsimit të Kosovës në arenën ndërkombëtare, por gjithashtu dëshmon përkushtimin e SBASHK-ut për të ndjekur dhe ndikuar në zhvillimet globale që kanë të bëjnë me të drejtat e punëtorëve dhe standardet ndërkombëtare të punës. Duhet theksuar se pesë vite më parë, Kosova kishte delegacion zyrtar në këtë Konferencë, falë përfaqësimit nëpërmjet Këshillit Ekonomik-Social (KES). Sot, mungesa e këtij mekanizmi e ka lënë Kosovën jashtë tryezave të rëndësishme ndërkombëtare për dialog social dhe politikëbërje në fushën e punës. Kjo e bënë edhe më të vlefshme dhe të domosdoshme pjesëmarrjen alternative të përfaqësuesve të SBASHK-ut, të cilët me angazhimin e tyre po mbrojnë dhe promovojnë të drejtat e punëtorëve të arsimit të Kosovës në nivel ndërkombëtar.

Mbahen zgjedhjet Sindikale në Podujevë – rizgjidhet kryetar Fadil Halimi, kurse nënkryetare Elfate Seta



Të shtunën e 14 qershorit në Podujevë ishte mbajtur Kuvendi Zgjedhor i Nivelit Sindikal Komunal të Arsimit Parauniversitar (NSKAP), ku ishte zgjedh kryetari, nënkryetaria, kryesia e re e NSKAP-it të Podujevës, delegatët për Kongresin e SBASHK-ut, si dhe anëtarët për Këshillin Drejtues të SBASHK-ut.



Gjatë procesit zgjedhor në Podujevë, të pranishëm ishin edhe përfaqësuesit e lartë të SBASHK-ut: Nënkryetaria Vjollca Shala dhe zyrtari ligjor, Blendor Shatri.



Ky kuvend ishte organizuar në kuadër të zgjedhjeve të rregullta ku në vitin 2025 ishin mbajtur zgjedhjet për të gjitha shoqatat sindikale dhe për nivelet komunale, universitare dhe të kulturës që veprojnë në kuadër të SBASHK-ut. Këshilli Drejtues e kishte shpallur këtë vit si vit zgjedhor që në fillim të vitit kalendarik. Procesi zgjedhor në Podujevë ishte zhvilluar në mënyrë të rregullt, demokratike dhe pa asnjë pengesë.



Kryetari i NSKAP-it për Podujevë ishte rizgjedh Fadil Halimi kurse nënkryetare, Elfate Seta.

SBASHK me Kongres të jashtëzakonshëm, propozoi veprime sindikale për realizim të kërkesave të mësimdhënësve



SBASHK gjatë muajit korrik kishte mbajtur Kongresin e 9, të jashtëzakonshëm, ku edhe kishte propozuar veprime sindikale në rast të mospërbushjes së kërkesave të mësimdhënësve dhe stafit arsimor nga ana e qeverisë. Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, kishte deklaruar se që nga viti 2022, Ministria e Arsimit kishte refuzuar çdo

formë bashkëbisedimi me Sindikatën, duke bllokuar përpjekjet për një dialog konstruktiv. Ai kishte theksuar mungesën e vullnetit institucional për të adresuar kërkesat e ligjshme të mësimdhënësve. Në kongres ishte theksuar gjithashtu moszbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese për njohjen e përvojës së punës dhe për mosrealizimin e rritjes së koeficientit të pagave. Pavarësisht dorëzimit të një versioni të ri të Kontratës Kolektive në nëntor 2024, nuk ishte bërë asnjë përpjekje për miratimin e saj.

Përfaqësuesit sindikalë kishin shprehur shqetësim për përjashtimin e zërave të arsimit nga trupat profesionale vendimmarrës dhe për mungesën e përfshirjes në Komisionin për Licencimin e Mësimdhënësve.

SBASHK-u kishte paralajmëruar se nëse deri më 20 gusht 2025 nuk rifillon dialogu me Ministrinë e Arsimit dhe nuk ndërmerren hapa konkretë për trajtimin e kërkesave të mësimdhënësve, atëherë do të pasojnë veprime sindikale, përfshirë edhe grevën, gjithnjë në përputhje me Ligjin dhe Statutin e sindikatës.

Kongresi kishte përfunduar me miratimin e një Rezolute që kërkonte formimin e një Ekipi të Posaçëm për riorganizimin dhe inovacionin sindikal, me synimin që SBASHK-u të forcojë mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve të arsimit dhe të ndikojë më shumë në politikat arsimore të vendit.



Kërkesat kryesore të SBASHK-ut ishin:

1. Fillimi dhe përfundimi i procesit të negociatave, si dhe nënshkrimi i Kontratës së re Kolektive të Arsimit.
2. Zbatimi i plotë dhe i pakushtëzuar i Kontratës Kolektive ekzistuese deri në nënshkrimin e Kontratës së re Kolektive të Arsimit.
3. Përfshirja e përfaqësuesve të SBASHK në të gjitha proceset vendimmarrëse që prekin të drejtat e punëtorëve të arsimit.

Kurse, propozimi për veprimet sindikale lidhur me Kontratën Kolektive në sektorin e arsimit – që do të ndërmerren nga shtatori 2025 e tutje janë:

Hapi 1: Paralajmërimi Institucional

Dërgimi i një letre zyrtare Ministrisë së Arsimit dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, me kërkesat:

- Fillimi urgjent i negociatave për nënshkrimin e Kontratës së re Kolektive;
- Zbatimi i plotë i Kontratës Kolektive aktuale deri në nënshkrimin e kontratës së re.

Afati për përgjigje: 7 ditë pune.

Hapi 2: Protesta

- Organizimi i një proteste me pjesëmarrjen e Kryesisë së SBASHK,

kryetarëve të SKAP dhe përfaqësuesve të sindikatave komunale.

Hapi 3: Veprime Simbolike

- Mbajtja e orës së parë mësimore pa mësim, gjatë së cilës do të informohen nxënësit për të drejtat sindikale dhe rëndësinë e Kontratës Kolektive.

Hapi 4: Grevë Paralajmëruese – Një Orë

- Organizimi i një greve një-orëshe në të gjitha institucionet publike arsimore.

Hapi 5: Grevë Paralajmëruese – Një Ditë

- Organizimi i një greve një-ditore në të gjitha shkollat publike të Kosovës.

Hapi 6: Grevë e Përgjithshme

- Në rast se nuk ka përmbyshje të kërkesave të mësipërme, do të thirret grevë e përgjithshme në të gjithë sektorin e arsimit publik.



Të gjitha veprimet e planifikuara do të ndërmerren në përputhje të plotë me Ligjin Nr. 03/L-200 për Grevë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-119.

Shfletojmë përshtypjet e pushuesve në bregdetin shqiptar

Mirënjohje dhe respekt për përkushtimin e SBASHK-ut

Aktiviteti tradicional i SBASHK-ut për organizimin e pushimeve në bregdetin shqiptar për një numër të konsideruar të anëtarëve e anëtarëve të sindikatës sonë këtë vit ishte realizuar në tri grupe të ndara. Ata ishin ndërjet mirë gjatë gjithë ditëve të pushimit dhe çdo gjë kishte shkuar sipas planifikimit të bërë me kohë. Pushueset e pushuesit kishin shprehur mirënjohje e falënderime për SBASHK-un edhe gjatë vizitës së kryetarit të SBASHK-ut, por një numër i madh i pjesëmarrësve, përshtypjet e tyre i kishin lënë edhe të shkruara në fletoret e përshtypjeve. Në numrin e muajit korrik të gazetës sonë kishim shfletuar ato dhe te ju lexues të nderuar ju kishim përcjell pjesë nga këto përshtypje. Nga

to kishim dalluar përshtypjet e thëna përmes vargjeve.

Në këto vargje shprehet krenaria për bukuritë e detit shqiptar dhe mirënjohja e falënderimi për kryetarin, stafin dhe për gjithë pushueset e pushuesit që kishin qëndrim të kulturuar e plot dinjitet gjatë gjithë ditëve të pushimit në ambientet e bukura

Detyrë konkrete nga takimi konsultativ me kryetarët

të “Bonita”. Edhe përshtypjet tjera që i kemi ruajtur në arkivin e SBASHK-ut, shprehin respekt e mirënjohje për Sekretarin e Përgjithshëm në SBASHK, për stafin dhe për veprimtarët e angazhuar për rrjedhën e mbarë të këtij aktiviteti.

“Që nga fillimi e deri më tani jemi tejet të kënaqur gjatë pushimeve të mundësuar nga SBASHK, si në plazh, poashtu edhe fjetje, ushqimi, janë fenomenal, dhe janë për të lodhënuar, si stafi i hotelit Bonita, ashtu edhe Sindikatë e SBASHK-ut. *Valentina*”

Jemi të kënaqur në të gjithë aspektet e mbledhjes së pushimit, duke filluar nga transporti, akomodimi, ushqimi e me rëndësishme, organizimi i grupit dhe punëtorët ndihmës. Do të jetojmë e s’do ta harrojmë kurrë”, ishte shprehur pushuesi tjetër.

PËRSHTYPJET E MIA PËR KREJT ORGANIZIMIN E KËTJË UDHËTIMI TË SBASHK-UT JANË POZITIVE. DUKË FILLUAR QË NGA NISJA ME AUTOBUSA, VENDOSJA NË HOTEL, USHQIMI, PLAZHI, ORGANIZIMI I GJITHMBARSHËM E MBI TË GJITHA INFORMIMI”, THUHEJ NË PËRSHTYPJET E Një pushuesi tjetër.

“Prej ditës së parë, 17.06.2025, me fjetje, me ushqim, me plazh, me mikpritje dhe bashkëpunimi Brenda Sindikatës, në përgjithësi jam e kënaqur. Uroj të vazhdoj kjo e mirë në ditët në vijim,” kishte shkruar një mësimdhënëse-pushuese tjetër.

Kurse një pushues nga Prishtina kishte thënë kështu: “Kjo vizitë është e mirëseardhur për ne. Që nga Prishtina e deri në hotel organizimi ka qenë në nivel me çdo detaj ishte mirë i menduar. Gjithashtu edhe në hotel, ushqimi, pastërtia në dhoma, shërbimi, komunikimi shumë perfekt. Respekt për udhëheqësinë e grupit të parë, jeni shembull”, është shprehur një pushues tjetër. Redaksia e gazetës “Arsimimi sot” ka falënderuar pushueset e pushuesit që kishin lënë përshtypjet e tyre të shkruara dhe ato që do t’i ruajmë me kujdes në arkivin e SBASHK-ut.

“Me respekt dhe falënderime të veçanta për kryesinë e SBASHK-ut dhe gjithë stafit menaxhues për organizimin dhe menaxhimin e këtij pushimi veror 2025! U jemi shumë mirënjohës dhe të privilegjuar që jemi bashkëpjesëmarrës në këtë pushim të paharrueshëm dhe të mrekullueshëm! Falënderimet shkojnë edhe për stafin dhe menaxhmentin e restorant “Bonita”. Pritja, shërbimi dhe akomodimi janë në nivelin e shkëlqyer dhe pa vërejtje. E deruara kryesi e SBASHK-ut, ju urojmë ju dhe gjithë stafit arsimor të Republikës së Kosovës suksese në rrugëtimin e drejtë dhe të shenjtë kombit.”

“Që nga fillimi e deri më tani jemi tejet të kënaqur gjatë pushimeve të mundësuar nga SBASHK, si në plazh po ashtu edhe fjetje, ushqimi janë fenomenal dhe janë për t’u lavdëruar si stafi i hotelit Bonita ashtu edhe SBASHK-u”, ishte shprehur një pushues.

“Jemi të kënaqur nga të gjitha sferat e mbarëvajtjes së pushimit, duke filluar nga transporti, akomodimi, ushqimi e më e rëndësishmja, atmosfera e krijuar nga grupi i mësimdhënësve dhe punëtorët ndihmës. Do të jetojmë e s’do ta harrojmë kurrë”, ishte shprehur pushuesi tjetër.

“Përshtypjet e mia për krejt organizimin e këtij udhëtimi të SBASHK-ut janë pozitive. Duke filluar që nga nisja me autobusa, vendosja në hotel, ushqimi, plazhi, organizimi i gjithmbarshtëm e mbi të gjitha informimi”, thuhej në përshtypjet e një pushuesi tjetër.

“Prej ditës së parë, 17.06.2025, me fjetje, me ushqim, me plazh, me mikpritje dhe bashkëpunimi Brenda Sindikatës, në përgjithësi jam e kënaqur. Uroj të vazhdoj kjo e mirë në ditët në vijim,” kishte shkruar një mësimdhënëse-pushuese tjetër.

Kurse një pushues nga Prishtina kishte thënë kështu: “Kjo vizitë është e mirëseardhur për ne. Që nga Prishtina e deri në hotel organizimi ka qenë në nivel me çdo detaj ishte mirë i menduar. Gjithashtu edhe në hotel, ushqimi, pastërtia në dhoma, shërbimi, komunikimi shumë perfekt. Respekt për udhëheqësinë e grupit të parë, jeni shembull”, është shprehur një pushues tjetër. Redaksia e gazetës “Arsimimi sot” ka falënderuar pushueset e pushuesit që kishin lënë përshtypjet e tyre të shkruara dhe ato që do t’i ruajmë me kujdes në arkivin e SBASHK-ut.

“Me respekt dhe falënderime të veçanta për kryesinë e SBASHK-ut dhe gjithë stafit menaxhues për organizimin dhe menaxhimin e këtij pushimi veror 2025!

U jemi shumë mirënjohës dhe të privilegjuar që jemi bashkëpjesëmarrës në këtë pushim të paharrueshëm dhe të mrekullueshëm!

Falënderimet shkojnë edhe për stafin dhe menaxhmentin e restorant “Bonita”. Pritja, shërbimi dhe akomodimi janë në nivelin e shkëlqyer dhe pa vërejtje.

E deruara kryesi e SBASHK-t, ju urojmë ju dhe gjithë stafit arsimor të Republikës së Kosovës suksese në rrugëtimin e drejtë dhe të shenjtë kombit”, kishte shkruar një pushues.

Ndërsa një përshtypje të cilën e kemi pranuar vetëm në formë elektronike (por jo të shkruar në letër), do ta postojmë vetëm si shkrim.

“Letërpërshtypjeje nga pushimi gjashtëditor në Durrës Pushimi gjashtëditor në bregdetin e Durrësit, i organizuar nga SBASHK-u, ishte një përjetim i paharrueshëm që na solli çlodhje, miqësi të reja dhe mirënjohje të thellë për organizatorët dhe mikpritësit tanë. Rruga drejt bregdetit kaloi në atmosferë të këndshme, me shoqëri të mirë dhe pritje të ëmbla për ditët që na prisnin. Në mbërritje, u sistemua në një hotel buzë detit, me kushte të mira dhe staf të sjellshëm. Dhomat ishin të rregullta dhe të pastërta, ndërsa ambienti përreth na ftoi menjëherë drejt qetësisë dhe relaksit. Ushqimi ishte i bollshëm dhe me shije të veçantë – menytë e përzgjedhura përfshinin gatime tradicionale dhe detare, që na kujtuan shijen e vërtetë të mikpritjes durrsake. Në çdo vakt ndiheshim si në shtëpinë tonë, të respektuar dhe të përkujdesur. Një nga përfitimet më të mëdha të këtij organizimi ishte njohja dhe shoqërimi me kolegë

nga vise të ndryshme të Kosovës, me të cilët ndamë përvoja, kënduam, biseduam e madje hodhëm edhe ndonjë valle nën tingujt e muzikës shqipe. Organizimet e përditshme – si shëtitjet buzë detit, aktivitetet argëtuese në mbrëmje dhe bisedat e hapura mes kolegësh – krijuan një atmosferë të veçantë bashkësie dhe solidariteti. Në fund, nuk mund të mos shprehim falënderimin tonë të thellë për SBASHK-un, i cili me përkushtim e organizim të shkëlqyer, bëri të mundur këtë përvojë kaq të bukur. Po ashtu, një përlulje e veçantë për mikpritjen e durrësakëve,

që na bënë të ndiheshim si pjesë e tyre. Këto gjashtë ditë nuk ishin vetëm pushim, por edhe rigjallërim shpirtëror, forcim i lidhjeve kolegjiale dhe dëshmi se bashkimi ynë, si komunitet arsimor, ka vlerë e jetë të gjatë”, kishte shkruar ky pushues.

Flasin ata që u angazhuan për rrjedhën e mbarë të pushimeve në bregdetin shqiptar

Ndjemmi krenar me respektin dhe mirënjohjen e shprehur nga pushuesit



Tri grupet e pushuesve në bregdetin shqiptar kishin shprehur respekt dhe mirënjohje për organizimin e shkëlqyer të aktivitetit tradicional të SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë. Për këtë numër të gazetës sonë kishim biseduar me sekretarin e Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri dhe me anëtarët tjerë të komisionit që ishin kujdesur për organizimin dhe rrjedhën e mbarë të këtij aktiviteti për pushuesit që ishin të ndarë në tri grupe.



Ymer Ymeri kishte treguar se ishin kryer me kohë gjithë përgatitjet për t'u nisur mbarë ky aktivitet. Ai kishte përgëzuar për angazhimet gjithë stafin dhe kryetarët e Nivelit Komunal Sindikal e të Universiteteve, të cilët ishin angazhuar me përkushtim dhe prandaj ky aktivitet ishte realizuar me plot sukses edhe këtë vit. “Kemi pasur shumë angazhime, por kemi harruar lodhjen e stresin duke dëgjuar ato që thoshin pushuesit për këtë aktivitet. Falënderoj gjithësecilin veç e veç për punën, angazhimin dhe përgjegjësitë e marra në organizimin pa asnjë vërejtje të këtij aktiviteti tashmë tradicional të SBASHK-ut”, ishte shprehur Ymeri.



Blendor Shatri-Jemi angazhuar bashkë me anëtarët tjerë të komisionit dhe ia kemi dalë që me sukses të organizojmë dhe realizojmë pushimet në bregdetin shqiptar.



Nezafete Jakupi-Më vjen mirë që pushuesit kanë kaluar mirë gjatë gjithë ditëve të pushimit. Kemi komunikuar vazhdimisht me ta dhe ndjeheshim krenar kur ata shpreheshin me fjalë falënderimi për angazhimin tonë.



Afërdita Mirena-Me kënaqësi isha angazhuar që ky aktivitet të ketë rrjedhë të mbarë dhe bashkërisht kemi arritur që ky aktivitet të përfundojë me sukses të plotë dhe me kënaqësi po lexoj përshtypjet e shumë prej pushuesve e pushuesve.

SBASHK nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me klinikën Euromed

SBASHK në kuadër të ofrimit të shëbrimeve më të lehta dhe me kosto më të ulët për anëtarësinë, gjatë muajit korrik kishte nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Klinikën Euromed në Fushë-Kosovë.

Edhe pas angazhimeve të shumta në shërbim të anëtarësisë, duke i shpërblyer në shenjë respekti me pushime në bregdetin shqiptar mbi 400 mësimdhënës vetëm gjatë muajit qershor, SBASHK kishte vazhduar të mendojë për kuletën e mësimdhënësit dhe punonjësit arsimor, i cili po ballafaqohet me shtrenjtime të mëdha dhe rritje të çmimeve në çdo fushë të jetës.

Në kuadër të ofrimit të ndihmesës së anëtarësisë, SBASHK kishte vazhduar të ndikojë në zbritje për shërbime të ndryshme, qofshin ato edhe solide për anëtarët e vet në fusha të ndryshme, e sidomos ato shëndetësore të cilat edhe janë shërbime me prioritet për qytetarin.

Marrëveshja e SBASHK-ut me Euromed ishte ndër marrëveshjet e radhës e cila për anëtarët e Sindikatës ofron zbritje në shërbime si kontrollat e mjekësisë familjare, dhënie të terapisë si: infuzione, ineksione etj. Me këtë marrëveshje, anëtarët e SBASHK-ut kishin përfituar zbritje edhe në shërbime si intervenime kirurgjike, vizita specialiste etj.

Marrëveshja e cila kishte për qëllim ndihmesën e anëtarësisë për ofrimin e shërbimeve të nevojshme shëndetësore, ishte nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm i SBASHK-ut, Ymer Ymeri dhe Drejtori i Euromed-it, Leart Jakupi.



Sekretari i përgjithshëm i SBASHK-ut, Ymer Ymeri, kishte falënderuar Drejtorin e Spitalit Euromed, Leart Jakupi, duke theksuar: "Ndjejmë nevojën t'iu shprehim mirënjohjen më të sinqertë për konsideratën dhe vlerësimin që keni treguar ndaj punonjësve të arsimit në Kosovë. Ofrimi i zbritjeve për shërbimet shëndetësore që ofron spitali juaj për anëtarët e SBASHK-ut nuk është vetëm një akt solidariteti, por edhe një dëshmi e qartë e respektit që keni për mësimdhënësit dhe për vetë Kosovën.

Ky gjest fisnik është një shembull frymëzimi dhe model bashkëpunimi që dëshirojmë ta shohim më shpesh në shoqërinë tonë. Ju falënderojmë për këtë mbështetje kaq të çmuar dhe jemi të bindur se ky bashkëpunim do të thellohet edhe më tej në të ardhmen në shërbim të përbashkët të arsimit dhe shëndetit", kishte thënë Ymeri.

Marrëveshja ofron zbritje deri në 20 për qind për disa shërbime shëndetësore që i ofron kjo klinikë derisa deri në 10 për qind për disa shërbime tjera. Marrëveshja ishte lidhur më datën 10 korrik 2025 dhe vlen për një vit kalendarik.



SBASHK mbajti testet për dy grupe të mësimdhënësve në Prishtinë




SBASHK gjatë korrikut kishte organizuar edhe testet për dy grupe të mësimdhënësve në Prishtinë, të cilët e kishin përfunduar trajnimin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, një grup në modulën I dhe grupi tjetër modulën II të trajnimit.

Testi për mësimdhënësit të cilët e kishin përfunduar trajnimin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”-moduli II, ishte administruar nga nënkryetarja e SBASHK-ut, Vjollca Shala kurse në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”-moduli I, ishte administruar nga sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri.

Gjatë testimit i pranishëm ishte edhe trajneri që e kishte udhëhequr trajnimin e modulit të dytë, Arben Zymeri si dhe kryetari i NSKAP-it për Prishtinë, Qamil Hajdini.



SBASHK organizoi tri grupe të trajnimeve në Prishtinë



Rifillimin e punës pas pushimeve verore, SBASHK e kishte nisur me organizimin e trajnimeve për mësimdhënës në dy programe të ndryshme: “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” dhe “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social”. Me kërkesë të mësimdhënësve të Prishtinës, me rikthimin e tyre nëpër shkollë, ishin mbajtur edhe tri grupe të ndryshme të trajnimit në shkollën “Dardania” në kryeqytet.



Një grup i mësimdhënësve të kryeqytetit kishin ndjekur trajnimin në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie – moduli 1”, me trajner Arben Zymeri. Grupi i dytë i mësimdhënësve kishte ndjekur trajnimin në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie – moduli 2”, me trajnere Blerona Ahmeti dhe grupi i tretë i mësimdhënësve kishte vijuar trajnimin në programin “Forcimi

Një grup i mësimdhënësve të kryeqytetit kishin ndjekur trajnimin në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie – moduli 1”, me trajner Arben Zymeri. Grupi i dytë i mësimdhënësve kishte ndjekur trajnimin në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie – moduli 2”, me trajnere Blerona Ahmeti dhe grupi i tretë i mësimdhënësve kishte vijuar trajnimin në programin “Forcimi

i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social”, me trajner Afrim Gashi.

Me përfundimin e trajnimeve të grupeve nga programi “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, moduli 1 dhe 2, SBASHK kishte organizuar edhe testet gjatë javës së fundit të gushtit. Testet ishin administruar nga nënkryetarja e SBASHK-ut, Vjollca Shala dhe sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri.



I pranishëm për të përcjellë nga afër mbarëvajtjen e trajnimit, por edhe testimin të mësimdhënësve, ishte edhe kryetari i NSKAP-it për Prishtinë, Qamil Hajdini. Teste gjatë muajit gusht ishin mbajtur edhe në Ferizaj e Gjilan për mësimdhënësit të cilët e kishin ndjekur me sukses trajnimin në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”. Në Gjilan testi ishte Administruar nga sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri, derisa trajnerja që e kishte udhëhequr këtë grup të mësimdhënësve ishte Ibadete Limani.



Kurse në Ferizaj, testet për dy grupe të mësimdhënësve ishin administruar nga sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri dhe zyrtari Ligjor, Blendor Shatri.



Mësimdhënës, prindër dhe ju nxënës urime viti i ri shkollor

E hëna e 1 shatorit shënoi fillimin e një beteje të re për dije. SBASHK-u ju drejtua punëtorëve arsimor, prindërve dhe nxënësve me urimin që ky vit shkollor të fillojë mbarë dhe të stoliset vazhdimisht me arritje e suksese të shumta. Urojmë që të ndodh sa më shpejt furnizimi i nxënësve me tekste shkollore e të mos na përsëritet situata e dy viteve të kaluara shkollore kur me fajin e ministres Nagavci dhe MASHTI-t shkonte shatori pa u kompletuar të gjithë nxënësit me tekste dhe mjete mësimore.

Urojmë që sa më shpejt të kemi një Qeveri të Kosovës me njerëz që e ndejnë si nder dhe obligim të jenë anëtarë të kabinetit qeveritar e jo të ndjehen, si kjo Qeveria Kurti, se janë bërë shumë të mëdhenj dhe t'i shohin si armiq gjithë ata që guxojnë t'i kritikojnë kur punojnë keq apo nuk punojnë fare.

Mësimdhënës të nderuar duke ju uruar fillim të mbarë të vitit të ri shkollor ju falënderojmë për gjithë angazhimet në vitet e shkuara dhe ju lusim që të vazhdoni me misionin tuaj të shenjtë për edukimin dhe arsimimin e brezave.

Prindër të nderuar edhe juve ua urojmë fillimin e vitit të ri shkollor duke ju lutur që të jeni pranë mësimdhënësve e t'i ndihmoni në realizimin e qëllimit të përbashkët për arritje e suksese sa më të larta. Ju lusim që mos të ngiteni kundër mësuesit, për t'i hyrë në hatër pushtetit, as atëherë kur punëtorët e arsimit janë në protestë apo në grevë. Të jeni të bindur ata nuk i duan këto veprime sindikale, por i bëjnë pas pritjes së gjatë që qeveritarët të bisedojnë me SBASHK-un dhe të ofrojnë zgjidhje për kërkesat legjitime. Prindër të nderuar fëmijët tuaj nuk kalojnë as edhe një minutë me qeveritarët po kalojnë një pjesë të madhe të ditës me mësimdhënësit.

Nxënës të nderuar duke ua uruar edhe juve fillimin e vitit të ri shkollor ju ftojme të angazhoheni sinqerisht për të fituar njohuri të reja dhe të dëgjoni këshillat e mësuesit dhe prindit. Janë këta që ua duan sinqerisht të mirën dhe luten që ju të arrini sa më shumë në jetë.

Rrahman Jasharaj,
SBASHK



SBASHK-u i gatshëm për veprim në pritje të krijimit të institucioneve



Duke respektuar vendimin e Kongresit të Jashtëzakonshëm për angazhime që me dialog me Qeverinë dhe MASHTI-n të realizohen kërkesat legjitime të anëtarësisë deri më 20 gusht, e nëse institucionet nuk tregojnë gatishmëri për dialog të bëhen përgatitje për veprime sindikale. Kryesia e SBASHK-ut kishte mbajtur takim më 20 gusht dhe në konsultim edhe me shumë prej kryetarëve të nivelit komunal e të universiteteve, kishte analizuar situatën aktuale duke shprehur

shqetësim për moskrijimin e institucioneve me të cilat do të zhvilloheshin takime dhe do të provohej fillimisht që me dialog të zgjidheshin kërkesat legjitime të anëtarësisë.

Në rast se vullneti i institucioneve për dialog do të mungonte, atëherë do të ndërmerren veprime sindikale pa përjashtuar as grevën e përgjithshme. Duke parë se ende nuk kishim institucione me të cilat do të dialogonim apo ndaj të cilave do të drejtoheshin veprimet sindikale, SBASHK-u kishte deklaruar se është i gatshëm për veprime qoftë për takime e dialog qoftë për veprime sindikale e greva dhe kështu do të veprojë duke respektuar zërin e anëtarësisë me krijimin e institucioneve të shtetit tonë.

SBASHK-u përkrahu protestën e OVL të UÇK-së në sheshin "Skenderbeu", për drejtësi ndaj krerëve të UÇK-së në Hagë

Zëri ynë i bashkohet zërit të së vërtetës dhe drejtësisë!



Anëtarët e SBASHK-ut, nga çerdhet e deri në universitete, sipas bindjeve vullnetare, ishin pjesë e protestës madhështore paqësore të thirrur nga organizatat e dala nga lufta e lavdishme e UÇK-së. Më 7 gusht, ora 17:00, në Sheshin "Skënderbeu" në Prishtinë, përfaqësuesit e SBASHK-

ut në mënyrë të organizuar ishin pjesë e protestës, duke bërë që të dëgjohet zëri ynë i fuqishëm, në përkrahje të bijve më të mirë të kombit, që padrejtësisht po mbahen prapa grilave në Hagë. Pjesëmarrja e gjerë e punëtorëve të arsimit, shkencës dhe kulturës në këtë protestë ishte një mesazh i qartë: ne nuk e harrojmë sakrificën! Falë atyre që sot padrejtësisht ndodhen në qeli, ne sot gëzojmë lirinë, ecim të lirë në shtetin tonë dhe edukojmë brezat për atdhedashuri e drejtësi. SBASHK-u ngre zërin për drejtësinë, për lirinë dhe për ata që sakrifkuan gjithçka për të ardhmen tonë.

SBASHK gjatë shtatorit organizoi katër grupe të trajnimit në shërbim të anëtarësisë

Me të hyrë në muajin shtator dhe me fillimin e vitit të ri shkollor, ishin shtuar edhe kërkesat e mësimdhënësve për t'i ndjekur trajnimet që SBASHK-u i organizon pa pagesë për anëtarësinë e vet.



Gjatë muajit shtator, SBASHK kishte organizuar katër grupe të trajnimit në dy programe të ndryshme të trajnimit, në tri komuna të Kosovës.



Të shtunën e fundit të shtatorit SBASHK kishte filluar me një grup të trajnimit në komunën e Drenasit në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie-moduli 2”, me trajnerin e përcaktuar nga SBASHK, Fejzullah Berisha. Trajnimi ishte mbajtur në Gjimnazin “Gjergj Kastrioti Skenderbeu”, derisa për t'u kujdesur për mbarëvajtjen e tij, mësimdhënësit i kishte vizituar në ditën e parë të trajnimit edhe kryetari i NSKAP-it për Drenas, Ilaz Dervishi.



Një javë më parë, SBASHK-u e kishte filluar trajnimin në programin “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social” me një grup mësimdhënësish në Lipjan, të cilin e kishte udhëhequr trajneri i përcaktuar nga SBASHK-u, Emrush Ahmeti.



Trajnimi ishte mbajtur në shkollën “Ismail Luma” në Lipjan, ndërsa mësimdhënësit ishin shprehur të kënaqur me ofrimin e mundësisë nga SBASHK-u për zhvillim në karrierë.



Në të njëjtin program trajnimi, në javën e dytë të shtatorit, kishte filluar edhe një grup trajnimi në Fushë-Kosovë, me trajnerin e përcaktuar nga SBASHK-u, Safet Beqiri.



Trajnimi ishte mbajtur në shkollën “Mihal Grameno”, kurse mësimdhënësit gjatë fillimit të trajnimit, i kishte përshëndetur edhe kryetari i NSKAP-it për Fushë-Kosovë, Haki Krasniqi. Mësimdhënësit ishin shprehur mirënjohës ndaj SBASHK-ut për mbështetjen në karrierë, duke ofruar trajnime pa pagesë në çdo komunë të Kosovës.



Në po të njëjtën javë, kishte filluar edhe trajnimi me një grup të mësimdhënësve të Lipjanit në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, ku trajneri përzgjedhur nga SBASHK-u për ta udhëhequr këtë grup ishte Idriz Sopa. Mësimdhënësit i kishte vizituar edhe vetë kryetari i NSKAP-it për Lipjan, Emrush Ahmeti.



Ndërsa, grupi i parë i trajnimit që e kishte nisur këtë muaj, ishte ai i mësimdhënësve të Gjilanit, ku në programin "Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social", nën udhëheqjen e trajnerit të përcaktuar nga SBASHK, Rexhep Arifi, ishte mbajtur trajnimi në shkollën "Veseli Muja" në Gjilan.



Për ta përshëndetur trajnimin, por edhe për t'u kujdesur për ecurinë e tij, gjatë organizimit ishte i pranishëm edhe kryetari i NSKAP-it për Gjilan, Blerim Mehmeti.



SBASHK vazhdon angazhimin përmes trajnimeve në shërbim të anëtarësisë në gjithë Kosovën. Kurse, me fillimin e vitit të ri shkollor, SBASHK kishte vazhduar edhe me teste për mësimdhënësit, të cilët i kishin ndjekur trajnimet në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” para pushimeve verore, e të cilët kishin për t'iu nënshtruar testimit nga ky trajnim.



Teste për mësimdhënësit ishin organizuar në Drenas, ku një grup i mësimdhënësve e kishte vijuar trajnimin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie – Moduli 2” me trajnerin e përcaktuar nga SBASHK, Fejzullah Berisha.



Kurse, testi ishte administruar nga sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri, dhe zyrtarja Afërdita Ahmeti. Trajnimi ishte mbajtur në Gjimnazin “Gjergj Kastrioti Skënderbeu”, kurse ishte përcjellë nga afër edhe nga

kryetari i NSKAP-it për këtë komunë, Ilaz Dervishi. Testi për një grup të mësimdhënësve ishte mbajtur edhe në shkollën “Musa Hoti” në Mitrovicë dhe ishte administruar nga nënkryetarja Vjollca Shala dhe sekretari Ymer Ymeri.



Ky trajnim ishte udhëhequr nga trajneri i përcaktuar nga SBASHK, Kadri Hyseni, derisa për mbarëvajtjen e tij ishte përkujdesur kryetari i NSKAP-it për Mitrovicë, Isa Ismajli.



SBASHK ishte pjesëmarrës në Konferencën Finale të ETUCE-së për përfshirjen e refugjatëve dhe migrantëve në arsim



Më 25–26 shtator 2025, në Varshavë të Polonisë, ishte mbajtur Konferenca Finale e projektit të ETUCE-së “In and through education: Education Trade Unions support the inclusion of refugees and migrants” (Në dhe përmes arsimit: Sindikatat e Arsimit mbështesin përfshirjen e refugjatëve dhe migrantëve), me pjesëmarrjen e të gjitha sindikatave të arsimit nga vendet evropiane.



Në këtë ngjarje të rëndësishme, SBASHK ishte përfaqësuar nga sekretari i Përgjithshëm, Ymer Ymeri, dhe nënkryetarja, Vjollca Shala, të cilët kishin dhënë kontributin me përvojën e Kosovës në adresimin e sfidave të përfshirjes së refugjatëve dhe migrantëve në sistemin arsimor. Konferenca ishte hapur me fjalimet përshëndetëse të: John MacGabhann, president i ETUCE-së; Sławomir Broniarz, president i ZNP (Poloni); Barbara Nowacka, ministre e Arsimit e Polonisë.



Në konferencë, Jelmer Evers (ETUCE) kishte prezantuar rezultatet e projektit ETU4REF, ndërsa Dominique Danau (SAGO Research) kishte paraqitur gjetjet kërkimore dhe rekomandimet e politikave për përfshirjen e refugjatëve dhe migrantëve në arsim. Gjatë sesioneve të punës, përfaqësues nga sindikatat e arsimit në gjithë Evropën, përfshirë edhe delegacionin e SBASHK-ut, kishin diskutuar mbi: mënyrat më efektive për përfshirjen e nxënësve me prejardhje refugjatësh e migrantësh; rolin e sindikatave në mbështetjen e mësimdhënësve me këtë sfond; avokimin për politika arsimore gjithëpërfshirëse dhe barazi në arsim.

Ky aktivitet, i mbështetur financiarisht nga Komisioni Evropian, ishte një mundësi e vlefshme për të ndarë përvoja, për të forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar dhe për të avancuar misionin e arsimit si e drejtë universale për të gjithë. Konferenca kishte vazhduar edhe gjatë ditës së dytë me sesione të tjera kushtuar shkëmbimit të përvojave mes sindikatave të arsimit nga e gjithë Evropa, duke theksuar rolin e tyre në avokimin për politika arsimore gjithëpërfshirëse dhe mbrojtjen e të

SBASHK nderoi “veteranët” e arsimit



SBASHK gjatë muajit shtator kishte vazhduar me aktivitetin tradicional për të dëshmuar respektin e lartë për veprimtarët veteranë, të cilët që nga vitet e 90-ta e deri në pensionim kanë dhënë kontribut me vlerë në angazhimet e shumta në shërbim të anëtarësisë dhe në forcimin e zërit sindikal.

Ata janë pensionistë tani e sa kohë dhe vitet kanë lënë gjurmë te ta, por ata sikur rinojnë kur bëhen bashkë dhe shpalosin kujtimet për angazhimet dhe veprimtaritë e shumta sindikale. Kështu ishte edhe këtë vit. SBASHK-u i kishte bërë bashkë për dy ditë me radhë dhe një takim solem; kryetari Rrahman Jasharaj dhe sekretari i përgjithshëm, Ymer

drejtave të mësimdhënësve. SBASHK mbetet i përkushtuar të kontribuojë aktivisht në këto nisma evropiane, duke mbrojtur të drejtat e mësimdhënësve dhe duke promovuar arsim cilësor e gjithëpërfshirës për çdo fëmijë.

Ymeri, kishin përshëndetur këta pishtarë të dijes, duke i falënderuar për gjithë kontributin e dhënë nëpër vite e dekada në angazhimet sindikale në shërbim të anëtarësisë dhe në arritjet e shumta të SBASHK-ut. Zyrtari ligjor Blendor Shatri ishte përgjigjur në pyetjet që kishin të bënin me Ligjin për skemat pensionale.

Këta veteranë kishin shprehur krenarinë e tyre për SBASHK-un, duke falënderuar shtabin qendror për këtë aktivitet që dëshmon se vlerësohet lart dhe nuk harrohen kurrë këta veprimtarë sindikalë dhe pishtarë të dijes nëpër vite e dekada.

SBASHK organizoi punëtori dyditore me temën “Mësuesit si liderë për të forcuar sindikatat dhe për të përmirësuar arsimin”.



SBASHK, në bashkëpunim me Qendrën Amerikane të Solidaritetit (Solidarity Center), kishte organizuar gjatë muajit shtator punëtori dyditore me temë “Mësuesit si lider për të forcuar sindikatat dhe për të përmirësuar arsimin”.

Në seminar ishin pjesëmarrës përfaqësues të sindikatave të arsimit nga Kosova dhe rajoni. Hapjen e kishte bërë kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, i cili e kishte përshëndetur këtë tryezë, duke

falënderuar Qendrën Amerikane të Solidaritetit për mbështetjen, si dhe pjesëmarrësit tjerë për kontributin e tyre gjatë punëtorisë dyditore.



Në punëtorinë dyditore kishin marrë pjesë edhe përfaqësuesit e sindikatave të arsimit të Shqipërisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë së Veriut, të cilët i kishin paraqitur përvojat e tyre nga këto shtete në lidhje me temat e punëtorisë.



Presidenti i Federatës së Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës të Shqipërisë (FSASH), Shpëtim Brahaj; Presidenti i Sindikatës së Pavarur të Arsimit të Shqipërisë (SFASH), Nevruz Kaptelli; Kryetarja e Bordit Komunal të Tuzit, Mali i Zi, Albana Lulanaj; Marina Dedvukaj nga Organizata Sindikale e Shkollave të Mesme të Malit të Zi; Tafa Ahmeti, nënkryetar i Sindikatës së Arsimit, Shkencës e Kulturës të Maqedonisë së Veriut (SNOK); Zanafer Baimak, përfaqësues rajonal i Sindikatës së Arsimit, Shkencës e Kulturës të Maqedonisë së Veriut (SNOK); dhe Bruna Hylviu, zyrtare e programit nga Qendra Amerikane e Solidaritetit, kishin diskutuar lidhur me gjendjen e mësimdhënësve në vendet respektive, derisa të gjithë kishin shprehur nevojën e funksionimit dhe thellimit të dialogut social mes institucioneve dhe përfaqësuesve të punonjësve arsimorë.



Seanca e parë e seminarit me temën “Aftësi lidhshipi për forcimin e sindikatave” ishte udhëhequr nga Visar Ymeri, Drejtor Ekzekutiv i Institutit për Politika Sociale “Musine Kokalari”.



Në ditën e dytë, SBASHK e kishte vazhduar seminarin me punëtorinë me temën: “Arsimi si e mirë publike”, ligjruar nga kryetari i Këshillit Shtetëror për Licencimin e Mësimdhënësve në MASHTI, Osman Beka. Gjatë ditës kishte edhe diskutime tjera nga pjesëmarrësit, si dhe përmbyllja e seminarit nga sekretari i përgjithshëm, Ymer Ymeri, nënkryetarja e SBASHK-ut, Vjollca Shala, dhe zyrtarja e programit nga Qendra Amerikane e Solidaritetit, Bruna Hylviu.




Punëtorja dyditore kishte për qëllim që mësuesit, si liderë, të forcojnë sindikatat dhe të përmirësojnë arsimin në Kosovë dhe vendet pjesëmarrëse të rajonit.

SBASHK – Shqetësime për mungesë të teksteve shkollore dhe mosformimin e institucioneve.

Këshilli Drejtues i SBASHK-ut kishte mbajtur mbledhjen e radhës në fillim-shtator, ku ishin trajtuar disa çështje me rëndësi për anëtarësinë dhe arsimin në vend.

Një nga temat kryesore ishte mungesa e teksteve shkollore, problem që ishte përsëritur edhe këtë fillimvit shkollor në





Kosovë. Kryetarët e niveleve komunale kishin raportuar se mungesa e teksteve mësimore ishte më e theksuar te klasat VI–IX, ku kishte mungesë të librave për shkak të dallimeve në numrin e nxënësve krahasuar me vitin e kaluar, ndërsa tekstet e dorëzuara ishin të dëmtuara dhe pothuajse të papërdorshme.

Një tjetër pikë e rëndësishme ishte shqetësimi për mosformimin e Kuvendit dhe të Qeverisë së Kosovës. Këshilli Drejtues kishte vlerësuar se vonesat e gjata po dëmtonin procesin arsimor dhe zgjidhjen e kërkesave të punëtorëve të arsimit. Ishte rënë dakord që, sapo të

Përfaqësuesit e SBASHK-ut ishin pritur nga nënkryetari i Prishtinës, Shkëmb Manaj



Kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj, nënkryetarja Vjollca Shala, sekretari Ymer Ymeri dhe zyrtari ligjor, Blendor Shatri, ishin pritur nga nënkryetari i Prishtinës, Shkëmb Manaj. Ata, bashkërisht kishin bërë një analizë të fillimit të këtij viti shkollor. Nënkryetari Manaj kishte deklaruar se institucionet komunale kanë bërë gjithë përgatitjet e duhura për fillimin e mbarë të vitit të ri shkollor. Ai kishte përmendur edhe organizimin e mësimi tërëditor edhe në 6 institucione shkollore.

Kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj, kishte falënderuar institucionet komunale, e në veçanti Drejtorinë e Arsimit, për bashkëpunimin e vazhdueshëm në shërbim të arsimit në kryeqytet. Të dy palët kishin shprehur shqetësime lidhur me tekstet shkollore, duke ripërsëritur se mënyra e tashme po krijon sfida e shqetësime te prindërit, por edhe te nxënësit dhe punëtorët e arsimit, sepse po ndodhin vonesa të konsiderueshme gjersa po bëhet furnizimi i plotë i nxënësve me tekstet shkollore.

formohet Qeveria, SBASHK-u të nisë dialogun për adresimin e kërkesave të kahershme të anëtarësisë. Nëse nuk do të ketë gatishmëri për dialog dhe rezultate konkrete, SBASHK-u do të niste veprime sindikale, duke mos përjashtuar as grevën e përgjithshme.

Gjithashtu, Këshilli Drejtues kishte marrë vendim unanim që udhëheqësit e Shoqatave Sindikale, që garonin në zgjedhjet komunale të 12 tetorit, të dorëhiqeshin nga pozitat sindikale, ose ndaj tyre të ndërmerrej vendimi për shkarkim, në përputhje me Statutin e SBASHK-ut.

Në fund të mbledhjes, ishin trajtuar edhe tema të tjera që ndërlidhen me organizimin dhe funksionimin e sindikatës.



Në vazhdim të këtij takimi, Sekretari i Përgjithshëm i SBASHK-ut, Ymer Ymeri, e kishte sqaruar kërkesën drejtuar institucioneve të kryeqytetit për gjetjen e një lokacioni, në të cilin do të ndërtoheshin ambientet e SBASHK-ut, e pse jo edhe të sindikatave të tjera.

Nënkryetari Manaj kishte deklaruar se institucionet komunale do ta analizojnë me kujdes këtë kërkesë dhe se janë të vullnetit të mirë që të gjendet një zgjidhje e pranueshme lidhur me lokacionin, në të cilin do të ndërtohej një objekt me zyrat, sallën për takime e trajnime dhe ambiente të tjera të nevojshme.

SBASHK, pjesëmarrës në Konferencën Vjetore të Institutit Pedagogjik të Kosovës.

Kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj, sekretari i Përgjithshëm, Ymer Ymeri, dhe kryetari i Komisionit Statutar të SBASHK-ut, Blendor Shatri, kishin marrë pjesë në Konferencën Vjetore të Institutit Pedagogjik të Kosovës, me temë “Arsimi gjatë gjithë jetës – qasje gjithëpërfshirëse nga fëmijëria e hershme deri të arsimit profesional”.

Në Konferencën e Institutit Pedagogjik të Kosovës, ku, përveç përfaqësuesve të SBASHK-ut, ishin edhe shumë përfaqësues të institucioneve arsimore e shkencore, ishte

ofruar një platformë gjithëpërfshirëse për diskutim, me pjesëmarrjen e studiuesve, ekspertëve të arsimit dhe profesionistëve të fushës. Ndërsa në ditën e dytë të konferencës, SBASHK-un e kishte përfaqësuar nënkryetarja Vjollca Shala, ku ishin mbajtur tryeza të ndryshme të diskutimit.



SBASHK, pas kërkesës për lirim të mësimdhënësve nga pagesa e transportit publik, mirëpret vendimin e Komunës së Prishtinës

SBASHK-u e kishte mirëpritur vendimin e Komunës së Prishtinës për t'i liruar nga pagesa e transportit publik mësimdhënësit dhe kategoritë tjera të arsimit parauniversitar, pas kërkesës që Niveli Sindikal Komunal i Prishtinës kishte bërë muaj më parë për lirim të mësimdhënësve nga pagesa e transportit.

SBASHK-u, me iniciativë të kryetarit të Nivelit Sindikal të Komunës së Prishtinës, Qamil Hajdini, që nga muaji qershor e kishte iniciuar këtë kërkesë në Komunën e Prishtinës, duke zhvilluar kështu disa takime me zyrtarë të kabinetit të kryetarit, Përparim Rama, zyrtarë të DKA-së dhe përfaqësues të tjerë komunal.

“Me këtë bashkëpunim, ne po synojmë që në Prishtinë, nga trafiku, të largohen mbi 500 vetura në ditë, sepse do të shfrytëzohet Trafiku Urban. Ky

hap është një veprim konkret në mbështetje të arsimit dhe i njëkohshëm me përkushtimin për një Prishtinë më të qëndrueshme dhe më të gjelbër”, kishte thënë ndër të tjera, kryetari i NSKAP-it për Prishtinë, Qamil Hajdini.

SBASHK-u e kishte falënderuar Komunën e Prishtinës për realizimin e këtij vendimi, derisa kishte njoftuar të gjithë mësimdhënësit, stafin mbështetës dhe nxënësit se këtë lirim nga pagesa mund ta shfrytëzonin që nga 1 tetori 2025.



SBASHK organizoi Seminar dyditor në Ferizaj e Pejë

“Forcimi i Angazhimit të Anëtarësisë me Fokus Gratë dhe të Rinjtë”



SBASHK-u në mbështetje të Qendrës së Solidaritetit, kishte organizuar një Seminar dyditor gjatë javës së fundit të tetorit, me temë “Forcimi i Angazhimit të Anëtarësisë me Fokus Gratë dhe të Rinjtë”.



Seminari i kishte filluar punimet të shtunën, më 25 tetor, në Ferizaj, ku hapjen e kishte bërë kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, i cili i kishte uruar pjesëmarrësit për angazhimin aktiv në sindikatë dhe forcimin e rolit të saj në shoqëri.

Fjalë rasti dhe përshëndetje për pjesëmarrësit kishte edhe zyrtarja e Programit në Qendrën e Solidaritetit, Bruna Hylviu, e cila i kishte falënderuar pjesëmarrësit nga rajoni i Ferizajt dhe u kishte dëshiruar punime të frytshme gjatë tryezave të përcaktuara me agjendë.

Hylviu kishte mbajtur edhe një prezantim me temë “Pse u bëra pjesë e sindikatës”, ku e kishte sqaruar rolin e sindikatës dhe ngritjen e saj në shoqëri.



Në sesionin e parë të seminarit, diskutim kishte mbajtur Visar Ymeri, drejtor ekzekutiv i Institutit për Politika Sociale “Musine Kokalari”,

me temë: Si duket një anëtarësi e fortë me fokus të rinjtë dhe gratë? Sesioni i dytë, po ashtu i mbajtur nga Visar Ymeri, kishte për temë “Zgjedhjet si mundësi për anëtarësim të grave dhe të rinjve”, derisa seminari kishte vazhduar me diskutimin mbi “Mjetet e komunikimit për angazhimin e anëtarëve gra dhe të rinj”, nga sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri.



Sesioni i tretë i seminarit kishte për temë “Planifikimin dhe Veprimin” (grup pune), i cili ishte udhëhequr nga nënkryetarja e SBASHK-ut, Vjollca Shala, derisa përmbyllja e seminarit në Ferizaj ishte bërë nga Bruna Hylviu nga Qendra e Solidaritetit dhe kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj.



Dita e dytë e seminarit, me temë “Forcimi i angazhimit të anëtarësisë me fokus gratë dhe të rinjtë”, kishte vazhduar në Pejë në ditën e diel.

Edhe në ditën e dytë, seminari ishte hapur nga kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, i cili i kishte uruar pjesëmarrësit për angazhimin aktiv në sindikatë dhe forcimin

e rolit të sindikatës në shoqëri.



Fjalë rasti dhe përshëndetje për pjesëmarrësit kishte edhe zyrtarja e programit në Qendrën e Solidaritetit, Bruna Hylviu, e cila i kishte falënderuar pjesëmarrësit nga rajoni i Pejës dhe u kishte dëshiruar punime të frytshme gjatë tryezave të përcaktuara me agjendë.

Po ashtu, Hylviu e kishte bërë edhe një prezantim me temë “Pse u bëra pjesë e sindikatës”, ku e kishte sqaruar rolin e sindikatës dhe ngritjen e tij në shoqëri.



Në sesionin e parë të seminarit ishte diskutuar rreth temës se “Si duket një anëtarësi e fortë me fokus të rinjtë dhe gratë”, nga hulumtuesi i lartë i Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD), Naim Jakaj.

Jakaj e kishte mbajtur edhe sesionin e dytë të seminarit me temë “Zgjedhjet në sindikatë si mundësi për anëtarësim të grave dhe të rinjve”. Kurse, sesioni i tretë kishte vazhduar me diskutimin mbi “Mjetet e komunikimit për angazhimin e anëtarëve gra dhe të rinj”, nga sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri.



Sesioni i katërt i seminarit kishte për temë “Planifikimi dhe Veprimi” (grup pune), i cili ishte udhëhequr nga nënkryetarja e SBASHK-ut, Vjollca Shala, derisa përmbyllja e seminarit në Pejë ishte bërë nga Bruna Hylviu, nga Qendra Amerikane e Solidaritetit dhe kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj.

SBASHK gjatë tetorit mbajti tri kuvende zgjedhore: në Shtime, Viti dhe Rahovec, dhe zgjodhi kryetarin në Klinë

zgjedhjet nëpër shoqata dhe ishin bërë përgatitjet paraprakisht.



SBASHK gjatë muajit tetor kishte organizuar zgjedhjet e Nivelit Sindikal Komunal në tri komuna të ndryshme të Kosovës në të cilat kishin përfunduar



Të mërkurën e 29 tetorit, Kuvendi Zgjedhor ishte mbajtur në Shtime, ku për kryetar të Nivelit Sindikal Komunal të Shtimes ishte zgjedh Bekim Krasniqi, ndërsa nënkryetare Pranvera Sylaj. Në këtë Kuvend Zgjedhor, po ashtu ishte zgjedh kryesia e re e NSKAP-it të Shtimes, delegatët për Kongresin e SBASHK-ut si dhe anëtarët për Këshillin Drejtues të SBASHK-ut.

Gjatë procesit zgjedhor në Shtime ishin të pranishëm edhe përfaqësues të lartë të SBASHK-ut: kryetari Rrahman Jasharaj, nënkryetarja Vjollca Shala, sekretari i Përgjithshëm Ymer Ymeri, kryetarja e Nivelit Sindikal të Arsimit të Mesëm të Kosovës, Hanife Salihu dhe kryetari i Komisionit Statutar, Blendor Shatri.

Procesi zgjedhor në Shtime ishte zhvilluar në mënyrë të rregullt, demokratike dhe pa asnjë pengesë.

Kuvendi i NSKAP-it të Shtimes i kishte propozuar Kongresit të SBASHK-ut kandidaturën e Blendor Shatrit për kryetar të SBASHK-ut, ndërsa kishte propozuar që Ymer Ymerit t'i vazhdojë edhe një mandat si sekretar i Përgjithshëm i SBASHK-ut.



Zgjedhjet sindikale ishin zhvilluar në të njëjtën ditë edhe në Viti, ku kryetare ishte zgjedh Makfirete Zuka, ndërsa nënkryetar Muhamet Avdiu.

Në Kuvendin Zgjedhor të Vitisë ishte zgjedh edhe kryesia e re, delegatët për Kongresin e SBASHK-ut, si dhe anëtarët për Këshillin Drejtues të SBASHK-ut.

Edhe në procesin zgjedhor në Viti ishin të pranishëm përfaqësues të lartë të SBASHK-ut: kryetari, Rrahman Jasharaj, nënkryetarja Vjollca Shala, sekretari i Përgjithshëm Ymer Ymeri dhe kryetari i Komisionit Statutar, Blendor Shatri.



Procesi zgjedhor në Viti ishte zhvilluar në mënyrë të rregullt, demokratike dhe pa asnjë pengesë. Po ashtu, Kuvendi i NSKAP-it të Vitisë i kishte propozuar Kongresit të SBASHK-ut kandidaturën e Blendor Shatri për kryetar të SBASHK-ut, ndërsa kishte propozuar që Ymer Ymerit t'i vazhdohet edhe një mandat si sekretar i Përgjithshëm i SBASHK-ut.



Ndërsa në Rahovec, Kuvendi Zgjedhor i Nivelit Sindikal të Arsimit Parauniversitar ishin mbajtur të enjten e 30 tetorit 2025. Në orët e pasdites në Rahovec ishte mbajt Kuvendi Zgjedhor i Nivelit Sindikal të Arsimit Parauniversitar, në të cilin kishin marrë pjesë: Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, sekretari i Përgjithshëm, Ymer Ymeri dhe kryetari i Komisionit Statutar të SBASHK-ut, Blendor Shatri. Para fillimit të punimeve të Kuvendit, kryetari Jasharaj së bashku me Ymer Ymeri, Blendor Shatri, kryetarin e NSKAP-it të Rahovecit Veli Morina dhe anëtarin e Kryesisë, Xhyllsime Sylka, kishin vizituar edhe grupin e trajnimit që po zhvillohej në Rahovec, organizuar nga SBASHK në kuadër të programit “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”.



Gjatë vizitës, ata kishin bashkëbiseduar me pjesëmarrësit, i kishin inkurajuar për angazhimin e tyre dhe u ishin përgjigjur pyetjeve të parashtruara.



Pas kësaj vizite, Kuvendi Zgjedhor ishte shpall i hapur nga kryetari i NSKAP-it, Veli Morina. Pas miratimit të rendit të ditës, fjalën përshëndetëse e kishte marrë kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj dhe sekretari i Përgjithshëm, Ymer Ymeri, të cilët i kishin përgëzuar strukturat sindikale të Rahovecit për organizimin, unitetin dhe kontributin e tyre të vazhdueshëm në forcimin e sindikatës.



Më pas, kryetari i Komisionit Statutar, Blendor Shatri, i kishte informuar të pranishmit për procedurat e parapara statutore që duhej ndjekur gjatë ecurisë së punimeve të Kuvendit.

Pas paraqitjes së raportit të punës dhe raportit financiar për periudhën katërvjeçare, Kuvendi kishte vazhduar me procesin e votimit për zgjedhjen e kryetarit të NSKAP-it të Rahovecit.

Në bazë të votimit të fshehtë, nga tre kandidatët e propozuar, me shumicë votash ishte zgjedh kryetar Mehmet Kryeziu, ndërsa nënkryetare Elife Maxhuni Hoti. Në Kuvend ishin zgjedh edhe anëtarët e Kryesisë,

komisioni mbikqyrës, delegatët për Kongresin e SBASHK-ut si dhe ishin propozuar anëtarët për Këshillin Drejtues të SBASHK-ut.



Kuvendi, në frymën e bashkëpunimit dhe respektit për kontributet e deritanishme, kishte propozuar Blendor Shatri si kandidat për kryetar të SBASHK-ut, ndërsa Kongresit të SBASHK-ut I ishte propozuar që Rrahman Jasharaj të shpallet Kryetar Nderi i SBASHK-ut, në shenjë mirënjohjeje për kontributin e tij të jashtëzakonshëm shumëvjeçar në udhëheqjen dhe forcimin e sindikatës dhe që Ymer Ymeri të rizgjidhet sekretar i Përgjithshëm për një mandat të ri.

Punimet e Kuvendit kishin përfunduar me urime për të zgjedhurit dhe me zotimin e strukturave sindikale të Rahovecit për të vazhduar me përkushtim mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve të arsimit dhe forcimin e mëtejshëm të SBASHK-ut.

Këto kuvende ishin organizuar në kuadër të zgjedhjeve të rregullta, të cilat gjatë vitit 2025 ishin mbajtur në të gjitha shoqatat sindikale dhe në të gjitha nivelet komunale, universitare dhe të kulturës që veprojnë në kuadër të SBASHK-ut.



SBASHK, po ashtu të enjten e 30 tetorit kishte organizuar edhe rizgjedhjen e kryetarit të NSKAP-it për Klinë, pas dorëheqjes së kryetarit të deritashëm, Arif Elezaj i cili kishte dhënë dorëheqje për shkak të pjesëmarrjes së tij në garën për zgjedhjet lokale në Komunën e Klinës.



Në mesin e tre kandidatëve, me votim të fshehtë, për kryetare të NSKAP-it të Klinës ishte zgjedh Njomza Limani. Po ashtu, edhe Kuvendi i NSKAP-it të Klinës kishte propozuar Blendor Shatri për kryetar të SBASHK-ut.

SBASHK mbajti edhe disa Kuvende Pune.

Gjatë muajit tetor SBASHK kishte organizuar edhe disa Kuvende Pune, si paraprijëse të Kuvendeve zgjedhore nëpër Nivele Sindikale Komunale.



Dy Kuvende të tilla ishin mbajtur në Ferizaj e në Viti. Në Ferizaj, kryetari i Nivelit Komunal Sindikal për Arsimin Parauniversitar, Fejzullah Vranovci, i kishte përshëndetur të pranishmit dhe kishte falënderuar për pjesëmarrje kryetarin e SBASHK-ut, Rahman Jasharaj dhe kryetarin e Komisionit Statutor, Blendor Shatri. Pas kësaj, kryetari Jasharaj kishte shprehur respekt të lartë për angazhimet e kryetarit Vranovci dhe të shumë veprimtarëve sindikal nga kjo komunë, ndërsa kryetari i komisionit statutor, Blendor Shatri, i kishte informuar të pranishmit për ndryshimet statutorë që ka bërë Kongresi i nëntë i jashtëzakonshëm. Shatri pastaj u ishte përgjigjur edhe pyetjeve të anëtarëve të këtij Kuvendi Sindikal.



Në një atmosferë përkushtimi ishte zhvilluar edhe takimi në Viti. Kryetari i Nivelit Komunal Sindikal për Arsimin Parauniversitar në Viti, Kemajl Bislimi, kishte përshëndetur pjesëmarrësit dhe kishte falënderuar për pjesëmarrje kryetarin e SBASHK-ut, Rahman Jasharaj dhe kryetarin e Komisionit Statutar Blendor Shatri. Në vazhdim të punimeve të këtij kuvendi, kryetari i Komisionit Statutar, Blendor Shatri po ashtu edhe pjesëmarrësit në Viti i kishte informuar për ndryshimet statutorë që



kishte bërë Kongresi i nëntë i jashtëzakonshëm, për t'u përgjigjur edhe në pyetjet e anëtarëve të këtij Kuvendi Sindikal.

Takime të njëjta pune ishin zhvilluar paraprakisht edhe në Klinë, Shtime e Rahovec. Në këto kuvende ishte diskutuar: përfshirja e të rinjve në udhëheqësitë sindikale komunale; puna e bërë dhe angazhimet që po vazhdojnë nga shoqatat sindikale dhe nivelet komunale; caktimi i datave për mbajtjen e kuvendeve zgjedhore; sugjerimet për kandidatët e mundshëm që do të udhëheqin sindikatën në mandatin e ardhshëm.

Në këto takime kishte marrë pjesë edhe Kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj, së bashku me sekretarin e Përgjithshëm, Ymer Ymeri dhe kryetarin e Komisionit Statutar, Blendor Shatri.

Në bashkëbisedim me anëtarët e kuvendeve ishin trajtuar edhe çështjet sindikale që preokupojnë anëtarësinë, duke theksuar rëndësinë e unitetit, përfaqësimit dinjitoz dhe fuqizimit të rolit të rinisë në organizimin sindikal.

SBASHK u përfaqësua në dy konferenca të rëndësishme të arsimit në Poloni e Danimarkë



SBASHK, gjatë muajit tetor ishte përfaqësuar në dy konferenca të rëndësishme ndërkombëtare sa i përket zhvillimit të arsimit dhe mësimdhënësve në Kosovë.



Në Varshavë të Polonisë, SBASHK i përfaqësuar nga sekretari i Përgjithshëm, Ymer Ymeri dhe nënkryetarja Vjollca Shala, kishin marrë pjesë në “Tryezën e Mësimi nga Bashkëmoshatarët” (Peer Learning Activity), ku ishte diskutuar edhe për bllokimin e dialogut social në Kosovë.

Në këtë veprimtari, që ishte organizuar nga Federata Evropiane e Punëdhënësve të Arsimit (EFEE) dhe Komiteti Evropian i Sindikatave për Arsim (ETUCE), ishin pjesëmarrës përfaqësues nga shumë vende evropiane.

Delegacioni i SBASHK-ut kishte zhvilluar një takim të rëndësishëm me Kryetarin e ETUCE-së, John MacGabhann, ku ishte diskutuar për bllokimin e dialogut social në Kosovë dhe për mundësinë e nënshkrimit të Kontratës Kolektive nga MASHTI. Diskutimet në këtë tryezë ishin përqendruar në tema si: rritja e atraktivitetit të profesionit të mësuesisë, koha e punës së mësimdhënësve

në vendet evropiane, mirëqenia dhe sfidat e mësimdhënësve, si dhe forcimi i dialogut social në arsim.



Po ashtu, gjatë këtij muaji, SBASHK-u ishte përfaqësuar edhe në Konferencën Evropiane për Inteligjencën Artificiale dhe Arsimin në Kopenhagë, Danimarkë. Me temën “Ndërtimi i një strategjie sindikale për avokimin dhe negociatat kolektive”, e mbajtur më 7 dhe 8 tetor 2025 nën organizimin e Unionit Evropian të Sindikatave të Arsimit (ETUCE), kishte marrë pjesë nënkryetarja e SBASHK-ut, Vjollca Shala dhe sekretari i Përgjithshëm Ymer Ymeri.



Konferenca ishte hapur nga John MacGabhann, kryetar i ETUCE-së, i cili i kishte përshëndetur të pranishmit dhe kishte theksuar rëndësinë e përfshirjes aktive të përfaqësuesve të mësuesve dhe sindikatave të arsimit në çdo hap të zhvillimeve dhe reformave arsimore. Ai kishte nënvizuar se përdorimi i inteligjencës artificiale në arsim është një proces që po zhvillohet me shpejtësi; ndaj, qeveritë e vendeve evropiane duhet të sigurojnë pjesëmarrjen dhe rolin vendimmarrës të sindikatave të arsimit në hartimin e politikave dhe strategjive që prekin mësuesit, nxënësit dhe procesin arsimor në tërësi.



Në emër të sindikatave pritëse, të pranishmit i kishte përshëndetur edhe Anders Bærholm Frikke, kryetar i GL Danimarkë dhe Lasse Bjerg Jørgensen, kryetar i Marrëdhënieve të Brendshme në BUPL Danimarkë, dhe njëherësh nënkryetar i ETUCE-së, të cilët kishin theksuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet sindikatave për të siguruar që transformimi digjital dhe AI të kontribuojnë në përmirësimin e kushteve të punës dhe cilësisë së arsimit, e jo në rritjen e pabarazive.

Në vijim, me temën “Sindikatat e Arsimit dhe Inteligjenca Artificiale – Çfarë kemi bërë dhe rruga përpara”, kishte diskutuar edhe Jelmer Evers, drejtor i ETUCE-së dhe njëkohësisht Drejtor për Evropë në Sindikatën Botërore të Edukimit (Education International). Ai kishte prezantuar nismat e deritashme të ETUCE-së në fushën e digjitalizimit, përfshirë zhvillimin e udhëzimeve për përdorimin etik dhe të drejtë të teknologjive të AI në arsim, si dhe rëndësinë e ndërtimit të strategjive sindikale për negociata kolektive që mbrojnë të drejtat e mësimitdhënësve në epokën digjitale.

Gjatë muajit tetor SBASHK kishte filluar me katër trajnime dhe kishte vazhduar me disa të tjera që ishin në proces

SBASHK vazhdon mbështetjen e mësimitdhënësve përmes trajnimeve të ndryshme

Gjatë muajit tetor, SBASHK kishte organizuar katër trajnime në komuna të ndryshme të Kosovës. Në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimitdhënie”, të shtunën e 18 tetorit kishte filluar me dy grupe trajnimi në Skenderaj, të cilat ishin udhëhequr nga trajneret e përcaktuara nga SBASHK, Fatlume Mehmeti dhe Arbenita Gashi. Mësimitdhënësit gjatë fillimit të trajnimit i kishte vizituar edhe kryetari i NSKAP-it për Skenderaj, Shpend Rexha, i cili u kishte dëshiruar atyre arritje sa më të larta në zhvillimin profesional.



Konferenca ishte mbajtur më 7 dhe 8 tetor 2025, me sesione tematike që kishin trajtuar: ndikimin e AI në procesin e mësimitdhënies dhe të nxënës; nevojën për formim të vazhdueshëm profesional për mësimitdhënësit; çështjet etike dhe të privatësisë që lidhen me përdorimin e të dhënave në arsim; dhe ndërtimin e një qasjeje të përbashkët evropiane për të garantuar që transformimi digjital të jetë në shërbim të njerëzve dhe arsimit cilësor për të gjithë.

Përfaqësuesit e SBASHK-ut kishin marrë pjesë aktive në diskutime, duke ndarë përvojën e Kosovës dhe qëndrimet e sindikatës sonë mbi rëndësinë e përfshirjes së mësimitdhënësve në proceset e reformave digjitale, si dhe mbi nevojën për garantimin e mbrojtjes së të drejtave të punës në kohën e shpejtë të zhvillimeve teknologjike.

Dy grupet e trajnimit i kishte vizituar edhe sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri dhe kryetari i Komisionit Statutar të SBASHK-ut, Blendor Shatri.



Gjatë vizitës, ata kishin zhvilluar një bashkëbisedim të hapur me pjesëmarrësit duke diskutuar jo vetëm për rrjedhën dhe rëndësinë e trajnimeve por edhe

përçështje të ndryshme sindikale që preokupojnë anëtarësinë. Ymeri dhe Shatri kishin dhënë përgjigje të detajuara e sqaruese ndaj pyetjeve të ngritura nga pjesëmarrësit, duke theksuar përkushtimin e SBASHK-ut për të qenë gjithmonë pranë anëtarëve të vet.



Në fund të takimit, të gjithë pjesëmarrësit në trajnim kishin shprehur mirënjohje dhe falënderim të veçantë për SBASHK-un, me në krye kryetarin, Rrahman Jasharaj, për angazhimin e vazhdueshëm në avancimin profesional të mësimeve dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre.




Me një grup të mësimeve në po të njëjtin program, “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësime”, në muajin tetor kishte filluar edhe komuna e Kaçanikut, i cili ishte udhëhequr nga trajneri i përzgjedhur nga SBASHK, Naser Guri. Për të përcjellur mbarëvajtjen e tij, mësimeve i kishte vizituar kryetari i NSKAP-it për Kaçanik, Islam Berisha i cili u kishte dëshiruar mësimeve punë të mbarë drejt zhvillimit të karrierës.



Ndërsa në Pejë, një grup i trajnimit në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësime”, kishte filluar të shtunën e 18 tetorit, nën udhëheqjen e trajnerit të përcaktuar nga SBASHK, Burim Krasniqi. Për të parë nga afër mbarëvajtjen e trajnimit, mësimeve i kishte vizituar edhe kryetari i NSKAP-it për Pejë, Isuf Lajçi, i cili u kishte dëshiruar mësimeve suksese në karrierë dhe në ngritje profesionale.



Gjatë po këtij muaji, SBASHK kishte organizuar edhe testin për një grup të mësimeve që e kishin përfunduar me sukses trajnimin në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësime”, në Lipjan, nën udhëheqjen e trajnerit të përcaktuar nga SBASHK, Idriz Sopa.



Testi i cili ishte organizuar në shkollën “Ismail Luma” në Lipjan, ishte administruar nga sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri, si dhe zyrtarja Nezafete Jakupi, derisa i pranishëm për ta përcjellur mbarëvajtjen e testit ishte edhe kryetari i NSKAP-it për Lipjan, Emrush Ahmeti.

SBASHK vazhdon angazhimin në shërbim të anëtarësisë me organizmin e trajnimeve në të gjitha komunat e Kosovës.

SBASHK vizitoi Drejtorinë e Arsimit në Prishtinë



Në kuadër të takimeve të rregullta me Drejtoritë Komunale të Arsimit, me qëllim të forcimit të bashkëpunimit në shërbim të arsimit, kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, së bashku me sekretarin e Përgjithshëm Ymer Ymeri, zyrtarin Ligjor Blendor Shatri dhe kryetarin e Kuvendit të Nivelit Sindikal të Arsimit Parauniversitar për kryeqytetin, Qamil Hajdini, kishin vizituar Drejtorinë e Arsimit në Prishtinë, ku ishin pritur nga drejtori i DKA-së, Samir Shahini.

Kryetari Jasharaj e kishte falënderuar drejtorin Shahini për bashkëpunimin e shkëlqyer me SBASHK-un në funksion të përmirësimit të arsimit dhe të mbrojtjes së të drejtave të punëtorëve arsimorë. Ai kishte theksuar se gjatë këtij takimi ishin diskutuar disa nga çështjet e ngritura nga anëtarët e SBASHK-ut.

Sekretari i Përgjithshëm Ymer Ymeri, zyrtari Ligjor Blendor Shatri dhe kryetari sindikal, Qamil Hajdini, ishin ndalur në disa çështje specifike, përfshirë:

- Organizimin e mësimin tërëditor,
- Angazhimin e disa mësimdhënësve në cilësinë e mësuesve të aktiviteteve në shkollat që zhvillojnë mësimin tërëditor,
- Çështjen e pushimit mjekësor për mësimdhënësit.

Përfaqësuesit e SBASHK-ut, ashtu si edhe në takimet e mëparshme, kishin ritheksuar përkrahjen e sindikatës për organizimin e mësimin tërëditor, me qëllim të arritjes së rezultateve më të mira në cilësinë e arsimit. Po ashtu, ishte theksuar edhe rëndësia e kësaj forme organizimi për faktin se po krijohet mundësi për ruajtjen dhe rritjen e numrit të të punësuarve në arsim. Ata kishin sqaruar se mësuesit e rregullt janë të angazhuar vetëm në procesin mësimor bazë, përveç atyre që me dëshirë zgjedhin të marrin pjesë edhe në aktivitete të tjera, për të cilat kompensohen me pagesë shtesë. Drejtori Shahini kishte falënderuar përfaqësuesit e SBASHK-ut për vizitën, duke i përgëzuar për angazhimin e tyre të vazhdueshëm në përkrahje të mësimdhënësve. Ai kishte theksuar se bashkëpunimi me SBASHK-un do të vazhdojë përmes takimeve të rregullta dhe dialogut të hapur për të gjitha

çështjet që lidhen me arsimin në kryeqytet.

Lidhur me mësimin tërëditor, drejtori Shahini kishte dhënë sqarime rreth organizimit dhe kishte theksuar se ky model synon përmirësimin e cilësisë në arsim. Ai kishte siguruar se asnjë punonjës arsimor nuk do të mbetet pa normën e tij të punës dhe se mësuesit e aktiviteteve kanë kontrata të njëjta pune me mësuesit e klasave, prandaj nuk duhet të kenë shqetësime për sigurinë e vendeve të tyre të punës. Për më tepër, Shahini kishte shtuar se me zgjerimin e institucioneve që zhvillojnë mësim tërëditor, janë punësuar edhe mësimdhënës që më parë kanë qenë në pritje të punësimit. Drejtori Shahini e kishte përmbyll takimin duke theksuar se bashkëpunimi i ndërsjellë do të vazhdojë dhe se do të ketë takime të tjera për të adresuar në mënyrë të përbashkët të gjitha çështjet që prekin arsimin dhe punëtorët arsimorë në kryeqytetin e Kosovës.

SBASHK nënshkruan marrëveshje mirëkuptimi me Banjën e Kllokotit “Nëna Naile”



SBASHK i përfaqësuar nga kryetari Rahman Jasharaj ka nënshkruar marrëveshje mirëkuptimi me Spitalin Special me Terapi Fizikale dhe Rehabilitim, Banja e Kllokotit “Nëna Naile” në Kllokot, të përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm, Yll Morina, me autorizimin e drejtorit të Përgjithshëm, Dardan Novosella.



Me këtë marrëveshje SBASHK-u u mundëson të gjithë anëtarëve të vet shfrytëzimin e shërbimeve të Banjës “Nëna Naile” në Kllokot me zbritje, ku përfshihen të gjitha shërbimet standard të Banjës duke filluar nga kontrolla fillestare mjekësore, ushtrimi i terapive të caktuara nga mjeku specialist i fiziatrisë, ushqimi dhe fjetja, sipas marrëveshjes.

Marrëveshja është nënshkruar më 28 tetor 2025 dhe vlen për një vit. SBASHK mbetet i përkushtuar në ofrimin e shërbimeve shëndetësore me kosto sa më të ulët për anëtarët e vet duke lidhur marrëveshje me qendra të ndryshme spitalore në vend.

SBASHK-u nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me “Move center”

SBASHK-u ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me qendrën e fizioterapisë “Move center”, me qëllim të ofrimit të zbritjes për anëtarësinë e SBASHK-ut deri në 50 për qind në shërbimet e kësaj qendre.

Marrëveshja është nënshkruar nga përfaqësuesi i SBASHK-ut, Qamil Hajdini dhe Move Center, e përfaqësuar nga fizioterapeuti, Endrit Memeti, e cila ka për qëllim ofrimin 50% zbritje dhe përfitime ekskluzive për të gjithë anëtarët e Sindikatës në shërbimet e “Move center” si: Fizioterapi, Pilates dhe Baby Spa.

Ky bashkëpunim është një hap i rëndësishëm drejt mbështetjes së mësimdhënësve dhe stafit arsimor, duke u mundësuar atyre të kujdesen për shëndetin, relaksin dhe mirëqenien e tyre me kushte të veçanta. Oferta vlenë në pikat: Prishtinë dhe Gjiilan.



Marrëveshje e Re Bashkëpunimi
Move Center & Sindikata e Arsimit -50%

SBASHK me trajnim për forcimin e dialogut social

SBASHK mbajti trajnim për trajnerët dhe udhëheqësit e sindikatës së nivelit komunal

SBASHK gjatë muajit nëntor kishte organizuar një trajnim për përfaqësuesit e sindikatës në nivel komunal dhe sindikalistët e rinj, në programin “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social”.



Në trajnimin katërditor kishte marrë pjesë edhe kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, i cili kishte mbajtur një fjalë rasti, ku i kishte inkurajuar pjesëmarrësit për zhvillimin e dialogut social në kuadër të sindikatës, por edhe zhvillimin e një dialogu të mirëfilltë sindikatë-punëdhënës.



Në ditën e parë të trajnimit, po ashtu, zyrtarja për programe në Qendrën e Solidaritetit, Bruna Hylviu, qendër kjo e cila edhe e kishte mbështetur trajnimin, kishte bërë një prezantim të objektivave dhe agjendës së trajnimit, si dhe ishte zhvilluar një diskutim i lirë.

Gjatë këtij trajnimi ishte diskutuar se çfarë është dialogu social – përkufizimi, zhvillimi dhe sfidat kryesore. Ndërsa, me temë: “Rëndësia e dialogut social për sindikatat dhe punëtorët në sektorin e arsimit”, një ligjëratë ishte mbajtur nga trajneri Safet Beqiri.



Gjatë trajnimit, përfaqësuesit e SBASHK-ut, nënkryetarja Vjollca Shala dhe sekretari i Përgjithshëm, Ymer Ymeri, kishin shtjelluar temën “Dialogu Social Kombëtar, Partnerët dhe interesat e tyre”, ku ishte diskutuar eksperiencia e SBASHK-ut në përfaqësimin e mësuesve dhe punonjësve të arsimit në mekanizmat e dialogut kombëtar.



Gjatë trajnimit ishin mbajtur edhe ushtrime praktike rreth identifikimit të interesave të punëtorëve, interesave të punëdhënësve dhe qëllimeve të përbashkëta. Po ashtu, ishin dhënë shembuj nga përvoja e SBASHK-ut në negociata dhe bashkëpunim me institucionet publike, të cilat u prezantuan nga përfaqësuesit e SBASHK-ut.



Ndërkohë, në trajnim ishte mbajtur ligjëratë edhe sa i përket Dialogut Social Evropian, rreth Këshillit Evropian të Punës dhe funksioneve të tij. Në kuadër të këtij diskutimi, ligjëratë me temën “Mundësitë që sindikatat e arsimit të angazhohen në platformat evropiane të dialogut” ishte mbajtur nga trajneri Alban Zeneli.



Gjatë trajnimit ishte diskutuar edhe sa i përket Këshillit Ekonomik Social në Kosovë, strukturës, funksioneve dhe organeve kryesore të tij. Me temë “Roli i BSPK-së/SBASHK-ut në KES-në dhe në përfaqësimin e sektorit të arsimit”, ligjëratë kishte mbajtur trajneri Safet Beqiri. Ndërsa, rreth Dialogut Social Evropian – përkufizimi, funksionimi dhe përfshirja e sindikatës, ligjëratë kishte mbajtur trajneri Alban Zeneli, me titull “Praktikat e mira nga sindikatat evropiane të arsimit”.



Një ndër temat e diskutimit gjatë këtij trajnimit ishte edhe “Strategjitë e konfliktit dhe zgjidhjes”, e cila ishte mbajtur nga zyrtari Ligjor në SBASHK, Blendor Shatri, ku ishte trajtuar përkufizimi i konfliktit dhe metodat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në vendin e punës. Në këtë kontekst, ishin dhënë shembuj të rasteve të SBASHK-ut për menaxhimin e konflikteve në sektorin e arsimit.



Gjithashtu, ishte mbajtur një ushtrim praktik në grup me temë: “Trajtimi i konflikteve të përditshme të lidhura me sindikatat dhe identifikimi i zgjidhjeve”, i cili ishte zhvilluar nga pjesëmarrësit.



Në fund të trajnimit, ishin dhënë vlerësime, përmbledhje të rezultateve dhe reflektim mbi rolin e SBASHK-ut në forcimin e dialogut social.

SBASHK dorëzoi kallëzim penal ndaj Ministrit në detyrë, Hekuran Murati

Republika e Kosovës - Republika of Kosovo
Shtetësi e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
 The Union of Education, Science and Culture
 Pristina, Kosovo | 11000 | Tel: +383 11 222 2222 | Email: info@sbashk.org

PROKURORISË THEMELORE NË PRISHTINË
 DEPARTAMENTI PËRGJITHSHËM

Nu. baz. 11.1.2025 në em. 09.10.2025 në Prokurorinë Themelore në Prishtinë

KALLËZIM PENAL

Kallëzimi është dorëzuar nga Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, Hekuran Murati, në datën 11.1.2025.

SEPSË

Për shkak të dyshimit në bazuar në veprimet e shprehura në Kallëzimin Penal, kështu që Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, Hekuran Murati, ka vepruar në përputhje me kompetencat ligjore për të shprehur fjalimin e Kallëzimit të KES-së (KES), që është përfshirë në Ligjin Nr. 044-908 për Këshillin Ekonomik-Social.

I. Përshkrimi i faktit dhe veprimeve të kundërligjshme

Kallëzimi është dorëzuar në datën 11.1.2025, kur ka shprehur mendimin e Këshillit Ekonomik-Social të Republikës së Kosovës, Ministrin i Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, Hekuran Murati, që ka vepruar në përputhje me kompetencat ligjore për të shprehur fjalimin e Kallëzimit të KES-së (KES), që është përfshirë në Ligjin Nr. 044-908 për Këshillin Ekonomik-Social.

II. Baza ligjore

Nu. 3 - Qëndrimi i themelimi të Këshillit Ekonomik-Social

Këshilli Ekonomik-Social (KES) themelohet në qëllim të vendosjes dhe zhvillimit të dialogut social në Republikën e Kosovës, për të përcaktuar dhe përcaktuar, për qëllim të shprehjes së veçantë që lidhet me marrëmbimin e të drejtave të tyre ekonomike, sociale dhe profesionale.

Republika e Kosovës - Republika of Kosovo
Prokurorinë Themelore në Prishtinë / Prokurorinë Themelore / Prokurorinë Themelore

Nu. i dokumentit: 0409717

ZYRA E PRANIMIT

BLENDOR SHATRI në datën 11.1.2025 në em. 09.10.2025 në Prokurorinë Themelore në Prishtinë

Udhë i dokumentit	Nr. i dokumentit	Data e dokumentit	Nr. i faqeve
Kallëzimi Penal	2225/1	11.1.2025	4

Tjerr: NGA SBASHK

Drejtori: [Signature]

Pasuri: [Signature]

BLENDOR SHATRI

Bejta Fejzullahu

SBASHK kishte dorëzuar kallëzim penal në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, te Departamenti i përgjithshëm, ndaj ministrit në detyrë, Hekuran Murati, për shkak të dyshimit të bazuar të keqpërdorimit të detyrës zyrtare, duke mos vepruar sipas Ligjit për Këshillin Ekonomik Social, duke mos shpallur që nga fundi i vitit 2022 ftesën për formimin e këtij Këshilli, për çka është i obliguar ligjërisht. Me këtë mosveprim, Murati ka shkaktuar dëme të palës së tretë, pra sindikatave dhe anëtarëve të sindikatave në

tërë Kosovën, duke pamundësuar diskutimin për Ligjet dhe rregulloret që prekin gjithë të punësuarit në Kosovë, e me theks të veçantë duke e lënë Kosovën pa Marrëveshjen Kolektive, si e drejtë që buron nga Ligji i

punës, dhe kështu Kosova mbetet si i vetmi shtet në rajon që nuk ka këtë Marrëveshje të nënshkruar.

SBASHK, pjesëmarrës në Konferencën Rajonale në Mal të Zi



Përfaqësuesit e SBASHK-ut, anëtari i Kryesisë, Blerim Mehmeti, dhe kryetari i Komisionit Statutor, Blendor Shatri, kishin marrë pjesë në Konferencën Rajonale në Mal të Zi, ku ishin diskutuar Ligji për Grevën dhe përvojat krahasuese të vendeve të rajonit.

Me këtë rast, kryetari i Komisionit Statutor në SBASHK, Blendor Shatri, kishte bërë një prezantim mbi Ligjin për Grevat në Kosovë dhe kishte sqaruar parimet bazë të tij. “Greva është një ndërprerje

e përkohshme e punës nga punëtorët për realizimin e kërkesave ekonomike, sociale apo profesionale. Punëdhënësi dhe Sindikata janë të detyruar të sigurojnë shërbimet minimale gjatë grevës në sektorët si: shëndetësia, energjia, ujësjellësi, transporti publik, siguria etj.”, ishte shprehur ndër të tjera Shatri.

Konferenca dyditore kishte përmbledhë prezantime dhe shkëmbime të përvojave edhe nga vendet tjera të Rajonit.

Përfaqësuesit e SBASHK-ut ishin në një vizitë tre-ditore në Holandë

SBASHK mori pjesë në Kongresin e Sindikatës së Arsimit “AOB” në Holandë



Përfaqësuesit e Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës së Kosovës – SBASHK, nënkryetarja Vjollca Shala dhe sekretari i Përgjithshëm Ymer Ymeri, gjatë muajit nëntor kishin qëndruar për vizitë zyrtare në Holandë, ku kishin marrë pjesë në Kongresin e Sindikatës së Arsimit të Holandës “AOB”.

Ky Kongres kishte mbledh përfaqësues të shumë sindikatave arsimore nga Evropa dhe më gjerë, duke krijuar një hapësirë të rëndësishme për dialog, bashkëpunim dhe shkëmbim përvojash mbi sfidat dhe drejtimit e arsimit publik.

Gjatë Kongresit kishte pjesëmarrje dhe diskutime strategjike, ku delegacioni i SBASHK-ut ishte pjesë aktive e sesioneve tematike, diskutimeve të organizuara dhe takimeve me sindikata dhe institucione partnere.



Kongresi kishte trajtuar çështje kyçe për të ardhmen e arsimit: mirëqenia e mësimdhënësve, financimi i arsimit publik, sfidat e kohës moderne në shkolla dhe roli i sindikatave në mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve të arsimit. Pjesëmarrja e SBASHK-ut në këtë Kongres përbën një hap të rëndësishëm në forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe shkëmbimit të përvojave me sindikatat evropiane.



Paraprakisht, delegacioni nga Kosova ishte prit nga udhëheqësit më të lartë të AOb, kryetarja Coba van der Veer dhe sekretari i Përgjithshëm Willem Naus, ku kishin zhvilluar një darkë të përbashkët në mbrëmje, e cila kishte shërbyer si mundësi e shkëlqyer për të diskutuar mbi zhvillimet në arsimin publik, sfidat e përbashkëta të mësimdhënësve, si dhe rrugët e reja të bashkëpunimit ndërmjet dy sindikatave. Gjatë bisedës, ishin shkëmbyer përvoja rreth rolit të sindikatave në mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve të arsimit, ndikimit të tyre në politikat publike dhe përpjekjeve për ngritjen e cilësisë së arsimit.




Përfaqësuesit e SBASHK-ut kishin mundësi të vizitonin edhe shkollën "Child Center LEF", ku ishin njohur nga afër me sistemin arsimor holandez. Gjatë kësaj vizite, nënkryetarja Vjollca Shala dhe sekretari i Përgjithshëm Ymer Ymeri ishin njohur me mënyrën se si funksionon shkolla, standardet pedagogjike, bashkëpunimin me prindërit dhe komunitetin, si dhe kushtet e punës së mësimdhënësve në këtë institucion. Përfaqësuesit e SBASHK-ut kishin vlerësuar organizimin profesional, respektimin e të drejtave të punës dhe mbështetjen e vazhdueshme që AOb u ofron mësimdhënësve anëtarë.

Pas vizitës në shkollë, delegacioni i SBASHK-ut, kishte marrë pjesë në një seminar dhe debat me fokus të sfidat e rekrutimit dhe mbajtjes së personelit të ri në sistemin arsimor. Ky diskutim, i organizuar në selinë e AOb, kishte trajtuar problemet që po hasin aktualisht shumë shtete evropiane: mungesën e mësimdhënësve të rinj, presionet e rritura mbi stafin ekzistues dhe nevojën për përmirësimin e kushteve të punës për tërheqjen e kuadrove të reja. Përfaqësuesit e SBASHK-ut kontribuan në diskutim, duke sjellë perspektivën kosovare dhe përvojat nga terreni, duke nënvizuar sfidat me të cilat përballen mësimdhënësit e rinj dhe rëndësinë e politikave të qëndrueshme për zhvillimin profesional të tyre.



Gjatë qëndrimit në Holandë ishte zhvilluar edhe ceremonia lamtumirëse për Sekretaren Ndërkombëtare të AOb, Trudy Kerperien, ku përfaqësuesit e SBASHK-ut kishin shprehur mirënjohje të veçantë për bashkëpunimin e ngushtë ndër vite, mbështetjen e saj të çmuar dhe përkushtimin në avancimin e marrëdhënieve ndërkombëtare të SBASHK-ut. Ajo ka qenë një zë i rëndësishëm në promovimin e vlerave sindikale dhe të drejtave të mësimdhënësve në nivel evropian. Vizita zyrtare treditore në Holandë ishte përmbyll më 23 nëntor, kur përfaqësuesit e SBASHK-ut ishin kthyer në Kosovë, duke sjellë me vete përvoja dhe ide të reja, që pritet të kontribuojnë në punën sindikale dhe avancimin e të drejtave të mësimdhënësve në vend.

SBASHK ka vazhduar me organizimin e trajnimeve për mësimdhënës edhe gjatë muajit nëntor SBASHK kishte organizuar 10 grupe trajnimi dhe tri teste për mësimdhënës gjatë muajit nëntor



Gjatë muajit nëntor, SBASHK-u kishte vazhduar me organizimin e trajnimeve për mësimdhënës në dy programe të ndryshme të trajnimit: “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” dhe “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social”, në të gjithë Kosovën.



Të shtunën e 22 nëntorit, SBASHK kishte filluar me shtatë grupe trajnimi në disa komuna të Kosovës. Tri grupe trajnimi kishin filluar në Prizren, dy grupe në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” – moduli 1 dhe moduli 2, të cilat po udhëhiqen nga trajnerët Naser Kastrati dhe Ermal Ahmetaj, respektivisht. Kurse një grup trajnimi në programin “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social” ishte udhëhequr nga trajneri i përcaktuar nga SBASHK, Gani Kryeziu.



Trajnimi në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” gjatë të njëjtit vikend kishte filluar edhe në komunën e Rahovecit, nën udhëheqjen e trajnerit të përcaktuar nga SBASHK-u, Emin Hoxha.



Ndërsa në Gjakovë kishte filluar një grup trajnimi në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, të cilin e kishte udhëheq trajnerja e përzgjedhur nga SBASHK, Litvana Spahija.



Grupet e trajnimit të filluara në Gjakovë e Prizren gjatë vikendit të parë i kishte vizituar edhe zyrtari ligjor në SBASHK, Blendor Shatri, i cili ishte njoftuar nga afër me mbarrëvajtjen e trajnimeve.



Gjatë takimeve me mësimdhënësit pjesëmarrës, Shatri ishte njoftuar me ecurinë e sesioneve, angazhimin e

trajnerëve dhe interesimin e lartë të pjesëmarrësve për të forcur aftësitë profesionale dhe teknologjike.

Shatri kishte vlerësuar organizimin e trajnimeve dhe kishte theksuar rëndësinë që këto programe kanë në zhvillimin profesional të mësimitdhënësve dhe në përmirësimin e cilësisë së procesit mësues.

Ndërkohë, një javë më parë, SBASHK-u kishte filluar edhe me tri grupe të tjera trajnimi.



Në Pejë, të dielën e 16 nëntorit SBASHK kishte filluar me një grup trajnimi në programin “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social”, nën udhëheqjen e trajnerit të përcaktuar nga SBASHK, Ilir Gashi.



Mësimitdhënësit që e kishin filluar trajnimin i kishte vizituar edhe kryetari i NSKAP-it për Pejë, Isuf Lajqi, i cili ishte kujdesur për mbarëvajtjen e fillimit të trajnimit dhe u kishte ofruar mbështetje mësimitdhënësve në zhvillimin e tyre profesional. Po ashtu, gjatë të njëjtit vikend kishin filluar edhe dy grupe trajnimi në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimitdhënie”.



Një grup në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimitdhënie – moduli 1” kishte filluar në Mitrovicë, nën udhëheqjen e trajnerit të përcaktuar nga SBASHK, Kadri Hyseni, kurse grupi tjetër në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimitdhënie – moduli 2” kishte filluar në Viti, nën udhëheqjen e trajnerit të përzgjedhur nga SBASHK, Musli Neziri.



Gjithashtu, gjatë muajit nëntor, SBASHK kishte organizuar edhe tri teste për mësimitdhënësit, të cilët e kishin përfunduar trajnimin në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimitdhënie”, në tri komuna të ndryshme të Kosovës. Në Kaçanik ishte mbajtur testi për një grup të mësimitdhënësve, nën administrimin e nënkryetares së SBASHK-ut, Vjollca Shala, derisa trajneri që e kishte udhëhequr këtë grup të trajnimit ishte Naser Guri. Gjatë mbajtjes së testit, i pranishëm ishte edhe kryetari i NSKAP-it për Kaçanik, Islam Berisha, i cili ishte kujdesur për mbarëvajtjen e testimit, i cili ishte mbajtur në shkollën “Emin Duraku”.



Paraprakisht, testi ishte mbajtur edhe për një grup të mësimitdhënësve në Rahovec, i cili ishte udhëhequr nga trajneri i përcaktuar nga SBASHK, Albert Samadraxha. Testi ishte administruar nga sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri dhe zyrtari ligjor, Blendor Shatri. Ndërsa për të përcjellë nga afër mbarëvajtjen e testit, I pranishëm ishte kryetari i NSKAP-it për Rahovec, Mehmet Kryeziu, nënkryetarja Elife Maxhuni-Hoti, si dhe ish-kryetari i NSKAP-it, Veli Morina.



Ndërsa, qysh në fillim të muajit nëntor, testi për një grup të mësimdhënësve të cilët e kishin ndjekur trajnimin në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, nën udhëheqjen e trajnerit Fejzullah Berisha, ishte organizuar edhe në Drenas. Testi në Drenas ishte administruar nga sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri, dhe zyrtarja Nezafete Jakupi. Kurse, për të përcjellë nga afër mbarëvajtjen e testit, i pranishëm ishte

kryetari i NSKAP-it për Drenas, Ilaz Dervishi.

SBASHK vazhdon organizimin e trajnimeve për mësimdhënësit, anëtarë të Sindikatës, në çdo komunë të Kosovës.



SBASHK kishte marrë pjesë në takimin e DKA-së në Prishtinë, me drejtorët e shkollave



Pavarësisht mungesës së vullnetit për dialog nga institucionet qendrore, përkatësisht Qeveria dhe MASHTI, SBASHK-u po vazhdon të organizojë rregullisht takime në nivel lokal, në interes të punëtorëve arsimorë. Një takim i tillë ishte mbajtur gjatë muajit nëntor me përfaqësues të Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA) në Prishtinë dhe me drejtorët e institucioneve arsimore të kryeqytetit.

SBASHK-u kishte marrë pjesë në këtë takim me ftesë të drejtorit të Arsimit në Prishtinë, Samir Shahini, ku të pranishëm ishin edhe drejtorët e shkollave të Prishtinës.

Në takim, SBASHK-u ishte përfaqësuar nga sekretari i Përgjithshëm, Ymer Ymeri, zyrtari ligjor, Blendor Shatri, dhe Kryetari i NSKAP-it për Prishtinë, Qamil Hajdini.

Përfaqësuesit e SBASHK-ut në këtë takim kishin marrë pjesë në cilësinë e vëzhguesve dhe kishin dhënë kontributin e tyre në diskutimet për disa çështje me interes për arsimin.

Gjatë takimit ishte diskutuar për:

- mundësinë e udhëtimit pa pagesë të mësimdhënësve me Trafikun Urban,
- përgatitjet për buxhetin e vitit të ardhshëm, si dhe
- njoftimet lidhur me shkollat që do të përfshihen në mësimin gjithëditor.

Në emër të SBASHK-ut, fjalën përshëndetëse e kishte mbajtur sekretari i Përgjithshëm, z. Ymer Ymeri, i cili kishte falënderuar drejtorin e DKA-së, Samir Shahini, për bashkëpunimin e mirë me SBASHK-un, si dhe kryetarin e Komunës së Prishtinës, Përparim Rama, për mundësinë që punëtorët e arsimit të udhëtojnë falas përmes Trafikut Urban.

Ymeri kishte përgëzuar DKA-në që, pavarësisht sfidave me mosmiratimin e buxhetit nga Kuvendi, Komuna e Prishtinës kishte arritur të funksionojë me buxhetin e vitit të kaluar dhe t'i realizojë të gjitha planifikimet e parapara.

“Urojmë që ky bashkëpunim i mirë të vazhdojë në të njëjtin nivel edhe në javët dhe muajt në vijim”, kishte thënë Ymeri.

Ai kishte theksuar gjithashtu



SBASHK kishte përkrah fuqishëm protestën e Sindikatës së Punëtorëve të RTK-së (SPERTK)

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës Kosovës (SBASHK) shpreh përkrahjen e plotë dhe të palëkundur për Sindikatën e Punëtorëve të RTK-së (SPERTK) dhe për të gjithë punëtorët e këtij mediumi publik, të cilët, përmes dialogut e veprimeve sindikale, po kërkojnë një të drejtë themelore, sigurimin e pagave të tyre të merituar.

SBASHK-u ka ndjekur me vëmendje situatën e krijuar në RTK dhe shpreh shqetësimin e thellë për faktin se, më 12 nëntor 2025, punëtorët e RTK-së ende nuk kanë marrë pagat e muajit tetor. Kjo gjendje është e papranueshme dhe përbën cenim të drejtpërdrejtë të dinjitetit të punëtorit.

SBASHK-u i bën thirrje urgjente Qeverisë në detyrë që të gjejë menjëherë zgjidhje dhe të alokojë mjetet e nevojshme për pagesën e pagave, jo vetëm për muajin tetor, por edhe për muajt në vijim, në mënyrë që të

se SBASHK-u mbështet mësimin gjithëditor, veçanërisht në rastet kur mësimdhënësit nuk kanë angazhim shtesë. Në ato raste kur ka angazhim shtesë, sipas tij, ai duhet të paguhet si mbinormë, gjë që njëkohësisht kontribuon në ruajtjen e vendeve të punës në arsim.

garantohet funksionimi normal i RTK-së dhe mirëqenia e punëtorëve të saj.

Po ashtu, SBASHK-u shpreh indinjatën e thellë ndaj çdo forme presioni që, sipas raportimeve, po ushtrohet mbi punëtorët e RTK-së. U bëjmë apel drejtuesve të këtij institucioni publik që të ndalojnë menjëherë çdo presion ndaj të punësuarve dhe të bëhen zëri i tyre për kërkesën më bazike, pagën për punën e ndershme që kryejnë çdo ditë në shërbim të publikut.


Në shenjë solidariteti dhe përkrahjeje sindikale, Kryesia e SBASHK-ut do të marrë pjesë në protestën e nesërme të organizuar nga Sindikata e Punëtorëve të RTK-së.

Gjithashtu, SBASHK-u nuk përjashton mundësinë që, nëse kjo situatë vazhdon, të mobilizojë të gjithë anëtarësinë e saj, nga çerdhet e deri në universitete, për t'u solidarizuar me kolegët e RTK-së, sepse solidariteti ndërmjet punëtorëve është shtylla më e fortë e lëvizjes sindikale.

SBASHK-u do të jetë gjithmonë në krah të çdo punëtori që lufton për dinjitetin dhe të drejtën e tij.



SBASHK zgjidhet Anëtar Kandidat për Zgjerim në Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian (EESC)



SBASHK gjatë dhjetorit ka pranuar njoftimin zyrtar nga Komiteti Ekonomik dhe Social Evropian (EESC) se është përzgjedhur për të qenë Anëtar Kandidat për Zgjerim (KEZ), duke u bërë pjesë e një procesi të rëndësishëm institucional evropian që lidhet drejtpërdrejt me dialogun social, politikat publike dhe procesin e zgjerimit të Bashkimit Evropian.

Qëllimi i kësaj iniciative të EESC-së është krijimi i një grupi të Anëtarëve Kandidatë për Zgjerim në Kosovë, të cilët do të kenë mundësi të marrin pjesë aktive në hartimin e opinionëve të EESC-së që janë relevante për organizatat e shoqërisë civile (OSHC) dhe për

vendet potenciale kandidate për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Ky vendim përbën një njohje të drejtpërdrejtë institucionale evropiane për rolin, seriozitetin dhe përfaqësimin e SBASHK-ut si zë autentik i mësimdhënësve dhe punëtorëve të arsimit në Kosovë. Njëkohësisht, ai përfaqëson një hap me rëndësi të veçantë në integrimin gradual të Kosovës në mekanizmat evropianë të dialogut social dhe të vendimmarrjes konsultative.

Rëndësia e Komitetit Ekonomik dhe Social Evropian (EESC)

Komiteti Ekonomik dhe Social Evropian është një organ këshillëdhënës i Bashkimit Evropian që përfaqëson interesat e punëdhënësve, punëmarrësve dhe organizatave të shoqërisë civile. Ai luan një rol kyç në hartimin e legjislacionit dhe politikave evropiane, duke siguruar që zëri i dialogut social dhe i qytetarëve të reflektohet në proceset vendimmarrëse të BE-së, veçanërisht në fushat e punës, të drejtave sociale, arsimit, kulturës dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Rëndësia e anëtarësimit të SBASHK-ut në këtë mekanizëm

Statusi i Anëtarit Kandidat për Zgjerim i mundëson SBASHK-ut pjesëmarrje të drejtpërdrejtë në hartimin e opinioneve të EESC-së, veçanërisht në çështjet që lidhen me arsimin, punën dhe vendet

potenciale kandidate. Kjo e vendos sindikalizmin kosovar të arsimit në tryezat evropiane ku artikulohehen politikat për të drejtat e punëtorëve, dialogun social dhe drejtësinë sociale në arsim, duke rritur dukshëm zërin dhe ndikimin e mësimdhënësve të Kosovës në nivel evropian. SBASHK e konsideron këtë zhvillim si një përgjegjësi shtesë, por edhe si një mundësi të rëndësishme për të kontribuar në avancimin e standardeve evropiane në arsimin dhe në mbrojtjen e të drejtave sindikale, në përputhje me praktikën dhe vlerat e Bashkimit Evropian.

SBASHK-u përgatit Planin strategjik 2026-2031



SBASHK-u ka vazhduar me aktivitetet sindikale përkrahur nga Qendra Amerikane e Solidaritetit. Kështu më 20 dhe 21 dhjetor 2025 ishin gjendur në një punëtori, që kishte për objektiv përgatitjen e Planit strategjik të aktiviteteve sindikale për pesë vitet në vijim.



Në hapje të këtij aktiviteti, kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj, kishte falënderuar zyrtaren e lartë në Qendren e Solidaritetit, Bruna Hylviu dhe gjithë Qendrën Amerikane të Solidaritetit për përkrahjen e vazhdueshme në përpjekjet për ta forcuar zërin sindikal. Jasharaj kishte kujtuar se edhe ky aktivitet sindikal shumë me rëndësi përkrahet nga kjo Qendër.



Zyrtarja e lartë e Qendrës Amerikane të Solidaritetit me seli në Tiranë, znj. Hylviu kishte shprehur respekt për gjithë angazhimet e SBASHK-ut duke konfirmuar se edhe tani e tutje kjo Qendër do të përkrahë angazhimet e SBASHK-ut për të qenë të përgatitur në përballje me sfidat e kohës. Ajo kishte

theksuar se në secilin aktivitet sindikal përfaqësuesit e SBASHK-ut kanë qenë shumë të angazhuar kështu që janë arritur edhe objektivat e parapara. Znj. Hylviu në fjalën përshëndetëse kishte falënderuar edhe ekspertin e mirënjohur të arsimit z. Dukagjin Pupovci.

Në vazhdim të kësaj punëtorie Pupovci kishte treguar për objektivat e kësaj punëtorie për të treguar edhe për temat kyçe e duke veçuar Qeverisjen dhe kapacitetet organizative, Shërbimet për anëtarë, për dialogun social, për financat dhe qëndrueshmërinë institucionale dhe për komunikimin, imazhin publik. Kontribut me vlerë në arritjen e objektivave, krahas ekspertit Pupovci kishin dhënë

edhe sekretari i Përgjithshëm i SBASHK-ut Ymer Ymeri, nënkryetarja Vjollca Shala, zyrtari Ligjor Blendor Shatri, por edhe pjesëmarrësit tjerë në këtë punëtori. Angazhimi maksimal i të gjithëve kishte bërë që të përgatitet Plan i strategjik i SBASHK-ut, i cili paraqet bazën e aktiviteteve që do të zhvillohen në pesë vitet e ardhshme.



SBASHK moi pjesë në Konferencën Botërore mbi Inteligjencën Artificiale Bruksel



SBASHK ishte përfaqësuar në Konferencën Botërore mbi Inteligjencën Artificiale, e cila ishte mbajt në Bruksel, me një delegacion prej katër pjesëmarrësish të kryesuar nga sekretari i Përgjithshëm i SBASHK-ut, Ymer Ymeri, si dhe nënkryetarja e SBASHK-ut, Vjollca Shala.



Konferenca ishte hapur nga kryetari i Edukimit Ndërkombëtar (EI), Magwena Maluleke. Fjalë përshëndetëse kishin mbajtur edhe kryetari i ETUCE-s, John MacGabhann, dhe kryetarja e Sindikatës së Mësuesve të Amerikës (AFT), Randi Weingarten.

Me temën qendrore: “Formësimi i së ardhmes sonë: Sindikatat e arsimit udhëheqin për një inteligjencë artificiale të përqendruar te njeriu”, gjatë ditës së parë ishin zhvilluar diskutime të rëndësishme rreth përdorimit të inteligjencës artificiale në arsim dhe ndikimit të saj në mësimdhënie, mësimnxënie dhe profesionin e mësuesit.



Në konferencë ishin trajtuar tema si:

Kornizat dhe qasjet e shkrim-leximit të IA-së dhe ndikimi i tyre në politikën arsimore;

Si duhet të integrohen konceptet e IA-së në kurrikula;

Roli i sindikatave të arsimit në mbështetjen e anëtarëve dhe nxënësve për t'u angazhuar në mënyrë kritike dhe të sigurt me teknologjitë e reja;

Përdorimi i mundësive që IA ofron për arsimin, duke garantuar etikë, privatësi, dinjitet profesional dhe standarde të barabarta për të gjithë. Gjatë punimeve të konferencës ishin zhvilluar edhe diskutime panelesh ku kishin marrë pjesë përfaqësues të sindikatave nga shumë vende të botës, duke sjellë përvoja, ide dhe modele të zbatimit të IA-së në sistemet edukative.



Delegacioni i SBASHK-ut kishte realizuar takime të rëndësishme me udhëheqës dhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, përfshirë:

Kryetarin e EI-së, Magwena Maluleke;
Kryetaren e AFT-së, Randi Weingarten;
Kryetarin e ETUCE-s, John MacGabhann;
Drejtorin e ETUCE-së, Jelmer Evers;
Si dhe delegacione nga vende të ndryshme të Evropës, Amerikës, Afrikës dhe Azisë.
Kjo pjesëmarrje e SBASHK-ut përbën një mundësi të rëndësishme për forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, shkëmbimin e praktikave më të mira dhe avancimin e angazhimit sindikal për një qasje të drejtë, etike dhe të përqendruar te njeriu në përdorimin e inteligjencës artificiale në arsim.

SBASHK mbajti 10 grupe të trajnimit

SBASHK gjatë dhjetorit organizoi 10 grupe të trajnimit dhe mbajti testet për 6 grupe që e kishin përfunduar trajnimin

Gjatë muajit dhjetor SBASHK kishte organizuar dhjetëra grupe të trajnimit për mësimdhënës në dy programe të trajnimit, si dhe kishte organizuar edhe testet për gjashtë grupe të mësimdhënësve të cilët e kishin përfunduar më parë trajnimin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”.



Të martën e 23 dhjetorit ishte organizuar testi në Viti për mësimdhënës të cilët e kishin ndjekur trajnimin në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”-moduli 2.



Mësimdhënësit të cilët e kishin vijuar trajnimin i kishte përshëndetur edhe kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj, i cili u kishte dhënë mbështetje në mbrojtjen e të drejtave të tyre dhe përmirësimin e kushteve të punës.



Testi ishte administruar nga sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri, derisa trajnimin e kishte udhëhequr trajneri i përzgjedhur nga SBASHK, Musli Neziri. Për ta përcjellë nga afër mbarëvajtjen e testimit ishte i pranishëm edhe kryetari i NSKAP-it për Viti, Kemajl Bislimi.



Më 19 dhjetor të vitit të shkuar ishin mbatur testet për dy grupe të mësimeve të Mitrovicës të cilët i kishin ndjekur me sukses trajnimet e programit “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësime”, moduli 1 dhe moduli 2.



Testet ishin administruar nga nënkryetarja e SBASHK-ut, Vjollca Shala dhe sekretari i Përgjithshëm, Ymer Ymeri, derisa i pranishëm ishte edhe kryetari i NSKAP-it për Mitrovicë, Isa Ismajli.



Trajnimi “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësime”- moduli 1 ishte udhëhequr nga trajneri i përcaktuar nga SBASHK, Kadri Hyseni, kurse ai “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësime”- moduli 2 nga trajneri Fevzi Selmani.



SBASHK të dielën e 21 dhjetorit kishte mbajtur testin edhe për një grup të mësimeve në Pejë, i cili ishte udhëhequr nga trajneri Burim Karasniqi.



Testi ishte administruar nga sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri dhe zyrtari Ligjor, Blendor Shatri. I pranishëm ishte edhe kryetari i NSKAP-it për Pejë, Isuf Lajqi i cili ishte kujdes për mbarëvajtjen e trajnimit dhe testit.



Ndërkohë, dy javë më parë testet ishin organizuar edhe për 4 grupe të trajnimit. Të dielën e 7 dhjetorit, SBASHK kishte organizuar testet për katër grupe të mësimeve të cilët e kishin përfunduar më parë trajnimin në programin "Aplikimi i programeve kompjuterike në mësime" në Lipjan dhe Skenderaj.



Në Lipjan ishin mbajtur testet për dy grupe të mësimdhënësve, një në programin "Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie"-moduli 1 i cili ishte udhëhequr nga trajneri Idriz Sopa dhe grupi tjetër në programin "Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie"-moduli 2, i cili ishte udhëhequr nga trajnerja e përcaktuar nga SBASHK, Blerona Ahmeti.



Testet në Lipaj ish administruar nga sekretari i Përgjithshëm, Ymer Ymeri dhe zyrtarja Nezafete Jakupi, derisa mësimdhënësit i kishte vizituar edhe kryetari i NSKAP-it për Lipjan, Emrush Ahmeti.



Po ashtu testet për dy grupe të mësimdhënësve ishin mbajtur edhe në Skenderaj në programin "Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie"-moduli 1.



Trajnimet ishin udhëhequr nga trajneret e përcaktuara nga SBASHK, Fatlume Mehmeti dhe Arbenita Gashi, kurse testet ishin administruar nga zyrtari Ligjor në SBASHK, Blendor Shatri.



I pranishëm ishte edhe kryetari i NSKAP-it për Skenderaj, Shpend Rexha i cili ishte kujdesur për mbarëvajtjen e procesit.



Gjatë dhjetorit SBASHK kishte organizuar edhe dhjetë grupe të reja të trajnimit në dy programe të ndryshme: "Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie" si dhe "Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social".



Të shtunën e 13 dhjetorit kishin filluar tri grupe të trajnimit, dy në programin "Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie" dhe një në atë "Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social".

Në Mitrovicë kishin filluar dy grupe të trajnimit, një në programin "Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie", me trajner Fevzi Selmani.

Kurse grupi tjetër në programin "Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social", me trajner Muhamet Shala.

Në po të njëjtin program, një grup i mësimdhënësve e kishin filluar trajnimin edhe në Rahovec, ku trajnimin e kishte


udhëheqë trajneri i përcaktuar nga SBASHK, Gani Kryeziu.



Mësimdhënësit në Rahovec i kishte vizituar edhe kryetari i NSKAP-it për këtë komunë, Mehmet Kryeziu, i cili ishte kujdesë për mbarrëvajtjen e trajnimit dhe kushtet e punës.



Ndërkohë, të shtunën e 6 dhjetorit SBAHSKu kishte filluar me 6 grupe të trajnimit. Në Prishtinë kishin filluar dy grupe të trajnimit në programin "Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie"-moduli 2, me trajneren e përcaktuar nga SBASHK-u, Doruntina Demaku dhe trajnerin Arben Zymeri. Mësimdhënësit që e kishin filluar trajnimin i kishte vizituar edhe kryetari i NSKAP-it për Prishtinë, Qamil Hajdini, i cili u kishte uruar sukses mësimdhënësve në zhvillimin profesional.



Një grup i trajnimit në programin "Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie", kishte filluar edhe në Drenas, me trajnerin e përzgjedhur nga SBASHK, Nexhmedin Gruda. Edhe mësimdhënësit e Drenasit i kishte vizituar kryetari i NSKAP-it për këtë komunë, Iilaz Dervishi.

Kurse në Malishevë SBASHK kishte filluar me dy grupe të reja të trajnimit: Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie dhe Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social.



Grupin nga programi "Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie", e kishte udhëhequr trajneri i përcaktuar nga SBASHK-u, Albert Samadraxha kurse atë të programit "Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social", e kishte udhëhequr trajneri Skender Gashi.



Edhe në Vushtri kishin filluar dy grupe të trajnimit në po këto programe. Trajnimin në programin "Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie" e kishte udhëhequr trajneri i përcaktuar nga SBASHK, Afrim Haziri kurse trajnimin e programit "Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social", trajneri Zahir Kastrati. SBASHK vazhdon angazhimin në shërbim të anëtarësisë më organizimin e trajnimeve pa pagesë për të gjithë mësimdhënësit anëtar.

SBASHK ishte pjesëmarrës në Konferencën e Parë të projektit evropian “Mësimdhënia Rreth Orës (TAC)”



SBASHK në dhjetor kishte përfaqësuar mësimdhënësit e Kosovës në një ngjarje të rëndësishme evropiane e cila ishte mbajtur në Romë – Konferencën e Parë të projektit “Mësimdhënia Rreth Orës (TAC)”, organizuar nga ETUCE, ku marrin pjesë sindikata të arsimit nga i gjithë kontinenti.



SBASHK në Romë ishte përfaqësuar nga nënkryetaria Vjollca Shala dhe sekretari i Përgjithshëm Ymer Ymeri, të cilët kishin kontribuar në diskutimet profesionale dhe po paraqesin qartë sfidat, përvojat dhe realitetin e mësimdhënësve tanë. Në fillim të takimit ishte prezantuar agjenda dhe objektivat e projektit TAC, i cili synon të sjellë një pasqyrë të saktë dhe të bazuar në të dhëna të ngarkesës së vërtetë të punës së mësuesve në Evropë. Ishte theksuar se shumë punë e mësuesve mbetet “e padukshme”, si përgatitja e mësimëve, vlerësimi, komunikimi me prindërit dhe detyra

të tjera që tejkalojnë orarin e planifikuar. Përfaqësues nga vende të ndryshme evropiane – Belgjika, Gjermania, Danimarka, Polonia dhe të tjera – kishin prezantuar gjetje kërkimore mbi: orarin real të punës së mësuesve, ndikimin e stresit dhe përgjegjësi shtesë, diferencat e mëdha ndërmjet vendeve në paga dhe kushte pune, mungesën e investimeve në arsim, sfidat e sigurisë profesionale dhe mungesën e mësuesve të kualifikuar.



Këto të dhëna kishin treguar qartë se ngarkesa e tepërt e punës dhe presioni i vazhdueshëm po ndikojnë në shëndetin, motivimin dhe cilësinë e procesit mësimor. Ishin prezantuar gjithashtu studime që tregojnë se stresi i akumuluar i mësuesve ka pasoja të drejtpërdrejta në cilësinë e të nxëniet. Përfaqësuesit tanë kishin paraqitur me dinjitet sfidat që përjetojnë mësuesit në Kosovë: mungesa e investimeve adekuate, pagat ende larg standardeve evropiane, punët e shumta shtesë jashtë orarit të mësimdhënies, nevoja për mbështetje profesionale dhe kushte më të sigurta pune. Ata kishin marrë pjesë aktivisht në diskutime dhe po krijojnë ura bashkëpunimi me sindikatat simotra evropiane, duke kontribuar që zëri i arsimit të Kosovës të dëgjohet në tryeza me rëndësi ndërkombëtare.

SBASHK kishte kërkuar sqarime rreth konkursit për Këshillin Ekonomik Social

Ministri në detyrë Hekuran Murati e kishte bërë të pamundurën që ta bllokojë dialogun social mes Qeverisë, punëdhënësve dhe Sindikatave, që janë pjesë e BSPK-së. Ai për këtë qëllim kishte pamundësuar shpalljen e konkursit për aplikim të palëve për 3 vite me radhë. Më në fund tani kur është vetëm ministër në detyrë ai ka shpallur konkurs me kriteret të çuditshme e të pabazuara në Ligjin për Këshillin Ekonomik Social. Në konkursin e Muratit për KES përmendet numri prej 41.449 anëtarëve që duhet t'i kenë sindikatat. Ligji për KES kërkon se për të aplikuar për këtë Këshill, sindikata duhet t'i ketë anëtarë 10% i të punësuarve. Shtrohet pyetja se ku e mori Murati shifrën 41.449. Për cilët të punësuar mendon Murati? Po ashtu SBASHK publikisht kërkon sqarim nga Murati për termin "degë sindikale". Ligji për organizim sindikal nuk e përmend këtë term, por saktëson tre terma për organizimin sindikal dhe atë shoqata sindikale, federata sindikale dhe Konfederata sindikale.

Duke u bazuar në këto paqartësi, që nuk janë bërë pa qëllim, SBASHK-u kërkon që thirrja drejtuar palëve për pjesëmarrje në bazë të konkursit me plotë paqartësi të anulohet dhe të shpallet konkurs i ri duke përdorë terme të qarta dhe duke u bazuar në Ligjin për organizimin sindikal dhe në Ligjin për Këshillin Ekonomik Social e duke mos harruar se në Kosovë është BSPK-ja e vetmja Konfederatë e regjistruar dhe prandaj ajo duhet të jetë pjesëmarrëse në një konkurs të

ri për Këshillin Ekonomik Social si përfaqësuese e të punësuarve në Kosovë.

Republika e Kosovës - Republic of Kosovo
Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture
 Rr. Agim Ferizaj 10000 Prishtinë, Tëllëf. +381(0)38 226 848,
 www.sbaskk.org.uk - E: sbaskk2004@eunet.com, info@sbaskk.org.uk

Për: Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve
Ministrit në detyrë – z. Hekuran Murati

Nga: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK)
Kryetari – Rrahman Jasharaj

Bazuar në Ligjin për organizim sindikal, Statutin e SBASHK-ut, SBASHK i drejtohet institucionit tuaj në këtë:

KËRKESË

Për sqarim rreth konkursit për Këshillin Ekonomik Social

ITë sqarohet detajisht se mbi cilën bazë ligjore keni cëkur në kriteret e aplikimit të sindikatave numrin prej 41.449 anëtarëve sindikalë, kur në Ligjin për KES ceket 10% e të punësuarve si dhe ku e keni marrë këtë numër.

II.Të sqarohet termi "degë sindikale", se çfarë keni dashur të thoni me të, për shkak se nuk është në harmoni me Ligjin për organizim sindikal.

ARSYETIM

I.

Në si Sindikatë e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës – SBASHK, jemi anëtarë të Konfederatës së vetme në Republikën e Kosovës, e cila është Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës – BSPK. Zyrtarisht, BSPK është Konfederata e vetme në Kosovë që ka certifikatë të regjistrimit të lëshuar nga Ministria e Punës, siç ishte më parë. Për ta marrë atë certifikatë nevojitet të sigurohet 10% e të punësuarve si anëtarë në Konfederatë, kriter të cilin BSPK e ka plotësuar dhe është pajisur me certifikatë si Konfederatë. Në bazë të veprimtimit tuaj, kur keni paraqitur në thirrje për aplikim numrin prej 41.449, e konsiderojmë si veprim të jashtëligjshëm dhe tendencë për të krijuar paqartësi rreth aplikimit të Konfederatës së vetme në Kosovë. Gjithashtu kërkojmë të na sqaroni saktë se ku e keni marrë numrin prej 41.449 sepse ne mendojmë se ky numër është me i vogël dhe qëllimisht është shkruar edhe pse cështja e numrit është e jashtëligjshme.

II.

Tek thirrja për aplikim për Këshillin Ekonomik Social, përkatësisht tek kriteret për sindikatat, është përdorur termi "degë sindikale", pavarësisht se në Ligjin për KES-in shënon ashtu, Në

kërkojmë të sqarohet kjo pikë, për shkak se në Ligjin për organizimin sindikal ekzistojnë vetëm këto terma:

1. Shoqatë sindikale
2. Federatë sindikale
3. Konfederatë sindikale

Pra, e kemi të paqartë kërkesën për numrin e degëve sindikale se çfarë saktësisht është kërkuar. Mbi këtë bazë kërkojmë që thirrja të anulohet dhe thirrja e re të shpallet duke u përpiluar në harmoni me Ligjin për KES-in dhe Ligjin për organizimin sindikal, dhe të mos ketë terma të paqarta dhe kërkesa me numra strikt, siç është rasti i 41.449 anëtarëve për sindikata, sepse Ligji për KES-in kërkon vetëm 10%. BSPK është Konfederata e vetme që e ka të konfirmuar me certifikatë regjistrimi përqindjen prej 10%.

Shpresojmë në mirëkuptimin dhe veprimin tuaj pozitiv që këto kërkesa tona të drejta të realizohen.

Prishtinë: 12.12.2025

Kryetari i SBASHK-ut
 Rrahman Jasharaj

R. Jasharaj

SBASHK në Bruksel - AI, barazi dhe gjithëpërfshirje në arsim



Nga 15–17 dhjetor, SBASHK kishte marr pjesë në Bruksel në trajnimin e përbashkët të ETUI dhe ETUCE: “Inteligjenca Artificiale, barazia dhe gjithëpërfshirja në arsim – ndërtimi i veprimeve sindikale”. SBASHK ishte përfaqësuar nga sekretari i Përgjithshëm, Ymer Ymeri, dhe kryetari i Komisionit Statutar, Blendor Shatri.

Ky trajnim ishte i rëndësishëm sepse AI po ndryshon arsimin, dhe sindikatat duhet të sigurojnë që kjo teknologji të përdoret në mënyrë të drejtë, pa diskriminim dhe në shërbim të mësimdhënësve dhe nxënësve.

Në këtë takim kishte marrw pjesë edhe përfaqësuesja e Sindikatës së Pavarur e Arsimit të Shqipërisë SPASH, Matilda Zani.

SBASHK vazhdon të jetë aktive në rrjetet sindikale evropiane dhe botërore, duke mbrojtur



interesat e anëtarësisë dhe duke punuar që mësimdhënësit e Kosovës të jenë krah për krah me kolegët evropianë – me më



shumë mbrojtje dhe më shumë perspektivë.

SBASHK – zëri yt në Kosovë dhe në Evropë.





Sindikata e Bashkuar
e Arsimit,
Shkencës dhe Kulturës

Dhjetor 2025